



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 48/2022 regjistër (JR)
Datë 17.11.2022

Nr. 44 i vendimit
Datë 28.05.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 28.05.2025, ora 11:20, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 48/2022 (JR), datë 17.11.2022, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Emiljano Ruli, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 557, datë 29.07.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; neni 442 e vijues i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve

në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit dhe dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, Emiljano Ruli (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenit 3/16 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse, prej të cilave rezultoi si më poshtë:

2.1 Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”) kreu kontrollin për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, i përcolli Komisionit raportin në të cilin ka konstatuar: *a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor; b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; d) nuk ka kryer deklarim të rremë; e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit dhe, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë raportin e Grupit të Punës, duke konstatuar: *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Emiljano Sh. Ruli.*

2.3 Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGj) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, duke dërguar raportin përkatës.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit bazuar në tri kriteret e vlerësimit, duke marrë vendimin nr. 557, datë 29.07.2022.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 557, datë 29.07.2022, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, mbështetur në konkluzionet si vijon:

- Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: -- *Mungesa e burimeve të ligjshme financiare në vlerën - 4.322.620 lekë, për të justifikuar pagesën e shumës 8.631.500 lekë, si pjesë e çmimit të apartamentit me sipërfaqe 119.3 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për harkun kohor 01.01.2009 – 12.11.2009, e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, në përputhje me parashikimet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 61 dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. -- Subjekti ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të*

interesit, kur ka gjykuar tri çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{***}” ShPK dhe kjo e vendos në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, në përputhje me parashikimet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 61 dhe germës “d”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. -- Në analizë të burimit të deklaruar në deklaratën vetting lidhur me pasurinë e luajtshme tip “Mercedes - Benz”, sipas një vlerësimi tërësor të të gjitha hallkave të zinxhirit të burimit të pretenduar, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, pavarësisht përpjekjeve, subjekti dështoi të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, duke u ndodhur në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 33, germa “b”, dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se, bazuar në konkluzionet e arritura më lart, në konsideratë edhe të standardeve të vendosura nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit Emiljano Ruli nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

- Për kriterin e kontrollit të figurës: Komisioni lidhur me kontrollin e figurës, nuk konstatoi indicie apo informacione, sipas kërkesave të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, që mund të përbënin dyshim të arsyeshëm gjatë kryerjes së hetimit administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit. Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Emiljano Ruli ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

- Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: Trupi gjykues konkludon se, në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues.

III. Mendimi paralel i vëzhguesit ndërkombëtar

5. Vendimit të Komisionit nr. 557, datë 29.07.2022, i bashkëlidhet mendimi paralel nr. {***} prot., datë 14.10.2022, i vëzhguesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”), i bazuar në nenin 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit çështja që i përket subjektit të rivlerësimit Emiljano Ruli referohet pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, për vlerësimin e ekzistencës së elementeve që përbëjnë shkak shkarkimi sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që do të justifikonin ushtrimin e ankimit.

IV. Shkaqet e ankimit

6. Subjekti i rivlerësimit, më datë 31.10.2022, ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 557, datë 29.07.2022, të Komisionit¹, duke kërkuar që Kolegji i Posaçëm i Apelimit (në vijim “Kolegji”) të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë: (i) gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; (ii) konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese, si dhe ato të parashikuara nga KEDNj, ndaj ankuesit Emiljano Ruli, me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; (iii) ndryshimin e vendimit nr. 557, datë 29.07.2022, të KPK-së, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Emiljano Ruli, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
7. Ankimi i subjektit të rivlerësimit përmban shkaqe procedurale dhe shkaqe të tjera në lidhje me themelin e çështjes, të cilat në tërësinë e tyre kanë të bëjnë me interpretim të gabuar të ligjit material dhe mosvlerësimin siç duhet të provave të administruara nga Komisioni.

7.1 Shkaqet e ankimit, që i përkasin natyrës procedurale dhe parimeve të cenuara të procesit të rregullt ligjor, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si vijon:

¹ Ky ankim është regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 31.10.2022.

7.1.1 Komisioni ka kryer shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak se gjykata nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme.

7.1.2 Komisioni ka qenë i njëanshëm, paragjykes dhe ka pasur diskrecion të pakufizuar.

7.1.3 Komisioni ka kryer shkelje të nenit 6 të Konventës për shkak se subjekti nuk është dëgjuar drejtësisht, në kundërshtim me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve.

7.1.4 Komisioni ka kryer shkelje të nenit 7 të Konventës për shkak se është cenuar parimi i sigurisë juridike.

7.1.5 Komisioni ka kryer shkelje të nenit 8 të Konventës për shkak se nuk është zbatuar parimi i proporcionalitetit.

7.2 Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

7.2.1 Në lidhje me “Apartament banimi 2+1, me sipërfaqe 119.3 m², rruga “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se mungesa e burimeve të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie ka rezultuar për shkak se në analizën financiare, në kundërshtim me provat e administruara, nuk janë përfshirë: i) huaja në vlerën 3.000.000 lekë, e marrë nga babai; ii) shumat e tërhequra nga llogaritë bankare, nga subjekti dhe bashkëshortja, në muajin dhjetor të vitit 2009.

7.2.2 Në lidhje me “Apartament banimi me sipërfaqe 119 m², rruga “{***}, Tiranë”, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit.

7.2.3 Në lidhje me “Automjet tip ‘Mercedes Benz’”, blerë në vitin 2015, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në datën e blerjes së automjetit, ai ka pasur mjaftueshmëri financiare për blerjen e këtij automjeti, duke u ndodhur në kushtet e shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

7.3 Në ankim, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar, ka pretenduar se, i paraqitur në këtë fazë, ai vjen në kundërshtim me parimet e procesit të rivlerësimit.

8. Subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Kolegjit që, bazuar në parashikimet e neneve 45, 49, 52 dhe 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të merren në shqyrtim dhe të vlerësohen aktet e paraqitura prej tij bashkëlidhur ankimit, si vijon: (i) kopje e Diplomës së Integruar të Nivelit të Dytë në Drejtësi e znj. B. R., lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë dhe certifikatë notash; (ii) kopje vërtetimi në gjuhën angleze, i lëshuar nga institucioni “Universita degli Studi di Padova” Itali, datë 25.03.2014, në lidhje me z. E. R.; (iii) dokument në gjuhën italiane, i lëshuar nga institucioni “Universita degli Studi di Cagliari”, Itali (me gjasë, nga sistemi elektronik i këtij institucioni), i datës 30.05.2018, në lidhje me z. E. R.
9. Në datën 13.05.2025 dhe 23.05.2025, subjekti i rivlerësimit depozitoi në Kolegj parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankimin e datës 31.10.2022, si dhe parashtrime shtesë, regjistruar përkatësisht me nr. {***} prot., datë 13.05.2025 dhe nr. {***} prot., datë 23.05.2025. Me parashtrimet shtesë të datës 23.05.2025, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet shkresore si vijon: (i) kopje e kartës së identitetit të shtetasit E. R., lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Italisë, Bashkia Padova, më datë 15.05.2019, me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 23.05.2025; (ii) kopje e lejes së qëndrimit të shtetasit E. R., lëshuar nga Ministria e Brendshme, Departamenti i Sigurisë Publike, Stacioni i Policisë Padova, Itali, më datë 05.05.2015, me vërtetim përkthimi nr.

{***}, datë 23.05.2025; (iii) kërkesë e subjektit të rivlerësimit dhe shkresë kthim përgjigje e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë me nr. {***} prot., datë 22.05.2025, origjinale, përmes së cilës përcillen të dhënat e sistemit TIMS mbi hyrje-daljet e shtetasit E. R. në shtetin shqiptar.

V. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Emiljano Ruli, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimitimi i ankuesit

11. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 557, datë 29.07.2022, të Komisionit, për shkak të ankimit të subjektit të rivlerësimit Emiljano Ruli, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore, të zhvilluar në dhomë këshillimi.
13. Trupi gjykues, fillimisht, mori në analizë shkaqet e ankimit me natyrë procedurale të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, për të vlerësuar nëse ishte i nevojshëm debati gjyqësor, për korrigjimin e ndonjë shkelje të rëndë procedurale të Komisionit, që do të cenonte procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut apo me qëllim konstatimin e saktë, të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, në kuptim të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”).
14. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: *Komisioni ka kryer shkelje të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për shkak se gjykata nuk ka qenë e pavarur dhe e paanshme*. Duke iu referuar çështjes “Volkov kundër Ukrainës”, lidhur me kriteret që duhet të merren në konsideratë për të përcaktuar nëse një organ, që vendos masa disiplinore ndaj gjyqtarëve, është i pavarur dhe i paanshëm, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se anëtarët e Komisionit, përfshirë edhe relatorin e çështjes, nuk kanë ardhur nga radhët e gjyqësorit dhe se janë përzgjedhur në shkelje flagrante të

procedurës dhe kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016, fakt që dëshmohet edhe nga lista e kandidatëve që nuk plotësonin kriteret ligjore, përcjellë Kuvendit nga institucioni i Avokatit të Popullit, në të cilën vetëm 8 nga 27 anëtarë të zgjedhur kanë përmbushur kushtet ligjore për t'u zgjedhur si të tillë. Ligji nr. 84/2016 parashikon kriterë strikte, por nga ana tjetër nuk parashikon se si do të verifikohen kushtet e zgjedhshmërisë së kandidatëve, për më tepër në afate shumë të shkurtra kohore për verifikim. Sipas subjektit të rivlerësimit, Kolegji duhet të ndryshojë qëndrimin e mbajtur deri më tani, se nuk ka kompetencë juridiksionale të shqyrtojë përmbushjen e kriterëve ligjore nga anëtarët e institucioneve të rivlerësimit.

14.1 Në vlerësim të këtij pretendimi, trupi gjykues, nga verifikimi në aktet e fashikullit të hetimit administrativ, vëren se subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit në Komision², në seancën dëgjimore të datës 11.05.2022, ka deklaruar: *“[...] Më lejoni të shpreh konsideratën time më të lartë përgjithësisht për veprimtarinë kushtetuese që kryen Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe posaçërisht për hetimin profesional, të pavarur dhe të paanshëm që ky trup gjykues i nderuar ka kryer në kuadër të procesit të rivlerësimit ndaj meje si subjekt rivlerësimi. [...]”*. Pavarësisht këtij pohimi të subjektit të rivlerësimit, i cili duke dëshmuar të kundërtën e asaj që pretendohet në ankim, do të bënte të panevojshëm analizën e mëtejshme të shkakut të ankimit lidhur me cenimin e gjykatës së paanshme e të pavarur, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se normat kushtetuese dhe ligjore, që garantojnë pavarësinë e organeve të rivlerësimit, janë vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, e cila shprehet se: *“[...] Gjykata, duke bërë një interpretim sistematik të dispozitave të ligjit të kundërshtuar, nga konteksti i tyre, si dhe nisur nga kuptimi i përgjithshëm i këtij ligji, vlerëson se qëllimi i tyre është përcaktimi i rregullave që do të ndiqen gjatë procesit të rivlerësimit nga organet kushtetuese të pavarura, të cilat janë të vetmet organe që kanë kompetencën për të realizuar kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, si dhe kriteret dhe mënyra e realizimit të këtij procesi. [...]*. Gjithashtu, edhe GjEDNj-ja ka mbajtur qëndrim, duke vlerësuar të pabazuara pretendimet lidhur me pavarësinë e organeve të rivlerësimit, për sa subjektet e rivlerësimit që i kanë ngritur ato, nuk kanë kontestuar paanësinë subjektive të anëtarëve të organeve të rivlerësimit³. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se Kolegji duhet të ndryshojë praktikën e deritanishme dhe të marrë në shqyrtim pretendimet në lidhje me mospërmbushjen e kriterëve ligjore nga anëtarët e institucioneve të rivlerësimit dhe mënyrën e zgjedhjes së tyre, trupi gjykues, në konsideratë të arsytimit⁴ të GjEDNj-së në çështjen “Altina

² *Procesverbal i seancës dëgjimore të datës 11.05.2022.*

³ *Shih vendimin e GjEDNj-së, çështja “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, paragrafin 296 e vijues.*

⁴ *“[...] Sipas këndvështrimit të Gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin. Ajo vëren se këta anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj. Për më tepër, statusi i anëtarëve të KPK-së është i njëjtë me atë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Gjykata arrin në përfundimin se, duke pasur parasysh faktin se si KPK-ja, ashtu dhe KPA-ja ishin krijuar dhe formuar në një mënyrë legjitime, duke përmbushur kërkesat e një “gjykatë të krijuar me ligj”, kërkesja i ishte adresuar “Gjykatës”, sipas kuptimit të kushtit të parë të testit Vilho Eskelinen. Për këtë arsye, neni 6/1 i Konventës gjen zbatim nën aspektin civil të saj [...] Gjykata më tej përsërit: [...] se një organ, i cili nuk është klasifikuar si një nga gjykatat e vendit, për qëllimet e nenit 6/1, mund të klasifikohet brenda konceptit të një “gjykatë” në kuptimin material të kësaj shprehjeje. Sipas praktikës gjyqësore të vendosur të gjykatës, një “gjykatë” karakterizohet në atë kuptim thelbësor të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë, të vendosë për çështjet brenda kompetencës së saj në bazë të rregullimeve ligjore dhe pas procedurave të zhvilluara në një mënyrë të përcaktuar. Ajo gjithashtu duhet të përmbushë një sërë kushtesh të mëtejshme, “të tilla si pavarësia, në veçanti nga pushteti ekzekutiv, paanësia, kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të saj [...]”. Fuqia e vendimit buron nga vetë nocioni i “gjykatës” [...].*

Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, e vlerëson si një argument të zgjidhur tashmë nga jurisprudenca kontrolluese e kësaj gjykate, për pasojë e sheh të panevojshme të argumentojë më tej rreth këtij pretendimi.

15. Pretendimin se Komisioni ka qenë i njëanshëm, paragjykes, subjektiv dhe me diskrecion të pakufizuar, subjekti i rivlerësimit e bazon edhe në një sërë rrethanash objektive të çështjes konkrete. Sipas tij, ai është njohur vetëm në vendimin përfundimtar,⁵ me argumentin e pavërtetë të përdorur nga Komisioni në mospërfshirjen në analizën financiare të shumës prej 3.000.000 lekësh, të realizuar nga babai i tij, se kjo shumë është përdorur për mbulimin e shpenzimeve jetike të familjes me 5 (pesë) anëtarë, ndërkohë që familja e babait të tij, në vitet në fjalë, përbëhej nga 2 (dy) anëtarë. Një tjetër rrethanë, sipas tij, lidhet me faktin se, pavarësisht se shkresa e Bashkisë Libohovë është depozituar në Komision që me prapësimet, në muajin maj të vitit 2022, në rezultatet e hetimit të dërguara subjektit pas riçeljes së hetimit administrativ për kriterin e pasurisë dhe përfshirjen e dy kriterëve të tjera, në muajin korrik të vitit 2022, Komisioni ka pasur një vlerësim të ndryshëm për të ardhurat e realizuara nga babai i subjektit, mbi bazën e të njëjtave prova. Sipas tij, pavarësisht se në pamje të parë duket se qëndrimi i mbajtur në vendimin përfundimtar për këto të ardhura është favorizues ndaj subjektit, krahasuar me qëndrimin e mbajtur në rezultatet e hetimit pas riçeljes së hetimit, fakti që këto të ardhura nuk janë konsideruar të mjaftueshme për dhënien e huas, duke argumentuar me fakte që nuk i janë njoftuar subjektit [përballimi i shpenzimeve për familjen me 5 (pesë) persona], tregon që vendimmarrja e Komisionit ka qenë e paragjykuar.

15.1 Në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në drejtim të argumenteve të mësipërme, trupi gjykues vëren fillimisht se rrethana e pretenduar lidhet me qëndrimin e mbajtur nga Komisioni në paragrafin 1.45 të vendimit, mbi të ardhurat nga aktiviteti privat i babait për periudhën 2007 – 2009, sipas të cilit: “Nëse në funksion të një analize garantuese dhe shteruese, të ardhurat nga zdrukthëtaria për periudhën 2007 – 2009 do të konsideroheshin të ardhurat në shumën 3.000.000 lekë, përkatësisht 1.000.000 lekë në vit, siç referonte vërtetimi nr. {***}, i Bashkisë Libohovë, dhe nëse prej tyre do të zbriteshin shpenzimet jetike për të njëjtën periudhë, referuar numrit të anëtarëve të familjes së subjektit (5 anëtarë)⁶, pa llogaritur asnjë shpenzim tjetër, mundësia e kursimit të babait do të ishte e pamjaftueshme për të justifikuar dhënien hua të shumës prej 3.000.000 lekë, subjektit të rivlerësimit në vitin 2009”. Në funksion të këtij qëndrimi, lidhur me të ardhurat e babait, të kësaj periudhe, Komisioni ka arsyetuar,⁷ ndër të tjera, se: [...] Faktet e referuara në shkresën me nr. {***} prot., datë 21.04.2022, të Bashkisë Libohovë, e cila citon se: “Detyrimet tatimore dhe taksat vendore, të vendosura për çdo vit kalendarik nga Këshilli Bashkiak, janë paguar të gjitha në bazë të mandatarëtimeve dhe faturave të bankës dhe, si rrjedhojë, nuk rezultojnë të jetë debitor ndaj Bashkisë Libohovë”, nuk provohen me mandatpagesa apo fatura bankare e, megjithatë, trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin e të dhënave që ka administruar nga biznesi i babait, vlerësoi të marrë në konsideratë shkresën e mësipërme, që evidenton faktin se babai i subjektit nuk është debitor, dhe të vlerësojë si të ardhura të ligjshme të ardhurat nga vitet 2007 – 2009, të cilat në total shkojnë 3.000.000 lekë. Në përfundim, Komisioni, pasi ka analizuar burimin e deklaruar të të ardhurave të babait, Sh. R., nga aktiviteti privat për periudhën 2001 – 2009, ka arritur në konkluzionin⁸ përfundimtar se: [...] Subjekti nuk ka arritur të provojë ligjshmërinë e huas së dhënë nga prindërit, në shumën 3.000.000 lekë, në vitin 2009, ndaj dhe huaja e dhënë nga prindërit e subjektit në shumën

⁵ Subjekti i rivlerësimit ka cituar mendim pakice të vendimit të Kolegjit nr. 7 (JR), datë 25.09.2018.

⁶ Referuar certifikatës familjare, familja e subjektit përbëhet nga pesë anëtarë, tre fëmijët dhe prindërit.

⁷ Shih paragrafin 1.41 dhe 1.42 të vendimit.

⁸ Shih paragrafin 1.51 të vendimit.

3.000.000 lekë, në vitin 2009, nuk mund të përfshihet në analizën financiare, lidhur me pagimin e pasurisë së paluajtshme nga ana e subjektit të rivlerësimit, në vitin 2009”. Në analizën financiare të burimeve të krijimit të pasurisë “Apartament me sipërfaqe 119.3 m², Tiranë”, në vendim, kjo hua është përfshirë në shumën 0 lekë.

15.2 Nga aktet në fashikullin e hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se Komisioni, referuar deklaratimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting, që një ndër burimet që ka shërbyer për blerjen e pasurisë “Apartament me sipërfaqe 119.3 m², në Tiranë”, ka qenë edhe huaja verbale në shumën 3.000.000 lekë, e dhënë nga babai i tij, z. Sh. R.⁹, pa dhënë specifikime mbi burimin e të ardhurave të këtij të fundit, ka kryer verifikime në drejtim të ligjshmërisë së këtij burimi, duke kërkuar shpjegime shoqëruar me dokumentacion nga subjekti i rivlerësimit dhe informacion nga një sërë institucionesh publike¹⁰. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua nga babai, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të hollësishme gjatë hetimit administrativ, duke paraqitur ndër të tjera edhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.01.2020, të z. Sh. R., përmes së cilës konfirmohet huaja e dhënë dhe burimi i të ardhurave të tij nga puna në emigracion, nga aktiviteti privat si marangoz, si dhe nga vetëpunësimi në bujqësi. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës: “Subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues të ardhurat e krijuara nga emigracioni, nga puna në aktivitetin privat ‘marangoz’, nga puna në bujqësi për personin e lidhur, duke mos arritur të dokumentojë burimin e ligjshëm të huas marrë nga huadhënësi Sh. R., në shumën 3.000.000 lekë, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 119.3 m², në Tiranë”. Në kundërshtim të kësaj barre prove, subjekti i rivlerësimit ka dhënë sërish shpjegime të hollësishme mbi ligjshmërinë e të ardhurave nga aktiviteti privat i ushtruar nga babai dhe vetëpunësimi në bujqësi i prindërve të tij, duke parashtruar, ndër të tjera: “[...] Mjafton të përllogarisim fitimet vetëm për periudhën 2006 – 2009, pra 4 vite, dhe të ardhurat neto vjetore janë 4.000.000 lekë, duke tejkuluar shumën e dhënë hua prej 3.000.000 lekësh. Pa marrë këtu në konsideratë të ardhurat nga toka bujqësore (të shtrira në kohë që nga viti 1996), të cilat mbulojnë shpenzimet jetike të dy prindërve të mi [...]”. Me këto shpjegime, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur¹¹ edhe shkresën nr. {***} prot., datë 21.04.2022, të Bashkisë Libohovë, mbi aktivitetin privat si marangoz të babait të tij, z. Sh. R., dhe raport-analizën financiare të audituesit ligjor O. V., i cili, në vlerësimin e mundësisë financiare të z. Sh. R. për të dhënë huan në shumën 3.000.000 lekë, shprehet për shpenzime jetese të familjes së tij me 2 (dy) persona. Në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, në datën 11.05.2022, relatorja e çështjes i ka bërë sërish të njohur subjektit të rivlerësimit konkluzionin paraprak se ai nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait të tij nga emigracioni, nga puna si marangoz dhe nga bujqësia, dhe si rrjedhojë e kësaj, edhe mospërfshirjen në analizën paraprake të treguesve financiarë të huas, në shumën prej 3.000.000 lekësh. Pas riçeljes së hetimit administrativ për kriterin e pasurisë dhe përfshirjen në procesin e rivlerësimit edhe të dy kritereve të tjera, subjektit iu përcollën, më datë

⁹ Deklarimet e tij në deklaratën e pasurisë vetting lidhur me këtë hua, subjekti i rivlerësimit i ka shoqëruar me: AMTP-në nr. {***}, datë 29.07.1996, në emër të z. Sh. R.; vërtetim nr. {***}, datë 31.10.2014, i Bashkisë Libohovë; librezë kontributesh për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në emër të H. e Sh. R.

¹⁰ Shkresë nr. {***} prot., datë 30.01.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; shkresë nr. {***} prot., datë 30.01.2020, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore; shkresë nr. {***} prot., datë 30.01.2020, drejtuar Qendrës Kombëtare të Biznesit etj.

¹¹ Leje higjierno-sanitare nr. {***}, datë 09.01.1997, lëshuar nga Inspektorati Sanitar Shtetëror i Rrethit Gjirokastër, pas kontrollit në vendin e ushtrimit të aktivitetit “prodhime druri” të subjektit Sh. R.; kërkesë pa datë e ish-Kryetarit të Bashkisë Libohovë, drejtuar Korporatës Elektrike Gjirokastër, Dega Libohovë, lidhur me transferimin e kontratës së energjisë elektrike të z. Sh. R.; vërtetim nr. {***} prot., datë 15.04.2022, lëshuar nga institucioni financiar “{***}”, mbi kredinë e marrë nga z. Sh. R., në vitin 2003.

13.07.2022, rezultatet shtesë të hetimit, me konkluzionin paraparak: “[...] Për sa i përket mundësisë financiare të babait për t’i dhënë subjektit të rivlerësimit shumën prej 3.000.000 lekësh, në vitin 2009, nuk është arritur të provohet nga hetimi shtesë dhe provat e depozituara nga ana e subjektit të rivlerësimit mundësia financiare e babait të subjektit për dhënien e kësaj huaje”. Ky konkluzion paraparak është cituar nga relatorja e çështjes, edhe në seancën dëgjimore të datës 27.07.2022.

15.3 Për t’iu përgjigjur pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon të sjellë fillimisht në vëmendje se Komisioni në vendim, në funksion të konkluzionit të tij përfundimtar lidhur me huan e dhënë nga babai, se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë ligjshmërinë e huas, e për pasojë mospërfshirjen e saj në analizën financiare të blerjes së apartamentit në vitin 2009, ka mbajtur edhe një qëndrim garantist, duke konsideruar në kuadër të analizimit të mundësisë për kursim të babait të tij, si të ardhur të ligjshme shumën prej 3.000.000 lekësh, të realizuar nga aktiviteti privat në periudhën 2007 – 2009, megjithëse ka konstatuar se pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e kësaj periudhe nuk provohej me mandatpagesa apo fatura bankare. Në këtë analizë garantiste, nga e cila mundësia e kursimit të babait ka rezultuar sërish e pamjaftueshme për të justifikuar dhënien e huas në vitin 2009, trupi gjykues vëren se Komisioni ka dhënë detaje mbi shpenzimet e jetesës, duke i përlllogaritur ato për familje me 5 (pesë) anëtarë. Pavarësisht kësaj rrethane, trupi gjykues i Kolegjit, pasi e analizoi pretendimin e subjektit të rivlerësimit në kuadër të trajtimit të shkakut të ankimit që lidhet me themelin e çështjes së pasurisë në fjalë, trajtuar në paragrafët 48 e vijues dhe 49 të këtij vendimi, dhe efektin e saj në formën e gjykimit të kësaj çështjeje në Kolegji, sjell në vëmendje se kuadri kushtetues dhe ligjor, që normon procesin e rivlerësimit, konkretisht neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe neni 52 i ligjit nr. 84/2016, kanë përcaktuar qartë detyrimin që barra e provës në procesin e rivlerësimit i takon subjektit të rivlerësimit. Në zbatim të këtyre dispozitave, nga analizimi i situatës së fakteve të parashtruara më lart, trupi gjykues vëren se Komisioni, në bazë të detyrimeve të parashikuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ të provojë me dokumentacion justifikues ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer si burim për dhënien e huas nga babai dhe, në përfundim të hetimit administrativ, ka përmbushur edhe detyrimin tjetër ligjor, duke i kaluar atij barrën e provës në zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, mbi mungesën e provueshmërisë me dokumentacion ligjor të të ardhurave të pretenduara nga babai. Sërish, në përfundim të hetimit administrativ shtesë, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, mbi mungesën e provueshmërisë së mundësisë financiare të babait për dhënien e huas. Këto konkluzione paraprahe janë cituar edhe nga relatorja e çështjes, në dy seancat dëgjimore të zhvilluara në Komision. Pavarësisht se në rezultatet e hetimit, në përfundim të hetimit administrativ dhe në ato shtesë, Komisioni nuk ka dhënë detaje mbi mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës të familjes së z. Sh. R., trupit gjykues, referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti, në kundërshtim të barrës së provës, dhe raportit të analizës financiare të audituesit ligjor, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në mbështetje të këtyre shpjegimeve, i rezulton se ai ka qenë plotësisht i qartë, që pjesë e analizimit të mundësisë së kursimit të babait, Sh. R., është edhe përlllogaritja e shpenzimeve të jetesës së familjes së babait, duke cituar shprehimisht përlllogaritjen e tyre për familjen e tij me 2 (dy) anëtarë, por të pashoqëruar me akte të gjendjes civile mbi përbërjen familjare të z. Sh. R. Ndërkaq, i pyetur specifikisht nga Komisioni¹² mbi ndryshimet kronologjike që kanë ndodhur në gjendjen e tij civile,

¹² Me pyetjen nr. 3 të pyetësorit standard, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar: Lutemi deklaroni ndryshimet kronologjike që kanë ndodhur në gjendjen tuaj civile (familjare), nga data e marrjes së detyrës deri tani, duke përfshirë: ndryshimet në certifikatat familjare, martesë, fëmijë etj. Në përgjigjen e tij, subjekti ka deklaruar: “Nga data e marrjes së detyrës kam qenë i lidhur në martesë me bashkëshorten time V. R. Në datën 06.05.2007 ka lindur djali, L. R. Në datën 05.08.2013 ka lindur djali tjetër, E. R.

certifikatat familjare, nga data e marrjes së detyrës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nga data e marrjes së detyrës (tetor 2005) ka qenë i lidhur në martesë me bashkëshorten e tij, dhe më pas, në vitet 2007 dhe 2013, kanë ardhur në jetë edhe dy fëmijët, por pa qartësuar përbërjen familjare nga momenti i marrjes së detyrës, fakt që do të hidhte dritë edhe mbi përbërjen familjare të babait të tij. Lidhur me këtë fakt, nga një verifikim i akteve të gjendjes civile, të administruara në fashikull gjatë hetimit administrativ, trupit gjykues i rezultoi të jenë paraqitur¹³ nga subjekti i rivlerësimit 3 (tre) certifikata të familjes së tij në cilësinë e kryefamiljarit, përkatësisht të datave 17.01.2017, 30.01.2020 dhe 04.11.2020, sipas të cilave familja e tij rezultoi të përbërë nga 4 (katër) anëtarë, të tria të bazuara në të dhënat e Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile (në vijim “RKGC”), të vitit 2010¹⁴, si dhe certifikatë martese e datës 27.04.2021, sipas së cilës vërtetohet se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë në vitin 2005, nga të cilat nuk rezultoi të provuar përbërja e familjes së tij në periudhën 2007 – 2009, e as ajo e z. Sh. R. Në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se barra e provës, e kaluar subjektit të rivlerësimit, i ka dhënë atij mundësi të qartë për kundërshtimin e saj, për të paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për ligjshmërinë e të ardhurave të babait, dhe vlerësimin për mundësinë e tij për kursim, në analizë edhe të shpenzimeve të kryera prej tij për të përbërur kostot e jetesës, bazuar në përbërjen familjare që rezultoi në aktet e gjendjes civile, edhe në këndvështrim të kufijve të verifikimit të mundësisë për të krijuar me të ardhura të ligjshme pasurinë objekt huaje, për të cilën Kolegji, në vitin 2022, ka pasur jurisprudencë të konsoliduar.¹⁵ Përpos këtyre argumenteve, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, si në Komision, por edhe në Kolegj, ka pasur të njëjtën qasje lidhur me përllogaritjen e shpenzimeve jetike të familjes së z. Sh. R. për 2 (dy) anëtarë, të pashoqëruar me akte të gjendjes civile, pasi edhe pse pretendon se është njohur me këtë rrethanë në vendimin e Komisionit, përsëri nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor në Kolegj, sikurse do të analizohet në vijim të këtij vendimi, përbërjen dhe shpenzimet e familjes së z. Sh. R. në periudhën 2007 – 2009. Për më tepër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është kontradiktor lidhur me këtë çështje, pasi fillimisht në ankim pretendoi që familja e babait në këtë periudhë përbëhej nga 2 (dy) persona (nëna dhe babai),¹⁶ e më pas, në parashtrimet e depozituara pesë ditë para shqyrtimit të çështjes në Kolegj, pretendoi se familja e babait të tij në këtë periudhë përbëhej nga 3 persona (nëna, babai dhe e motra),¹⁷ duke u bërë i pabesueshëm në versionin e paraqitur prej tij, të pambështetur në akte të gjendjes civile, lidhur me këtë rrethanë të pretenduar si të rëndësishme për analizën e mundësisë financiare të z. Sh. R. për të mbuluar me burime të ligjshme shumën prej 3.000.000 lekë. Mbështetur në argumentet e mësipërme, si dhe në qëndrimin e mbajtur në vijim lidhur me aktet e depozituara me ankimin dhe parashtrimet në Kolegj, sipas të cilit këto akte, edhe nëse do të kalonin pengesat ligjore formale, nuk provojnë sa më lart pretendohet, trupi gjykues vlerësoi se subjektit të rivlerësimit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë, që do të afektonte parimin e procesit të

¹³ Këto akte janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit përkatësisht bashkëlidhur deklaratës së pasurisë vetting, përgjigjeve të pyetësorit standard dhe me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit.

¹⁴ Përbërja familjare sipas këtyre certifikatave është: Emiljano Ruli – kryefamiljar, V. R. – bashkëshortja, L. R. – i biri dhe E. R. – i biri.

¹⁵ Shih vendimet e Kolegjit 15 (JR), datë 17.06.2019 dhe 20 (JR), datë 31.07.2019.

¹⁶ Në paragrafin 115, faqe 23 të ankimit, subjekti i rivlerësimit shprehet: “[...] Vendimi i Komisionit është i gabuar për shkak se, në vitin 2007 – 2009, familja e babait përbëhej vetëm nga dy anëtarë (babai dhe nëna)”.

¹⁷ Në paragrafin 35, faqe 9, të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit shprehet: “[...] Nga viti 2003 deri në vitin 2009, familja Ruli ka qenë e përbërë nga 3 anëtarë (babai, nëna dhe motra, B. R.), pasi vëllai, E. R., në tetor të vitit 2003, ka qenë duke ndjekur studimet e larta Bachelor, periudha (2004 – 2006) dhe Master (Laurea Specialistica in Scienze Economiche), periudha (2006 – 2010), në Universita degli Studi di Cagliari, Itali, ku dhe aktualisht jeton së bashku me familjen e tij (ndërsa unë, subjekti i rivlerësimit, në tetor të vitit 2003, kam fituar Shkollën e Magjistraturës, ku dhe jam trajtuar me bursë mujore)”.

rregullt ligjor, e atillë që do të kërkonte korrigjimin e saj përmes kalimit për gjykim të çështjes në seancë gjyqësore publike.

15.4 Në drejtim të argumentit tjetër të subjektit të rivlerësimit për një vlerësim të ndryshëm të Komisionit në vendim, mbi të ardhurat e realizuara nga babai, mbi bazën e të njëjtave prova, në rastin konkret shkresës së Bashkisë Libohovë, trupi gjykues vlerëson se fakti që në vendim Komisioni ka konsideruar, bazuar në një qëndrim garantist, si të ardhur të ligjshme shumë prej 3.000.000 lekësh, megjithëse ka konstatuar se pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e z. Sh. R, në vitet 2007 – 2009, nuk provohej me mandatpagesa apo fatura bankare, nuk nënkupton një vlerësim të ndryshëm të tij lidhur me shkresën e Bashkisë Libohovë, nga ai i mbajtur në rezultatet e hetimit shtesë të datës 13.07.2022, sipas të cilit nuk provohej mundësia financiare e z. Sh. R për dhënien e huas, për sa kohë që në vendim nuk rezulton të ketë konkluduar për të kundërtën, pra që z. Sh. R ka pasur mundësi financiare për ta kursyer këtë shumë. Në këto rrethana, në vlerësimin e trupit gjykues, nuk mund të flitet për qëndrime të ndryshme të Komisionit mbi të njëjtën provë.

16. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: *Komisioni ka kryer shkelje të nenit 6 të Konventës, për shkak se ai nuk është dëgjuar drejtësisht, në kundërshtim me parimin e kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve.* Në mbështetje të këtij shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se: (i) Komisioni ka detyrimin ligjor që, në njoftimin mbi rezultatet e hetimit paraprak, t'i njoftojë subjektin në mënyrë të qartë se cila nga shkeljet ligjore, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, dyshohet se është kryer, argumentet ligjore dhe provat ku bazohen rezultatet e hetimit dhe vendimi. (ii) Komisioni nuk ka respektuar procedurën e vlerësimit të provave të paraqitura nga subjekti sipas kërkesave të nenit 48 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i kthyer seancat dëgjimore në seanca tërësisht formale, dhe nuk rezulton të jetë marrë vendim për administrimin ose jo të tyre. (iii) Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit pa arsyetuar se përse provat e paraqitura prej tij nuk kanë fuqi provuese, duke iu referuar konkretisht aktit të ekspertimit kontabël. (iv) Komisioni nuk ka vlerësuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit, as gjatë hetimit administrativ dhe as gjatë seancës dëgjimore, duke i mohuar të drejtën për t'u dëgjuar, për të prapësuar dhe për të paraqitur kundërgargumentet e tij në lidhje me konstatimet e Komisionit. (v) Në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se vetëm për subjektin që përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuri, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit, ndërkohë nuk rezulton që subjekti të jetë në kushtet e dyfishit të pasurisë. (vi) Personat që kanë hartuar analizën financiare nuk rezultojnë të jenë ekspertë kontabël dhe nuk identifikohen, ndërkohë që akti mbi bazën e të cilit është prodhuar rezultati financiar është i panjohur nga subjekti i rivlerësimit, sepse nuk ka shpjegime se si janë përcaktuar të dhënat në tabelat financiare.

16.1 Në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme, trupi gjykues, referuar nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, sjell në vëmendje se Komisioni ka detyrimin që, në përfundim të fazës së hetimit administrativ, t'i kalojë subjektin të rivlerësimit barrën e provës, pasi të ketë arritur në përfundimin se provat e mbledhura kanë mjaftueshëm nivelin e provueshmërisë për të mbështetur përfundimet paraprake¹⁸ dhe jo që ato të çojnë drejt prezumimit të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit. Nëse Komisioni do të kishte përcaktuar që me rezultatet e hetimit, referencën apo pasojën ligjore, ky fakt do të përbënte paragjykim të vendimit nga ana e Komisionit, që bazuar në nenin 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i zhvillon bisedimet për marrjen e vendimit pas zhvillimit të seancës dëgjimore.

¹⁸ Sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016: “2. Nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45, të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën”.

16.2 Nga verifikimi i procesit të rivlerësimit të zhvilluar në Komision, gjatë periudhës 16.12.2019 – 29.07.2022, në drejtim të zbatimit të parimit të kontradiktoritetit, trupi gjykues konstaton se mes Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit ka pasur një komunikim të ndërsjellë, përmes dërgimit të 4 (katër) pyetësorëve dhe dhënies së shpjegime respektive nga ana e subjektit të rivlerësimit. Më datë 12.04.2022, Komisioni i ka njoftuar subjektin të rivlerësimit rezultatet e hetimit administrativ lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë. Pasi është njohur me aktet e dosjes,¹⁹ subjekti ka paraqitur shpjegime dhe prova²⁰ për të kundërshtuar barrën e provës, ndër të tjera, edhe një raport analize financiare të audituesit ligjor, si dhe u dëgjua nga trupi gjykues në seancën dëgjimore të datës 11.05.2022. Pasi vlerësoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit, si dhe kërkesën e tij për riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera, trupi gjykues i Komisionit, me vendimin e datës 13.05.2022, vendosi riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë dhe për dy kriteret e tjera. Në zbatim të kësaj vendimmarrjeje, Komisioni, më datë 13.07.2022, i dërgoi subjektin rezultatet e hetimit administrativ shtesë. Pasi u njoh me aktet e hetimit administrativ shtesë,²¹ subjekti i rivlerësimit paraqiti sërish shpjegime dhe prova,²² si dhe u dëgjua nga trupi gjykues në seancën dëgjimore të datës 27.07.2022. Nga shqyrtimi i procesverbaleve të dy seancave dëgjimore, rezulton që, pas prezantimit të rezultateve të hetimit administrativ nga relatorja e çështjes, përveç faktit që subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësinë të kundërshtojë gjetjet e Komisionit, si dhe të japë shpjegime mbi faktet e provat e administruara, ai e ka mbyllur fjalën e tij, duke e konsideruar profesional angazhimin e trupit gjykues të Komisionit në kryerjen e hetimit administrativ. Bazuar në këtë analizë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, se i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar dhe për të prapësuar, vlerësohen se mbeten të pambështetura në prova e fakte.

16.3 Pretendimet se Komisioni nuk i ka bërë me dije provat, në të cilat janë mbështetur konkluzionet e nxjerra në rezultatet e hetimit, dhe se nuk ka vlerësuar provat e paraqitura prej tij, duke i kthyer seancat dëgjimore në seanca tërësisht formale, vlerësohen të pabazuara në fakte dhe prova. Kështu, nga shqyrtimi i përmbajtjes së rezultateve të hetimit, të datës 12.04.2022, rezulton të jenë referuar së bashku me parashtrimin e fakteve për secilën pasuri edhe provat e administruara, që kanë çuar drejt konkluzioneve respektive. Referuar vendimit të trupit gjykues, të datës 09.05.2022, rezulton se Komisioni ka caktuar seancën dëgjimore të datës 11.05.2022, pasi ka administruar provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së rezultateve të hetimit administrativ shtesë, të datës 13.07.2025, rezulton se në lidhje me kriterin e pasurisë, pas vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, atij i janë bërë të njohura konkluzionet që kanë të bëjnë me huadhënësin A. Z. dhe huadhënësin Sh. R. Për të parin, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka përmbysur barrën e provës lidhur me ligjshmërinë e huas prej 4.000.000 lekësh, ndërkohë që hetimi shtesë, referuar rezultatit paraprak, nuk ka mundur të ndryshojë pamundësinë financiare të babait, Sh. R, për dhënien e huas në vlerën 3.000.000 lekë. Në këto të fundit, megjithëse mungon një parashtrim i fakteve e i provave të mbledhura nga hetimi administrativ shtesë për pasurinë, nuk rezulton që subjektin të rivlerësimit t'i jetë mohuar njohja me to. Veç kësaj, nuk rezulton që Komisioni të ketë refuzuar ndonjë provë të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, rast për të cilin do të nevojitej një vendim i arsyetuar sipas nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016. Të gjitha faktet e parashtruara më sipër dëshmojnë se nga ana e Komisionit ka pasur një vlerësim paraprak të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe seancat dëgjimore nuk kanë qenë formale.

¹⁹ Deklaratë e datës 13.04.2022, për njohje dhe marrje të akteve.

²⁰ Prapësimet e subjektit, regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 04.05.2022.

²¹ Deklaratë e datës 14.07.2022, për njohjen dhe marrjen e akteve.

²² Prapësimet e subjektit, regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 22.07.2022.

16.4 Në vijim të analizës së mësipërme, referuar përmbajtjes së vendimit të Komisionit, trupi gjykues vëren se, për secilën pasuri të hetuar, parashtrohen rrethanat e faktit, ku pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur shpjegimet e subjektit dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ. Më tej, në rubrikën “Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara” parashtrohet në mënyrë të përmbledhur qëndrimi i subjektit dhe provat e paraqitura pas kalimit të barrës së provës. Në rubrikën “Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe ligjin e zbatueshëm” parashtrohet arsyetimi dhe vlerësimi ligjor i shpjegimeve e i provave të paraqitura, si dhe fakti nëse ato kanë mundur ose jo të përmbysin barrën e provës së Komisionit. Trupi gjykues sjell në vëmendje se Komisioni gëzon diskrecion ligjor për vlerësimin e provave sipas nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dhe se fakti që provat e depozituara nuk citohen në mënyrë analitike apo nuk vlerësohen në mënyrën e dëshiruar nga subjekti, nuk dëshmon që ka munguar analizimi apo vlerësimi i tyre nga ana e Komisionit. Sa i takon aktin të ekspertimit, të cituar nga subjekti i rivlerësimit në ankim, trupi gjykues vlerëson se raporti i analizës financiare të audituesit ligjor, i përpiluar në mënyrë të njëanshme sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit, për efekt të procesit të rivlerësimit, nëse nuk bazohet në dokumentacionin e administruar në fashikull, si dhe legjislacionin në fuqi, është jorelevant dhe i pabesueshëm për vendimmarrjen, e për sa kohë studimin e dosjes nga pikëpamja ligjore e financiare /ekonomike, Komisioni e kryen përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor. Trupi gjykues sjell në vëmendje se kjo njësi, e cila funksionon pranë Komisionit dhe Kolegjit sipas nenit 22, pika 1 dhe nenit 23 të ligjit nr. 84/2016, e përbërë nga këshilltarë ligjorë dhe ekonomikë, ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse, nëpërmjet studimit të dosjes gjyqësore, përgatitjes së relacionit përkatës me karakter kërkimor dhe analizues, si dhe asiston procesin e vendimmarrjes në institucionet e rivlerësimit. Këshilltari ligjor apo ekonomik nuk është një figurë procedurale e këtij procesi, dhe mosnjohja e identitetit të tij, nuk përbën shkak për cenimin e një procesi të rregullt ligjor.

16.5 Së fundi, trupi gjykues, në përputhje dhe me jurisprudencën e Kolegjit, lidhur me kërkesa të ngjashme në çështje të mëparshme, çmon se konstatimi i dyfishit të pasurisë së ligjshme është vetëm një nga rrethanat ligjore të parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016, vërtetimi i të cilave passjell shkarkimin nga detyra të subjekteve të rivlerësimit dhe secila prej situatave ligjore mund të zbatohet edhe veçmas. Në rastin konkret, trupi gjykues vëren se vlerësimi negativ dhe aplikimi i masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit rezulton të jetë derivat i konstatimit të deklaratimit të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, si një ndër rrethanat e kësaj dispozite, e cila, sikurse situata e dyfishit të pasurisë së ligjshme, çojnë drejt aplikimit të kësaj mase disiplinore.

17. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni ka kryer shkelje të nenit 7 të Konventës për shkak se është cenuar parimi i sigurisë juridike*. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se: (i) Komisioni e ka ngarkuar me një barrë prove të paarsyeshme, duke i kërkuar të justifikojë bindshëm të ardhurat e prindërve të tij, shumë vite më parë, apo të ardhurat nga toka bujqësore, në kushtet kur asnjë akt ligjor apo nënligjor nuk ka parashikuar mënyrën se si dokumentohen këto të ardhura. Subjekti është shkarkuar nga detyra për një “shkelje administrative”, e cila, edhe sikur të qëndrojë, nuk është kryer për faj të tij. (ii) Mosnjohja dhe moszbatimi nga organet e rivlerësimit të konceptit kushtetues të dyfishit të pasurisë cenon parimin e sigurisë juridike. (iii) Subjekti i rivlerësimit nuk mund të shkarkohet nga detyra nga një këshill disiplinor për pasaktësitë apo problemet që mund të konstatohen në deklaratat e interesave private vjetore, për më tepër të një periudhe më shumë se 10 vite më parë, në vitin 2009. (iv) Në vendimin e Komisionit janë përdorur koncepte të paqarta dhe të papërcaktuara në ligjin nr. 84/2016, si: “pasaktësi në deklarinimin e burimeve

financiare”, “deklarim të pamjaftueshëm të të ardhurave” dhe “deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë”.

17.1 Në vlerësim të këtyre pretendimeve, trupi gjykues sjell në vëmendje se, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 32 të ligjit nr. 84/2016, është subjekti i rivlerësimit që ka detyrimin për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së krijuar nga dhurime apo huamarrje të konfirmuar nga persona të tjerë të lidhur. Po kështu, edhe barra e provës²³ në procesin e rivlerësimit është e zhvendosur te subjekti i rivlerësimit, pra i përket këtij të fundit detyrimi për të provuar pretendimet e tij, duke paraqitur prova e fakte të nevojshme për këtë qëllim, si dhe për pamundësinë objektive të tij për t’i disponuar ato sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në rastin konkret, trupi gjykues konstaton se Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, barrën e provës për të provuar burimet e ligjshme të babait të tij, për dhënien e huas në vlerën prej 3.000.000 lekësh, e cila ka shërbyer si një ndër burimet e krijimit të pasurisë “apartament”, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në këtë kuptim, duke iu referuar përcaktimeve të neneve 30, 32, pika 4 dhe 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni, me të drejtë, në aplikim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar burimet e financimit të kësaj pasurie. Në kushtet kur, ndër burimet e kësaj huaje nga subjekti dhe personi tjetër i lidhur, deklarohet se kanë shërbyer të ardhura të prindërve nga aktiviteti privat si marangoz, toka bujqësore apo emigracioni, atëherë, me të drejtë, Komisioni, brenda diskrecionit të tij për veprimtarinë hetimore gjatë procesit administrativ, i pakushtëzuar nga kriteret ligjore kohore, në referim të dispozitave të sipërcituara, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës apo i ka kërkuar shpjegime mbi ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Pavarësisht këtyre argumenteve, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit në momentin e krijimit të pasurisë “*Apartament me sipërfaqe 119.3 m², rruga ‘{***}’, Tiranë*”, në vitin 2009, për të cilin si burim krijimi është deklaruar, ndër të tjera, edhe huaja e marrë nga babai, z. Sh. R, ka qenë subjekt deklarues²⁴ sipas ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, dhe si i tillë ka pasur detyrimin për të provuar me dokumentacion ligjor burimet financiare të ligjshme për krijimin e saj. Gjithashtu, sikurse shtjellohet në vijim të këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit duket se nuk është përpara një pamundësie objektive për të provuar me dokumentacion të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti privat i babait të tij, si marangoz, dhe nga toka bujqësore, por të mosdokumentimit të të ardhurave të ligjshme sipas legjislationit në fuqi.

17.2 Trupi gjykues çmon se, referuar edhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, lidhur me terminologjinë e paqartë të përdorur në ligjin nr. 84/2016, ku citohet: *[...] është detyrë e gjykatave ose organeve të tjera shtetërore e shoqërore, të ngarkuara me ligj, që mangësi të caktuara të një ligji t’i plotësojnë natyrshëm përmes interpretimit dhe zbatimit të tij në praktikë [...]*, përdorimi nga Komisioni i koncepteve të sipërcituara dhe kuptimi i dhënë atyre në vendim janë objekt vlerësimi dhe kontrolli nga ana e Kolegjit, sipas shkaqeve konkrete të ankimit lidhur me kriterin e rivlerësimit, të cilit i përkasin. Për rrjedhojë, vetëm fakti i përdorimit të këtyre togfjalëshave në vendimin e Komisionit, pa vlerësuar kontekstin në të cilin kanë gjetur përdorim, si dhe kuptimin që i ka dhënë Komisioni nëpërmjet arsytimit të tij, nuk vlerësohet i mjaftueshëm për t’u ngritur në nivelin e një shkaku ligjor, që mund të cenojë vlefshmërinë e vendimit të Komisionit. Për të mos rënë në përsëritje, për sa arsytuar më lart në lidhje me konceptin e dyfishit të pasurisë, trupi gjykues e gjen të pambështetur edhe pretendimin e subjektit për mosnjohjen dhe moszbatimin nga ana Komisionit të këtij koncepti në rrethanat juridike të rastit.

²³ Sipas parashikimeve të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, barra e provës në procesin e rivlerësimit i kalon subjektit të rivlerësimit.

²⁴ Në funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Shkodër.

18. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *Komisioni ka kryer shkelje të nenit 8 të Konventës për shkak se nuk është zbatuar parimi i proporcionalitetit*, pasi shkaqet e shkarkimit nuk janë relevante dhe as të mjaftueshme për të justifikuar masën disiplinore të shkarkimit, e cila ka sjellë pasoja të rënda në jetën profesionale të tij. I vetmi parashikim ligjor sipas subjektit, që ka të bëjë me parimin e proporcionalitetit, në ligjin nr. 84/2016, si dhe në Aneksin e Kushtetutës, është ai i dyfishit të pasurisë së ligjshme, i cili nuk zbatohet fare nga institucionet e rivlerësimit. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti ka parashtruar se, për shkak të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, ai ka humbur të gjitha mundësitë për punësim sipas kualifikimit dhe eksperiencës së tij profesionale, pasi nuk mund të ushtrojë për të gjithë jetën detyrën e prokurorit, gjyqtarit, noterit, avokatit apo funksione të tjera në administratën publike.

18.1 Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit,²⁵ sjell në vëmendje se parimi i proporcionalitetit i referohet vlerësimit në tërësi të çështjes dhe synon që masa disiplinore të jetë në raport të drejtë me shkeljen e kryer nga subjekti i rivlerësimit. Në rastin konkret, masa disiplinore, e dhënë ndaj subjektit të rivlerësimit, i atribuohet konkluzionit të Komisionit për deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, që përbën një ndër rrethanat ligjore të parashikuara nga neni 61 i ligjit nr. 84/2016. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit objekt ankimi, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se situata e përshkruar në vendim, mbi mungesën e burimeve të ligjshme financiare, në vlerën - 4.322.620 lekë, për të justifikuar pagesën e shumës 8.631.500 lekë, si pjesë e çmimit të apartamentit me sipërfaqe 119.3 m,² në rrugën “{***}”, Tiranë, dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara në harkun kohor 01.01.2009 – 12.11.2009, mbështet përfundimin e Komisionit për aplikimin e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, që lidhet me deklarimin e pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, referuar përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” të po këtij ligji. Ndonëse situata në lidhje me gjykimin e tri çështjeve me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{***}” ShPK u vlerësua e tillë nga trupi gjykues i Kolegjit që duhet të ishte adresuar në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, pamjaftueshmëria e mësipërme financiare, për periudhën 01.01.2009 – 12.11.2009, që i atribuohet vetëm kësaj pasurie, edhe pse e reduktuar në Kolegj në vlerën - 3.866.435 lekë, shoqëruar edhe me problematikën domethënëse në transaksionet e shitje-blerjeve të automjeteve, mbetet e tillë që nuk lejon zbatimin e parimit të proporcionalitetit. Edhe në një analizë garantiste të mundësisë së babait të subjektit të rivlerësimit, z. Sh. R, për dhënien e huas, për familjen me 4 (katër) persona, që afekton rezultatin financiar të mësipërm, sikurse do të arsyetohet në vijim të këtij vendimi, mungesa e burimeve të ligjshme do të ishte në vlerën - 3.357.227 lekë, e cila mbetet sërish e atillë që nuk do të lejonte zbatimin e këtij parimi.

18.2 Ndërkohë, sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se, si pasojë e masës së shkarkimit nga detyra, ai ka humbur çdo mundësi punësimi që përkon me kualifikimin dhe eksperiencën e tij profesionale, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje arsyetimin e GjEDNj-së lidhur me të njëjtat pretendime të shtruara përpara kësaj gjykate në çështjen “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, në të cilën arsyetohet se: *Në rrethanat e jashtëzakonshme që i paraprijnë miratimit të ligjit nr. 84/2016 [...], Gjykata konstaton se është në përputhje me frymën e procesit të rivlerësimit që të ketë një shkallë më të kufizuar sanksionesh, në rast se një person nuk arrin të përmbushë një nga tri kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 84/2016. Gjykata vëren më tej se, sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, shkarkimi i kërkueses nga detyra passjell një ndalim të përfundimtar për t’u rifitur në sistemin e drejtësisë. Në lidhje me këtë, Gjykata përsërit se gjyqtarët, dhe posaçërisht ata që zënë pozicione, që sjellin një shkallë të lartë përgjegjësie, siç janë pozicionet në të cilat kërkuesja dëshiron të rifillojë*

²⁵ Shih vendimet e Kolegjit nr. 2 (JR), datë 27.02.2020; nr. 20 (JR), datë 08.09.2020 dhe nr. 36 (JR), datë 16.12.2020.

punësimin, kanë një pjesë të pushtetit sovran të Shtetit. Ndalimi i përjetshëm i vendosur ndaj kërkueses dhe individëve të tjerë të shkarkuar, për shkak të shkeljeve të rënda etike nuk është në kundërshtim ose në raport të zhdrejtë me objektivin legjitim të ndjekur nga Shteti për të siguruar integritetin e detyrës gjyqësore dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë [...]. Kjo është veçanërisht e tillë në kontekstin kombëtar të konsolidimit të vazhdueshëm të shtetit të së drejtës. Duke pasur parasysh shkaqet e mësipërme, Gjykata vlerëson se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me shkarkimin nga detyra të kërkueses. Në referim edhe të jurisprudencës së GjEDNj-së, trupi gjykues e gjen shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit, për cenim të nenit 8 të KEDNj-së, të pabazuar në fakte dhe në ligj.

19. Për sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerësoi se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për shkelje të rënda procedurale dhe për shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor, gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, u gjetën të pabazuara në fakte dhe në ligj. Për rrjedhojë, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve.
20. Kërkesa e subjektit të rivlerësimit për marrjen në cilësinë e provës së akteve të paraqitura bashkëlidhur ankimit, të cituara në paragrafin 8 më lart, u analizua në këndvështrimin e dispozitës ligjore, që përligj pranimin e provave të reja në gjykimin administrativ të apelit, konkretisht nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, në vijim “ligji nr. 49/2012”. Nga analizimi i këtyre akteve, të paraqitura për herë të parë në Kolegji në mbështetje të pretendimit të trajtuar në paragrafët 48-50 këtij vendimi, për kundërshtimin e llogaritjes së shpenzimeve jetike të familjes së z. Sh. R, për 5 (pesë) persona, në periudhën 2007 – 2009, trupi gjykues vëren, fillimisht, se ato nuk rezultojnë të paraqitura tërësisht në formën e duhur ligjore²⁶ dhe nuk përmbushin kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, sa kohë që, siç arsyetuar më lart, subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të kundërshtonte barrën e provës së kaluar nga Komisioni, edhe në drejtim të shpenzimeve të jetesës, e për rrjedhojë, t’i paraqiste këto akte në Komision. Edhe në eventualitetin që këto akte do të ishin në formën e duhur ligjore, pavarësisht mosplotësimit të kriterit formal, sipas nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, vlerësuar edhe nën dritën e përcaktimeve të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të arsyetimit në paragrafin 15 e vijues më lart, ato nuk provojnë faktin e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit në ankim apo në parashtrimet se, për periudhën 2007 – 2009, shpenzimet e jetesës së familjes së babait të tij duhet të përlllogariten për 2 (dy) apo për 3 (tre) persona. Për këto arsye, trupi gjykues vlerësoi se marrja e këtyre akteve në cilësinë e provës është e panevojshme dhe e parëndësishme për vendimmarrjen e Kolegjit, në kuptim të nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.
21. Sa i përket akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet shtesë,²⁷ paraqitur pesë

²⁶ Diploma në emër të znj. B. R., e lëshuar nga Universiteti i Tiranës, është fotokopje, jo e njëzuar me origjinalin. Vërtetimi në gjuhën angleze për z. E. R., i lëshuar nga institucioni “Universita degli Studi di Padova”, Itali, rezultoi i palegalizuar me vulë apostile. Dokumenti në gjuhën italiane, i lëshuar nga institucioni “Universita degli Studi di Cagliari”, Itali, me gjasë, nga sistemi elektronik i këtij institucioni, në lidhje me z. E. R., rezultoi të jetë i papërkthyer në gjuhën shqipe dhe i palegalizuar me vulë apostile.

²⁷ (i) Kopje e kartës së identitetit të shtetasit E. R., lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Italisë, Bashkia Padova, më datë 15.05.2019, me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 23.05.2025; (ii) kopje e lejes së qëndrimit e shtetasit E. R., lëshuar nga Ministria e Brendshme, Departamenti i Sigurisë Publike, Stacioni i Policisë Padova, Itali, më

ditë para zhvillimit të seancës gjyqësore në Kolegj, trupi gjykues vlerësoi se ato nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara prej neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, sipas së cilave, deri pesë ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo prova të reja, ndaj, për këto arsye, nuk lejoi marrjen e tyre dhe i përjashtoi nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre provuese në zgjidhjen e çështjes.

22. Në përfundim edhe të analizës së mësipërme, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, mbi bazë të akteve, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

Në lidhje me “Apartament banimi 2+1, me sipërfaqe 119.3 m², rruga “{***}”, Tiranë

23. Komisioni ka arritur në konkluzionin²⁸ se: “Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë burimet financiare të ligjshme për pagesën e shumës 8.631.500 lekë, në datën 12.11.2009, pjesë e çmimit të apartamentit me sip. 119.3 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, dhe kryerjen e shpenzimeve të deklaruara dhe të evidentuara për periudhën 1.1.2009 – 12.11.2009, duke rezultuar me balancë negative në vlerën - 4.322.620 lekë dhe duke u ndodhur në kushtet e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
24. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në ankim konkluzionin e mësipërm, me pretendimin se balanca negative prej - 4.322.620 lekësh, për pagesën e apartamentit dhe kryerjen e shpenzimeve, ka rezultuar për shkak se në analizën financiare, në kundërshtim me provat e administruara, nuk janë përfshirë huaja në shumën 3.000.000 lekë, e marrë nga subjekti te babai i tij, si dhe shumat e tërhequra nga llogaritë bankare nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, në muajin dhjetor të vitit 2009.

I. Lidhur me burimin e krijimit “Shumat e tërhequra nga llogaritë bankare pranë Raiffeisen Bank ShA”

25. Komisioni ka konkluduar: “Bazuar në dokumentacionin e përcjellë nga Raiffeisen Bank ShA,²⁹ të administruar nga Komisioni, rezulton se në datën 23.12.2009, bashkëshortja e subjektit ka tërhequr cash nga llogaria e saj e pagës, në këtë bankë, shumën prej 700.000 lekësh. Gjithashtu, subjekti ka tërhequr nga llogaria e tij depozitë, në datën 28.12.2009, shumën prej 714.900 lekësh. Komisioni vlerëson se këto vlera monetare, të cilat nuk janë përfshirë në analizën për këstin e parë, duket se kanë qenë të mjaftueshme për shlyerjen e këstit të dytë të çmimit të blerjes së këtij apartamenti, në vlerën 368.500 lekë³⁰. [...] Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 01.01.2009 – 12.11.2009, për të evidentuar mundësinë financiare të subjektit dhe personave të lidhur për pagesën e shumës 8.631.500 lekë, në datën 12.11.2009, lidhur me mundësinë financiare të pagimit të çmimit të apartamentit me sip. 119.3 m², në rrugën “{***}”, Tiranë [...]”³¹”.

datë 05.05.2015, me vërtetim përktimi nr. {***}, datë 23.05.2025; (iii) kërkesë e subjektit të rivlerësimit dhe shkresë kthim përgjigje e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, me nr. {***} prot., datë 22.05.2025, origjinale, përmes së cilës përcillen të dhënat e sistemit TIMS mbi hyrje-daljet e shtetasit E. R.

²⁸ Shih paragrafin 1.105 të vendimit të Komisionit.

²⁹ Shkresë nr. {***} prot., datë 04.02.2020, nga Raiffeisen Bank ShA.

³⁰ Për të cilën nuk ka datë të saktë pagese.

³¹ Shih paragrafët 1.102, 1.103 dhe 1.104 të vendimit.

26. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *shumat e tërhequra nga llogaria e pagës së bashkëshortes, në Raiffeisen Bank ShA, në vlerën 700.000 lekë, dhe tërheqja nga llogaria e depozitës së tij, në vlerën 714.900 lekë, kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit të banimit (paguar në fund të muajit dhjetor, për të plotësuar vlerën totale të këstit të parë të apartamentit) dhe analiza financiare duhet të shtrihet deri në fund të vitit 2009, ndërsa shuma prej 368.500 lekësh duhet të përlllogaritet si detyrim në fund të vitit, dhe për efekt të kësaj analize, e shlyer në vitin 2010, në kushtet kur është provuar se çelësat e apartamentit nuk janë dorëzuar brenda vitit 2009, por në vitin 2010. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar argumentet si vijon:*
- (i) Tërheqja e këtyre shumave është deklaruar rregullisht, si në DIPP-në e vitit 2009, ashtu dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, si burim krijimi për blerjen e apartamentit.
 - (ii) Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka shpjeguar se ka rënë dakord verbalisht me administratorin e shoqërisë, që shuma prej 1.631.500 lekësh të paguhej pas maturimit të depozitave, me qëllim që të përfitoheshin edhe interesat bankarë të depozitave.
 - (iii) Kësti i fundit (i dyti) ishte një shumë e përlllogaritur mbi bazën e një % fikse, pagesa e së cilës ishte e lidhur me momentin e dorëzimit të çelësave të apartamentit. Pjesa tjetër e çmimit do të përfaqësonte këstin e parë të pagesës. Shuma prej 7.000.000 lekësh është siguruar nga dy huat e marra, kurse diferenca do të paguhej nga kursimet e ndodhura në llogaritë bankare.
 - (iv) Kontrata e porosisë është nënshkruar në mirëbesim dhe pagesa efektive është bërë në fund të vitit 2009, konfirmuar edhe nga administratori i shoqërisë ndërtuese. Kushtet e përcaktuara në kontratë kanë forcën e ligjit, por palët kanë gjithashtu lirinë të dakordësohen për ndryshimin e kushteve të saj, qoftë edhe verbalisht, për sa kohë mes tyre nuk ka mosmarrëveshje.
 - (v) Likuiditeti i tërhequr nga llogaritë bankare të tij dhe të bashkëshortes nuk është deklaruar si shtim i gjendjes *cash* në DIPP-në e vitit 2009, si burim për shtimin e ndonjë pasurie apo kryerjen e ndonjë shpenzimi tjetër.
 - (vi) Mosdeklarimi në DIPP-në e vitit 2009, i detyrimit ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, në vlerën 368.500 lekë, në kushtet e deklarimit të çmimit të plotë të apartamentit dhe shumës së paguar, është i karakterit formal, për shkak se detyrimi logjikisht rezulton i deklaruar. Kjo vlerë është paguar ashtu siç përcaktohet në kontratën e sipërmarrjes në momentin e dorëzimit të çelësave, dorëzim i cili është kryer realisht në vitin 2010.
 - (vii) Nuk mundet që të dhënat e përshkruara në kontratën noteriale të kenë më shumë vlerë provuese se tërësia e provave të tjera të administruara nga hetimi.³²
27. Nga kontrolli i arsytimit të vendimit,³³ trupi gjykues vëren se shumtat e tërhequra në llogaritë bankare pranë Raiffeisen Bank ShA, nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, përkatësisht në datat 23.12.2009 dhe 28.12.2009, nuk janë përfshirë në analizën e këstit të parapaguar, në vlerën 8.631.500 lekë, sipas kontratës së porosisë së datës 12.11.2009, por janë konsideruar nga Komisioni si burim krijimi për pagesën e këstit të fundit të çmimit të blerjes, në shumën prej 368.500 lekësh. Ky i fundit është përlllogaritur nga Komisioni³⁴ i shlyer në periudhën 13.11.2009 – 31.12.2009, mbështetur në: (i) parashikimin e kontratës së porosisë, sipas së cilës vërtetohet se para nënshkrimit të saj janë paguar 8.631.500 lekë dhe kësti i fundit, prej 368.500 lekësh, do të paguhet brenda datës 30.12.2009; (ii) DIPP-në e vitit 2009, në të cilën nuk deklarohen detyrime ndaj shoqërisë “{***}” ShPK në rubrikën

³² Subjekti ka referuar vendimet e Kolegjit nr. 19/2019 dhe nr. 20/2019.

³³ Shih paragrafët 1.92, 1.103 dhe 1.104 të vendimit.

³⁴ Shih paragrafin 1.101 të vendimit.

respektive; (iii) parashikimet e kontratës së shitjes së vitit 2020, e cila, në lidhje me likuidimin e çmimit të shitjes, i referohet kontratës së porosisë së vitit 2009.

28. Në shqyrtim të shkakut të ankimit në raport me konkluzionet e Komisionit, si më lart, nga aktet administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se:

28.1 Në deklaratën e pasurisë vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kontratë porosie për blerje apartamenti me sipërfaqe 119.3 m², me firmën ‘{***}’ ShPK, nr. {***} prot., datë 12.11.2009. Për pagesën e vlerës kam përdorur tërheqjen nga RFZ Bank, e llogarisë së pagës së b/shortes V. R., në vlerën 800.000 lekë, tërheqjen e depozitës sime, në vlerën 700.000 lekë, vlerë cash e grumbulluar nga kursimet në shumën 131.500 lekë, hua në shumën 4.000.000 lekë, dhënë nga shtetasi A. Z., me kontratën e huas me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.12.2009, hua verbale e dhënë nga babai, Sh. R, në shumën 3.000.000 lekë. Vlera 9.000.000, parapaguar shuma 8.631.500 lekë. 50% bashkëpronësi me bashkëshorten”. Bashkëlidhur kësaj deklaratë, subjekti ka depozituar kontratë “Porositje për blerje apartamenti” nr. {***} prot., datë 12.11.2009, me palë shitëse shoqërinë “{***}” ShPK, me objekt ndërtimin dhe premtimin e shitjes së apartamentit me sipërfaqe 119.3 m², rruga “{***}”, Tiranë”, me çmim shitjeje 9.000.000 lekë. Në nenin 3 të kontratës parashikohet se: *Blerësi ka parapaguar me këste vlerën prej 8.631.500 lekësh përpara nënshkrimit të kontratës. -- Blerësi do të paguajë këstin e katërt dhe të fundit, në vlerën prej 368.500 lekësh, me marrjen në dorëzim të sendit të ardhshëm, dhe nënshkrimin e autorizimit të dorëzimit të çelësave, parashikuar brenda datës 30.12.2009. -- Pagesat që do të kryhen nga blerësi do të vërtetohen me faturat e transfertave bankare. Më tej, në nenin 8, parashikohet se: *Shitësi impenjohet të përfundojë punimet e ndërtimit të sendit të ardhshëm dhe të dorëzojë me çelësa në dorë, pas nënshkrimit të autorizimit të marrjes në dorëzim të apartamentit me çelësa në dorë, të parashikuar brenda afatit prej 12 muajsh nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate. Në nenin 9, parashikohet se: “Shoqëria ‘{***}’ ShPK, mbas likuidimit të plotë të vlerës së apartamentit dhe pas firmosjes së autorizimit të marrjes në dorëzim të çelësave të sendit të ardhshëm, do të marrë të gjitha masat për regjistrimin e apartamentit në ZVRPP brenda një afati kohor prej 18 muajsh dhe hartimin e kontratës së shitblerjes”.**

28.2 Në deklaratën e interesave privatë periodikë (në vijim “DIPP”) të vitit 2009, deklarohet: “ [...] 3. Mbarimi i depozitës bankare, tërheqje cash e vlerës 714.300 lekë, nga numri i llogarisë 2700420792, me qëllim blerje apartamenti banimi. 4. Kontratë porositje për blerje apartamenti, nr. {***} prot., datë 12.11.2009, “{***}” ShPK. Vlera 9.000.000 lekë, parapagim 8.631.500 lekë. Pjesa takuese ½. [...] 7. Tërheqje cash në vlerë 800.000 lekë, nga llogaria e pagës së bashkëshortes, për blerje apartamenti. Në këtë deklaratë, nuk deklarohen detyrime financiare ndaj shoqërisë “{***}” ShPK.

28.3 Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së, në vitin 2014³⁵, subjekti ka deklaruar: “*paraqes kontratën e porosisë [...] për apartament me sipërfaqe 119.3 m² dhe vlerë 9.000.000 lekë, paguar përpara nënshkrimit të kontratës shumën 8.631.500 lekë, me këste. Për këtë pagesë kam përdorur tërheqjen nga RFZ Bank, e llogarisë së b/shortes, në shumën 800.000 lekë dhe të depozitës time në shumën 700.000 lekë, hua në shumën 4.000.000 lekë, me shtetasin A. Z., hua në shumën 3.000.000 lekë, nga babai Sh. R. Nuk disponoj mandatpagesat dhe as dokumente bankare, pasi pagesat janë bërë cash pranë shoqërisë së ndërtimit. Apartamenti nuk është hipotekuar, por i banueshëm është bërë nga mesi i vitit 2010 [...].*

³⁵ Procesverbali i mbajtur në ILDKPKI, në datën 07.11.2014.

28.4 Gjatë hetimit administrativ, lidhur me kohën dhe mënyrën e pagesës së shumës prej 8.631.500 lekësh dhe këstin e dytë, si dhe burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për këtë pagesë, subjekti ka shpjeguar³⁶: *Mënyra e pagesës ndaj shoqërisë “{***}” ShPK është bërë me para në dorë, pranë zyrave të shoqërisë, kjo në kushtet siç funksiononte tregu asokohe, si dhe kushteve të informalitetit të tregut. Duke qenë se vlera e likuiduar ka qenë shënuar në kontratë, nga shoqëria nuk më kujtohet nëse më është lëshuar apo jo dokument tjetër shtesë për pagesën. [...] Pra, shuma prej 7.000.000 lekësh i është paguar shoqërisë “{***}” SHPK përpara lidhjes së kontratës së porosisë. Me shoqërinë kemi rënë dakord verbalisht, që shumën prej 1.631.500 lekësh t’ia paguaja pasi të tërhiqja paratë nga llogaria bankare (depozitë me afat) pranë Raiffeisen Bank, si dhe nga llogaria e pagës së bashkëshortes, kjo pasi depozita me afat që kisha në bankë, nuk mund të tërhiqej pa u maturuar. [...] Kemi rënë dakord verbalisht në kushtet e mirëbesimit reciprok, që në kontratën e porosisë do të shënohej: “Blerësi ka parapaguar me këste vlerën prej 8.631.500 lekësh, përpara nënshkrimit të kontratës”, me qëllim që të evitonim bërjen e një kontrate tjetër. Ndërkohë, diferenca në shumën prej 1.631.500 lekësh i është paguar shoqërisë “{***}” ShPK, me sa më kujtohet, rreth datave 29 – 31.12.2009. Burimi i përdorur për këtë shpenzim, me sa më kujtohet, janë: (a) shuma 714.900 lekë, e tërhequr nga llogaria bankare (depozitë me afat) pranë Raiffeisen Bank, në datën 28.12.2009 [...]; (b) shuma prej 700.000 lekësh, tërhequr nga llogaria e pagës së bashkëshortes [...]; (c) shuma prej 100.000 lekësh dhe shuma prej 116.000 lekësh janë tërhequr gradualisht në vlera të vogla, gjatë vitit 2009 deri në momentin e blerjes [...].*

28.5 I pyetur në vijim, në lidhje me kohën dhe mënyrën e pagesës së kështit prej 368.500 lekësh, mosdeklarimin e tij në DIPP-në e vitit 2009, në rubrikën e detyrimeve, dhe burimin e krijimit, subjekti ka shpjeguar: *[...] Shuma e kështit prej 368.500 lekë, nuk është përfshirë në DVP 2009 [...], pasi nuk përcaktohej nga ligji i kohës si kredi, huamarrje, detyrim për studime. [...] Kjo shumë është paguar gradualisht ndër vite, me këste të vogla, të cilat ligji i kohës nuk i përcaktonte si shpenzime të deklarueshme (shuma e saktë dhe momentet kur janë paguar, nuk më kujtohen) dhe as kishte përcaktuar vlerën minimale të tyre. Burimi i të ardhurave i përdorur për këtë shpenzim, me sa më kujtohet, kanë qenë tërheqje periodike ndër vite nga llogaria bankare e pagesës sime dhe e bashkëshortes. Me shoqërinë kemi rënë dakord verbalisht në kushtet e mirëbesimit reciprok, që pavarësisht se në kontratën e porosisë do të shënohej se: “Blerësi do të paguajë këstin e katërt dhe të fundit, në vlerën prej 368.500 lekë (treqind e gjashtë dhjetë e tetë mijë e pesëqind lekë), me marrjen në dorëzim të sendit të ardhshëm, apartamentit dhe nënshkrimit e autorizimit të dorëzimit të çelësave, parashikuar brenda datës 30/12/2009”, pagesa e këtij kështi të bëhej nga ana jonë në çdo kohë dhe kur të kishim mundësi financiare, por gjithmonë para se të lidhej kontrata përfundimtare e shitjes. Lidhur me destinacionin e shumave të tërhequra në Raiffeisen Bank ShA, në datat 23.12.2009 dhe 28.12.2009, subjekti ka shpjeguar se destinacioni i këtyre shumave ka qenë pagesa e kështit të mbetur, prej 1.631.500 lekësh, e cila i është paguar shoqërisë “{***}” ShPK ... rreth datave 29 – 31.12.2009. [...].*

28.6 Më tej, lidhur me kohën e nisjes së banimit në këtë apartament, subjekti ka shpjeguar: *[...] Me sa më kujtohet, kam filluar të banoj fizikisht [...] nga muaji prill i vitit 2010 [...]. Me sa më kujtohet, përpara se të filloja të banoja, rreth muajve shkurt ose mars 2010, është lidhur kontrata tip për furnizimin me energji elektrike, ndërsa rreth muajit gusht 2010 është hapur kontrata tip me UK Tiranë, për furnizimin me ujë, nga ana e shoqërisë “{***}” ShPK. Këto kontrata nuk janë lidhur personalisht nga ana ime, por më janë dhënë nga administratori i pallatit, kur unë kam filluar të*

³⁶ Përgjigjet e pyetësorit nr. 3.

banoj, dhe vetëm nga ai moment kam filluar të paguaj detyrimet për energji elektrike dhe për furnizimin me ujë.

28.7 Në mbështetje të pretendimeve të mësipërme, subjekti ka paraqitur: (i) Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 24.11.2021, nga shoqëria “{***}” ShPK, e cila ka shpjeguar: *“Fillimisht është dakordësuar verbalisht dhe në mirëbesim për kryerjen e pagesës së parë, që përbënte vlerën më të lartë të çmimit të kontratës, dhe diferenca e shumës për të plotësuar vlerën e paraqitur në kontratë, për shkak të pamundësisë Tuaj për ta paguar në të njëjtin moment, do të paguhej nga ju më vonë, diku nga fundi i muajit dhjetor të vitit 2009. Ndërsa kësti i fundit, i cili ishte shumë më i vogël, do të paguhej nga ju në çdo kohë dhe kur të kishit mundësi financiare, por gjithmonë para se të lidhej kontrata përfundimtare e shitjes dhe jo në momentin e dorëzimit të objektit me çelësa në dorë. [...] Në lidhje me kontratën për furnizimin me energji elektrike dhe kontratën me UK Tiranë, për furnizimin me ujë, në atë kohë, shoqëria e ka pasur si praktikë pune të vetën, që për çdo njësi ndërtimore, lidhte kontratat respektive me UK Tiranë dhe OShEE, përpara se objekti të regjistrohej në ZVRPP, duke paguar paraprakisht detyrimet financiare, të cilat i kërkoreshin blerësve në momentin që njësia ndërtimore përkatëse i dorëzohej secilit prej tyre, me çelësa në dorë.* (ii) Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 23.11.2021, nga UKT ShA sipas së cilës në emër të Emiljano Ruli figuron kontrata me nr. {***}, e hapur në muajin gusht 2010, me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë. (iii) Kontratë e furnizimit me energji elektrike nr. {***}, në emër të Emiljano Ruli, e lidhur më datë 10.02.2010, me adresë: Godina {***}, Ap. {***}, në rrugën “{***}”, Tiranë.

28.8 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit,³⁷ subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar: *[...] Shuma prej 368.500 lekësh është paguar gradualisht ndër vite, me këste të vogla, të cilat ligji i kohës nuk i përcaktonte si shpenzime të deklarueshme. Me sa më kujtohet, në fund të vitit 2017, është paguar shuma prej 120.000 lekësh, në vitin 2018 është paguar shuma prej 100.000 lekësh, në vitin 2019 është paguar shuma prej 80.000 lekësh dhe në vitin 2020 është paguar diferenca 68.500 lekë. Edhe sikur t’i qëndrojmë strikt përcaktimit të bërë në kontratë, që e lidh pagesën e kështit të fundit me momentin e dorëzimit të çelësave, ndërsa me shoqërinë kemi rënë dakord që pagesa e kështit të fundit do të bëhet në momentin e regjistrimit të apartamentit në ZVRPP, përsëri, kësti i fundit prej 368.500 lekësh do të duhej të konsiderohej i paguar në vitin 2010, atëherë kur janë lidhur edhe kontratat e energjisë dhe ujit, dhe apartamenti është bërë funksional, momenti i dorëzimit me çelësa në dorë. [...] Kërkoj që shuma prej 368.500 lekësh të mos jetë pjesë e analizës financiare për vitin 2009. [...] Në tri deklarime,³⁸ në kohë të ndryshme me njëra - tjetrën, kam deklaruar qartësisht të njëjtin burim krijimi për blerjen e apartamentit. [...] Në kushtet kur në kontratë nuk janë përshkruar mandatarkëtimet e shoqërisë, kur nga ana tjetër shoqëria deklaroi se kontrata është nënshkruar në mirëbesim dhe pagesa efektive është bërë në fund të vitit 2009, nuk mund të merret apriori, se këto dy shuma të tërhequra nuk kanë shërbyer si burim për të vetmin fakt se data e tërheqjes është më shumë se një muaj mbrapa nga data e nënshkrimit të kontratës. [...] Kërkoj që shuma prej 1.631.500 lekësh të përfshihet në analizën financiare për vitin 2009, e cila është deklaruar dhe realisht përdorur për çmimin e blerjes së këtij apartamenti. [...].*

28.9 Subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve të mësipërme, ndër të tjera: (i) Kontratën e shitjes me

³⁷ Me rezultatet e hetimit, Komisioni i njoftoi subjektin konkluzionin paraprak: *“Bazuar në rrethanat dhe faktet e çështjes, tërheqjet e kryera nga subjekti në llogarinë e tij, në shumën prej 714.900 lekësh, në datën 28.12.2009, si dhe tërheqjet nga llogaria e personit të lidhur, bashkëshortes së tij, në shumën prej 700.000 lekësh, në datën 23.12.2009, për efekt të analizës financiare, nuk do të llogariten në pagesën e kështit të parë, pasi janë kryer pas lidhjes së kontratës”.*

³⁸ I referohet DIPP-së së vitit 2009, procesverbalit të mbajtur nga ILDKPKI-ja në datën 07.11.2014, si dhe deklaratës së pasurisë vetting.

nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.11.2020, të lidhur mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe Emiljano e V. Ruli, me objekt pasurinë e llojit “apartament me nr. pasurie {***} me sipërfaqe 106.70 m²”, në rrugën “{***}”, Tiranë, shoqëruar me vërtetim pronësie të datës 21.06.2019 dhe kartelën e pasurisë, e cila, në nenin 5, parashikon se: “*Shitësi deklaron se blerësi ka paguar paraprakisht të gjithë çmimin e shitjes së pasurisë së paluajtshme apartament objekt kontrate, në shumën prej 9.000.000 lekësh, sipas kontratë porositje për blerje apartamenti me nr. prot. {***}, datë 12.11.2009, shumë e përfituar totalisht nga blerësi.* (ii) Vërtetim pagese, datë 05.11.2020, lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK, sipas së cilës vërtetohet likuidimi i shumës prej 9.000.000 lekësh për blerjen e apartamentit. (iii) Certifikatë për vërtetim pronësie, e datës 20.11.2020, sipas së cilës kjo pasuri figuron e regjistruar në bashkëpronësi të Emiljano dhe V. Ruli. Pas riçeljes së hetimit administrativ, shoqëria “{***}” ShPK ka informuar Komisionin³⁹ se kjo shoqëri ka raportuar kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.11.2020, në vlerën 9.000.000 lekë, në datën 20.11.2020.

29. Nga analizimi i fakteve të parashtruara më lart, në përgjigje të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se shumata e tërhequra në Raiffeisen Bank ShA, në vlerat 700.000 lekë dhe 714.900 lekë, kanë shërbyer si burim për të plotësuar vlerën e kështit të parë të apartamentit dhe analiza financiare duhet të shtrihet deri në fund të vitit 2009, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë vetting, në DIPP-në e vitit 2009 dhe në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së, në vitin 2014, ndër burimet që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit, në vlerën 9.000.000 lekë, nga e cila është parapaguar shuma prej 8.631.500 lekësh, ka deklaruar edhe tërheqjen e dy shumave nga Raiffeisen Bank ShA, pa përcaktuar konkretisht vlerën e pagesës së apartamentit që do të mbulonin këto shuma. Gjatë hetimit administrativ dhe në ankim, subjekti ka pretenduar se destinacioni i këtyre dy tërheqjeve ka qenë pagesa e kështit të mbetur, prej 1.631.500 lekësh, nga kësti prej 8.631.500 lekësh (pasi ishte paguar para nënshkrimit të kontratës së porosisë, vlera prej 7.000.000 lekë), paguar rreth datave 29 – 31.12.2009. Pa u ndalur në fuqinë ligjore të kontratave noteriale lidhur me të dhënat e deklaruara në to, trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, rezulton se deklarimet e subjektit bien në kundërshtim me parashikimin e kontratës së porosisë së datës 12.11.2009, e cila parashikonte faktin që në këtë datë ishte parapaguar shuma prej 8.631.500 lekësh dhe jo 7.000.000 lekë, sikurse pretendohet prej tij. Në këto rrethana, si dhe nisur nga fakti që të dyja tërheqjet bankare të mësipërme janë kryer në data të mëvonshme nga data e kontratës së porosisë, përkatësisht më 23.12.2009 dhe 28.12.2009, në vlerësimin e trupit gjykues, në të njëjtën linjë me Komisionin, ato nuk mund të konsiderohen si burim krijimi për kështin në vlerën 8.631.500 lekë, i likuiduar përpara datës së nënshkrimit të kontratës, më 12.11.2009. Gjithashtu, referuar faktit që shumata e tërhequra në këto llogari nuk rezultojnë të jenë deklaruar si shtim likuiditeti *cash*-i në DIPP-në e vitit 2009, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, dhe formularit respektiv, sikurse Komisioni, do të konsiderohen në analizën financiare si të shpenzuara brenda vitit 2009⁴⁰. Në konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë se shumata e tërhequra nga Raiffeisen Bank ShA, në datat 23.12.2009 dhe 28.12.2009, përkatësisht në vlerat 700.000 lekë dhe 714.900 lekë, kanë shërbyer si burim për pagesën e kështit prej 8.631.500 lekësh, pjesë e çmimit total të apartamentit prej 9.000.000 lekësh, likuiduar përpara datës të lidhjes së kontratës së porosisë, më 12.11.2009.
30. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se shumata prej 368.500 lekësh duhet të përlllogaritet si detyrim në fund të vitit 2009 dhe, për efekt të kësaj analize, e shlyer në vitin 2010, në kushtet kur

³⁹ Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 16.06.2022, nga shoqëria “{***}” ShPK.

⁴⁰ Nga shumata e tërhequr, prej 1.414.900 lekësh, u konsiderua e përdorur për pagesën e kështit të katërt vlera prej 368.500 lekë. Pjesa e mbetur u konsiderua e shpenzuar.

është provuar se çelësat e apartamentit nuk janë dorëzuar brenda vitit 2009, por në vitin 2010, nga analiza e situatës së fakteve të parashtruar më lart, trupi gjykues evidenton disa të dhëna të ndryshme. Kështu, referuar DIPP-së së vitit 2009, kjo vlerë nuk rezulton e deklaruar si likuiditet *cash* në fund të vitit apo si detyrim ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, dhe formularit respektiv, dhe si e tillë prezumohet e paguar brenda datës 31.12.2009. Ndryshe nga kjo e dhënë, subjekti ka pretenduar gjatë hetimit administrativ, mbështetur edhe në konfirmimin e shoqërisë së ndërtimit, gjatë procesit të rivlerësimit, se kjo vlerë nuk është paguar në vitin 2009 për shkak të dakordësisë verbale mes palëve që të paguhej në disa vite, pa përcaktuar një kohë të saktë të kryerjes së pagesës, kushtëzuar nga mundësitë financiare të subjektit, por gjithmonë përpara nënshkrimit të kontratës së shitjes. Në përgjigje të barrës së provës, kjo vlerë deklarohet e paguar e shtrirë në vitet 2017, 2018, 2019 dhe 2020, ndërsa në ankim kërkohet të konsiderohet si detyrim në fund të vitit 2009, për sa kohë që është provuar se çelësat e apartamentit janë dorëzuar në vitin 2010. Krahas këtyre të dhënave, për mënyrën e pagesës së kësaj vlere rezulton edhe parashikimi i kontratës së porosisë se: *“Blerësi do të paguajë këstin e katërt dhe të fundit në vlerën prej 368.500 lekësh me marrjen në dorëzim të sendit të ardhshëm, apartamentit dhe nënshkrimit e autorizimit të dorëzimit të çelësave, parashikuar brenda datës 30.12.2009. – Pagesat që do të kryhen nga blerësi do të vërtetohen me faturat e transfertave bankare”*. Ndonëse sipas këtij parashikimi, përcaktimi i kohës së shlyerjes së vlerës së mbetur brenda datës 30.12.2009 është një parashikim mes palësh mbi mënyrën e shlyerjes së çmimit në të ardhmen për pjesën e mbetur pa paguar, përjashtuar *vlerën prej 8.631.500 lekësh, paguar përpara nënshkrimit të kontratës*, trupit gjykues nuk i rezulton ndonjë akt, i cili të kundërshtojë këtë parashikim kontraktor, qoftë ky një procesverbal për marrjen në dorëzim të apartamentit apo një autorizim për dorëzimin e çelësave, nga shoqëria e ndërtimit, në të cilin do të referohej data e saktë e dorëzimit të apartamentit, dhe as ndonjë dokument financiar mbi kryerjen e kësaj pagese, pra këstit të fundit, pas vitit 2009. Sa i takon lidhjes së kontratave të furnizimit me energji dhe ujë, përkatësisht në shkurt dhe në gusht të vitit 2010, ato mund të japin informacion mbi momentin kur detyrimet ndaj këtyre furnizuesve kanë filluar të faturohen në emër të subjektit të rivlerësimit. Në konkluzion të kësaj analize, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009 gjendje likuiditeti *cash* në fund të vitit apo detyrime ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, në mungesë të një akti që do të kundërshtonte parashikimin e kontratës së porosisë për dorëzimin e sendit brenda datës 30.12.2009, si dhe në kushtet që kontrata e shitjes, e datës 05.11.2020, lidhur me mënyrën e likuidimit të çmimit, i referohet kontratës së porosisë, trupi gjykues e gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit për ta konsideruar shumën prej 368.500 lekësh të shpenzuar në fund të vitit 2009.

II. Në lidhje me burimin “Hua në vlerën 3.000.000 lekë, të dhënë nga babai”

31. Komisioni ka konkluduar se: *Subjekti nuk ka arritur të provojë ligjshmërinë e huas së dhënë nga prindërit, në shumën 3.000.000 lekë, dhe si e tillë ajo nuk mund të përfshihet në analizën financiare si burim për blerjen e pasurisë së paluajtshme, në vitin 2009. Në arritjen e këtij konkluzioni, Komisioni ka arsyetuar: “Nga vlerësimi i situatës faktike financiare të prindërve të subjektit, trupi gjykues vlerëson se nga prindërit e tij nuk provohet se ata kanë pasur likuiditete gjendje për dhënien e huas subjektit. Ky konkluzion i trupit gjykues bazohet edhe në sa ka rezultuar nga hetimi administrativ lidhur me mundësinë financiare të babait të subjektit, e cila referuar huamarrjes së babait të subjektit në “{***}” dhe përqindjes së lartë të normës së kreditimit të përdorur për këtë huadhënie, nuk tregon një situatë financiare të tillë të babait të subjektit, që të mundësonte krijimin e likuiditeteve cash nga babai i subjektit, gjatë viteve 2003 – 2005. Përveç sa më sipër, trupi gjykues mban në konsideratë dhe: - mungesa e të dhënave në sistemin bankar, lidhur me mundësitë e kursimit*

të prindërve të subjektit; - mungesa e provueshmërisë, lidhur me mënyrën e përfitimit/transaksionin e kryer, i cili nuk rezulton i provuar në ndonjë formë; - mungesa e provueshmërisë, lidhur me mënyrën e shlyerjes/transaksionin e kësaj huaje, e cila nuk rezulton e shlyer nga subjekti për një periudhë 10-vjeçare. Këto fakte nuk krijojnë bindjen mbi mundësinë financiare të babait për dhënien e huas së pretenduar”. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, duke parashtruar në ankim disa pretendime që trajtohen në vijim:

32. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se: *Huaja e marrë nga babai ka qenë verbale, e cila, për shkak të marrëdhënies familjare dhe të besueshmërisë, nuk është dokumentuar me shkrim. Edhe neni 1050 i Kodit Civil nuk kërkon që veprimi juridik i dyanshëm, siç është kontrata e huas, të jetë formale (me shkrim) dhe as solemne (me akt noterial). Marrja e kësaj huaje është deklaruar rregullisht në të gjitha deklaratat e interesave privatë periodikë dhe në deklaratën vetting, dhe konfirmohet e provohet katërcipërisht edhe nga deklaratat noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.01.2020, e lëshuar nga babai, Sh. R. Prindërit e subjektit, që prej vitit 2014, jetojnë në ShBA, ku nëna e tij tashmë është qytetare amerikane dhe, për shkak të situatës së mirë financiare, nuk kërkojnë kthimin e huas derisa të kthehen në Shqipëri. Në kushtet kur huaja është pa afat, sipas nenit 1050 të Kodit Civil, ajo kthehet me kërkesë të huadhënësit.*
33. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit, në drejtim të marrëdhënies së huas mes tij dhe babait, trupi gjykues, nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, si dhe nga kontrolli i arsyetimit në vendim, konstaton dhe vlerëson si më poshtë:

33.1 Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit në deklaratën e pasurisë vetting dhe në deklaratat e dorëzuara ndër vite pranë ILDKPKI-së rezulton se: (i) Në deklaratën e pasurisë vetting, si një ndër burimet e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 119.3 m², në Tiranë, deklarohet edhe hua verbale e dhënë nga babai, Sh. R, në shumën 3.000.000 lekë. Kjo hua është deklaruar edhe në rubrikën “Detyrimet financiare” të kësaj deklarate, si: *“Hua ekzistuese pa afat e dhënë nga babai Sh. R., në vlerën 3.000.000 lekë, me qëllim blerjen e apartamentit të banimit. Nuk është shlyer asnjë shumë. Detyrimi ekzistues 3.000.000 lekë”*. (ii) Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar *“Hua pa afat, në vlerë 3.000.000 lekë, e dhënë nga babai, Sh. R, me qëllim blerje apartament banimi”*. (iii) Edhe në DIPP-të e viteve 2010 – 2016, huaja është deklaruar në të njëjtën mënyrë dhe e marrë për të njëjtin qëllim, si dhe me detyrim të mbetur pa shlyer në vlerën 3.000.000 lekë. (iv) Në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së, në datën 07.11.2014⁴¹, i pyetur mbi burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e kësaj huaje, subjekti ka deklaruar: (a) të ardhurat nga emigracioni në Greqin në vitet 1990 – 1996 ; (b) të ardhura nga aktiviteti si person fizik “marangoz”, në Libohovë, në periudhën 1996 – 2014; (c) të ardhura nga vetëpunësimi në bujqësi.

33.2 Gjatë hetimit administrativ, për të provuar marrëdhënien e huas me babain e tij, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur⁴² deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.01.2020, të z. Sh. R, i cili konfirmon faktin se, në vitin 2009, i ka dhënë djalit të tij, Emiljano Ruli, hua verbale pa interes, në shumën 3.000.000 lekë, me qëllim plotësimin e vlerës prej 9.000.000 lekësh, për blerjen e apartamentit nga shoqëria “{***}” ShPK, duke deklaruar: *“Këtë shumë parash, unë e kam siguruar nga të ardhurat e fituara në shtetin grek, në periudhën 1991–1996, ku kam qenë i punësuar sezonal informal; nga të ardhurat e fituara nga periudha 1996 e në vijim, nga biznesi që kisha, “marangozi”, të cilin e kam pasur të regjistruar në Bashkinë Libohovë, si biznes i vogël dhe ku kam paguar taksat*

⁴¹ Procesverbal i pyetjes pranë ILDKPKI-së, datë 07.11.2014.

⁴² Bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit standard dhe përgjigjeve të pyetësorit nr. 2.

vendore pranë kësaj bashkie, si dhe nga të ardhurat e fituara së bashku me bashkëshorten time, H. R., si të vetëpunësuar në bujqësi, ku kemi kultivuar dhe më pas shitur prodhime të ndryshme bujqësore, në tokën të cilën e kemi përfitur me ligjin nr. 7501, “Për tokën”. Deklaroj se huan verbale pa interes, djalit tim, Emiljano Ruli, ia kam dhënë pa afat kthimi dhe nuk e kam dokumentuar/formalizuar me akt noterial. [...]. Në përfundim të hetimit administrativ, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit,⁴³ subjekti i rivlerësimit ka sjellë në vëmendje faktin se marrëdhënia e huas me babain është deklaruar rregullisht prej tij që në DIPP-në e vitit 2009, në deklaratën e pasurisë vetting, dhe në të gjitha deklaratat e tjera, për sa kohë që nuk është shuar ende.

34. Në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga kontrolli i arsytimit në vendim, trupi gjykues vëren se mungesa e provueshmërisë së transaksionit të dhënies së kësaj huaje, si dhe mosshlyerja e saj për një periudhë 10-vjeçare, janë renditur nga Komisioni ndër rrethanat⁴⁴ që kanë çuar drejt bindjes se babai i subjektit nuk ka pasur mundësi financiare për dhënien e saj.⁴⁵ Në këtë drejtim, nga analizimi i situatës së fakteve të parashtruara më lart, pavarësisht pretendimeve të subjektit të rivlerësimit mbi formën e marrëdhënies së huas nga pikëpamja formale, trupi gjykues e gjen të drejtë konstatimin e Komisionit mbi mungesën e provueshmërisë së transaksionit në momentin e dhënies së huas dhe mosshlyerjen e saj nga ana e subjektit të rivlerësimit, të paktën për një periudhë 10-vjeçare. Kjo rrethanë, e vlerësuar në mënyrë harmonike me pamundësinë financiare të babait të subjektit të rivlerësimit për dhënien e huas, si dhe rrethanat e tjera të renditura nga Komisioni në paragrafin 1.48 të vendimit, duhet të ishin vlerësuar prej tij edhe në drejtim të besueshmërisë së ekzistencës së marrëdhënies së huas me z. Sh. R, pavarësisht konfirmimit të prindërve përmes deklaratës noteriale të vitit 2020, të hartuar për qëllime të procesit të rivlerësimit.
35. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim, se babai i tij ka pasur të ardhura të ligjshme dhe të mjaftueshme për dhënien e huas në vitin 2009, me burim nga: (i) të ardhurat e fituara nga periudha 1996 e në vijim, nga aktiviteti tregtar si “marangoz”, i regjistruar si biznes i vogël në Bashkinë Libohovë, në të cilën janë paguar edhe detyrimet tatimore; (ii) të ardhurat e fituara si i vetëpunësuar në bujqësi, në tokën e përfitur me ligjin nr. 7501, “Për tokën”; (iii) të ardhurat e babait si emigrant informal në shtetin grek, në periudhën 1991–1996. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për secilin prej burimeve të krijimit, analizohen si më poshtë:

Të ardhura nga aktiviteti privat i babait si “marangoz”, nga periudha 1996 e në vijim

36. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni duhet të kishte konkluduar se babai i subjektit ka siguruar të paktën 1.000.000 lekë të ardhura të ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, gjatë viteve 2001 – 2008, ashtu siç është përlllogaritur edhe në aktin e audituesit ligjor. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përmbledhur, ka argumentuar se:

36.1 Babai i tij ka ushtruar aktivitetin tregtar si “marangoz” edhe përpara vitit 2001, por për shkak të kushteve social-ekonomike të Shqipërisë dhe mënyrës se si administrohej dokumentacioni përpara vitit 2001, ka qenë e pamundur të sigurohen akte në organet tatimore për zhvillimin e këtij aktiviteti tregtar. Një fakt i tillë, sipas subjektit, vërtetohet edhe nga leja higjieno-sanitare e vitit 1997 dhe kërkesa e ish-Kryetarit të Bashkisë Libohovë, drejtuar Korporatës Elektrike Gjirokastër.

36.2 Në vitin 2001, në momentin e regjistrimit si person fizik me kod fiskal, për ushtrimin e aktivitetit

⁴³ Subjekti i ka kaluar barra e provës “duket se subjekti ka mungesë të dokumentacionit ligjor që provon dhënien e huas nga huadhënësi Sh.”.

⁴⁴ Shih paragrafin 1.48 të vendimit.

⁴⁵ Shih paragrafin 1.49 të vendimit.

të artizanit (marangozit), i vetmi detyrim që përcaktohet nga ligji nr. 8313, datë 26.03.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, për kategorinë e ambulantëve me qarkullim deri në 2.000.000 lekë, ku përfshiheshin edhe marangozët, ka qenë taksa vendore e biznesit të vogël, me kuotë fikse. Në këtë vit, vetë Bashkia duhet të kryente regjistrimin dhe ta pajiste babain e tij me NIPT, ndërkohë që mënyra e veprimeve për regjistrim ose reregjistrim përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave.⁴⁶

36.3 Për vitet 2003, 2004 dhe 2006, Komisioni pranon realizimin e të ardhurave nga aktiviteti i babait të subjektit të rivlerësimit, por në mënyrë të gabuar ka argumentuar se për to janë paguar vetëm taksat në Bashki dhe jo tatimet, ndërkohë që ai ka përmbushur shlyerjen e detyrimeve sipas kategorisë së biznesit të vogël, si artizan, me qarkullim deri në 2.000.000 lekë. Në këto vite, biznesi i vogël duhet të paguante taksën vendore të biznesit të vogël, e cila është një kuotë fikse vjetore, që parashikohej nga ligji nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, dhe paguhej në bashki, si dhe tatimin mbi fitimin e thjeshtuar të biznesit të vogël, sipas ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’”, i ndryshuar, tatim nga i cili përjashtoheshin ambulantët në fushën e tregtisë dhe të shërbimeve, e për këto arsye, mosregjistrimi në organin tatimor dhe mospajisja me NIPT, nga viti 2003 deri në vitin 2010, nuk ka shmangur asnjë detyrim tatimor, sepse kategoria e biznesit ku ka vepruar babai i tij, paguan taksa në Bashki dhe ka qenë e përjashtuar nga tatimi i thjeshtuar i fitimit. Pavarësisht se babai i tij ka pasur një vend për ushtrimin e veprimtarisë artizane të tij, të ardhurat i ka realizuar nga shitja në tregjet e Bashkisë Libohovë, pa një vend fiks të shitjes së produkteve artizanale.

36.4 Mosregjistrimi në Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastër dhe mospajisja me NIPT, nga viti 2003 deri në vitin 2010, është e karakterit formal dhe nuk ka sjellë si pasojë shmangien e ndonjë detyrimi tatimor. Përveç se mosregjistrimi është i karakterit formal, ky mosregjistrim ka ndodhur edhe për shkak të mosveprimit të organeve shtetërore, të cilat nuk kanë realizuar procedurën për regjistrimin e babait të tij dhe në organet tatimore, dhe se problematikat në administrimin e dokumentacionit nga organet shtetërore, nuk duhet të rëndojnë mbi subjektin e rivlerësimit, referuar edhe vendimit nr. 14/2021,⁴⁷ të Kolegjit.

36.5 Komisioni ka njohur të ardhurat e vitit 2006 – 2009, për shkak se provohej pagesa e detyrimeve tatimore, pavarësisht regjistrimit ose jo në Drejtorinë përkatëse Tatimore Gjirokastër.

37. Në shqyrtim të shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit në drejtim të argumenteve të mësipërme, trupi gjykues mori në analizë aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, nga të cilat konstaton sa vijon:

37.1 Për të vërtetuar të ardhurat nga aktiviteti privat i babait, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting* vërtetimin nr. {***}, datë 31.10.2014, të Bashkisë Libohovë, sipas të cilit: “*Sh. Sh. R., i datëlindjes 05.06.1957, banor i qytetit Libohovë, ka qenë emigrant në Greqi nga viti 1990 deri në vitin 1996. Në vitin 1996 është kthyer në Shqipëri, ku ka hapur biznes privat (marangoz), është regjistruar si biznes i vogël pranë kësaj bashkie, dhe ka shlyer detyrimet tatimore në*

⁴⁶ Subjekti ka referuar udhëzimin nr. 1, datë 12.01.2007, “Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulant, si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”.

⁴⁷ Në këtë vendim, Kolegji ka arsyetuar: “27. [...] Trupi gjykues vlerësoi që në kuadër të parimit të objektivitetit në gjykim, problematikat në ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit nga organet shtetërore, nuk duhet të rëndojnë mbi subjektin e rivlerësimit, për sa kohë nga procesi i rivlerësimit nuk u evidentuan gjetje në drejtim të veprimeve të qëllimshme nga ana e subjektit të rivlerësimit lidhur me sa më sipër”.

mënyrë të përvitshme deri në qershor të vitit 2014, vit kur ka ikur në ShBA. Nga biznesi i tij privat kanë realizuar të ardhura vjetore mesatare rreth 1.000.000 lekë në vit”[...].

37.2 Nga informacioni i administruar në dosjen e ILDKPKI-së, përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër⁴⁸ (në vijim “DRT Gjirokastër”), rezulton se z. Sh. R është i regjistruar pranë këtij institucioni si person fizik, me NIPT {***}, më datë 14.02.2011, me aktivitet “Fabrikimi i artikujve në dru, që përdoren në ndërtim (trarë, dritare, dyer etj.)”, nuk ka detyrime tatimore, nuk ka deklaruar xhiro dhe fitim, dhe nuk ka deklaruar tatim dividendi. I njëjti informacion është përcjellë nga DRT-së Gjirokastër⁴⁹ edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, me shpjegimin se: *Subjekti figuron me status “kërkesë për çregjistrim” që prej datës 12.03.2015. Pas verifikimit në sistemin informatik tatimor C@TS për këtë subjekt, rezulton se është i ngarkuar me këto përgjegjësi tatimore: 2100, kontributet shoqërore; 1900, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; 1200, tatim i thjeshtuar mbi fitimin. Detyrimet në kohë reale deri më datë 25.02.2020 janë 0 (zero) lekë. Subjekti rezulton me deklarata të munguara prej datës 14.02.2011, që është data e regjistrimit të subjektit dhe deri më datë 12.03.2015, kur subjekti ka kaluar me status “Kërkesë për çregjistrim”. Edhe nga informacioni i përcjellë në Komision nga QKB⁵⁰-ja konfirmohet fakti se Sh. R rezulton i regjistruar si person fizik më datë 14.02.2011, për aktivitetin “marangoz”, me adresë të ushtrimit të aktivitetit “Godinë njëkatëshe në qendër të qytetit”.*

37.3 Në përfundim të hetimit administrativ, referuar të dhënave të përcjella nga organet tatimore, sipas të cilave Sh. R ka regjistruar aktivitetin tregtar si biznes i vogël në vitin 2011, pra dy vite mbas dhënies së huas, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës se: *subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor provues të ardhurat e krijuara nga puna e babait në aktivitetin privat “marangoz”. Në kundërshtim të kësaj barre prove⁵¹, subjekti ka deklaruar: [...] Aktiviteti i ushtruar nga prindërit ka qenë artizanal/ambulant, konkretisht, për babanë, i cili ka qenë marangoz, pavarësisht se ka qenë i regjistruar si biznes dhe ka pasur një vend ushtrimi të aktivitetit, kryesisht ka prodhuar artikuj druri me porosi [...] artikuj, të cilët, në të shumtën e rasteve, shiteshin në fshat dhe në fshatrat përreth, me porosi dhe/ose në tregjet e komunës [...]. Sipas nenit 6, pika 4⁵² e ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore mbi biznesin e vogël”, regjistrimi i babait tim si shitës ambulant, pa vend fiks të ushtrimit të aktivitetit, duhet të ishte bërë nga organi kompetent tatimor. [...] Në rastin konkret, mosregjistrimi i babait tim që në vitin 2001 pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Gjirokastër, por regjistrimi i tij vetëm pranë Bashkisë Libohovë, duhet të vlerësohet nga institucioni sipas nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, dhe nuk duhet të sjellë pasoja negative në drejtim të barrës së provës që më ngarkon ligji, për të vërtetuar burimet e ligjshme të të ardhurave [...].*

37.4 Në mbështetje të shpjegimeve të mësipërme, subjekti ka paraqitur shkresën nr. {***} prot., datë 21.04.2022, të Sektorit të Tatim-Taksave të Bashkisë Libohovë, përmes të cilës informohet se: “Në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ‘Për sistemin e taksave vendore’, neni 12, pika 4, ‘Për regjistrimin e taksapaguesit nga Bashkia’, subjekti privat, z. Sh. R, në bazë të dokumentacionit që disponon Zyra e Tatim-Taksave pranë Bashkisë Libohovë, rezulton se ka filluar aktivitetin në vitin 2001. Është regjistruar pranë regjistrimit të subjekteve private të Bashkisë Libohovë në muajin janar të vitit 2001, në cilësinë e

⁴⁸ Shkresat nr. {***} prot., datë 04.07.2017, nr. {***} prot., datë 14.07.2017 dhe nr. {***} prot., datë 16.08.2017.

⁴⁹ Shkresë nr. {***} prot., datë 27.02.2020, e DRT-së Gjirokastër.

⁵⁰ Shkresë nr. {***} prot., datë 20.02.2020, e QKB-së.

⁵¹ Shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 04.05.2022.

⁵² Në këtë nen përcaktohet se: “Kur taksapaguesi nuk regjistrohet ose reregjistrohet në kohën e duhur, ai regjistrohet nga organi tatimor. Ky regjistrim ka të njëjtin efekt me regjistrimin ose reregjistrimin e bërë nga taksapaguesi dhe shoqërohet me sanksione, sipas nenit 12, pika 1.a e këtij ligji”.

statusit person fizik “marangoz”. Xhiroja vjetore që ka qenë e deklaruar prej tij, ka qenë në vlerën 2.000.000 lekë në vit; niveli i taksave vendore është pasqyruar në aktdetyrimet për çdo vit kalendarik, sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Subjekti ka paguar tatimin si biznes i vogël, sipas përcaktimit të bërë për nivelin e taksimit të biznesit të vogël, për bashkitë e kategorisë së tretë (Bashkia Libohovë është e tillë), në masën 20.000 lekë në vit, mbi bazën e xhiros vjetore të deklaruar prej 2.000.000 lekë. Po kështu, edhe detyrimet tatimore për taksat vendore të vendosura për çdo vit kalendarik nga Këshilli Bashkiak janë paguar të gjitha në bazë të mandatarkëtimeve dhe faturave të bankës dhe, si rrjedhojë, nuk rezulton të jetë debitor pranë Bashkisë Libohovë. Edhe pas regjistrimit të tij si subjekt fiskal në vitin 2011 pranë DRT-së Gjirokastër, ku dhe është pajisur me NIPT, ai ka vazhduar të jetë i regjistruar pranë regjistrit të subjekteve private të Bashkisë Libohovë, ku ka deklaruar xhiro vjetore në vlerën 2.000.000 lekë në vit, dhe ka paguar rregullisht tatimin si biznes i vogël, si dhe detyrimet tatimore vendore pasqyruar në aktdetyrimet për çdo vit kalendarik, sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak”. Bashkëlidhur kësaj shkrese përcillen aktet si vijojnë:

i. Kopje e fletës së regjistrit të evidencës së tatimpaguesve, “Pasqyrë progresive e subjekteve private që janë të regjistruar dhe kanë paguar taksat lokale për vitin 2001”, në të cilën evidentohet me numër rendor 26, emri i z. Sh. R, i regjistruar si person fizik, me aktivitet “marangoz”, me adresë “Qendër”, i cili ka paguar me mandatarkëtimin nr. 119, datë 19.09.2001, taksat si vijojnë: taksë pastrimi – 2.500 lekë, taksë pasurie – 2.000 lekë dhe taksë tabele – 500 lekë.

ii. Fletë njoftimi mbi tatimet dhe taksat e vitit 2003, në bazë të ligjit nr. 8435, datë 28.12.1998, “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 8982, datë 12.12.2002, “Për sistemin e taksave vendore”, për z. Sh. R, me veprimtari “Përpunim druri”, e kryer “në njësi”, vendndodhja “{***}”, në të cilën evidentohen detyrimet: “tatim pasurie – 4.130 lekë, taksë pastrimi – 15.000 lekë, taksë tabele – 500 lekë, taksë reklame –, taksë 1% e xhiros –, taksë fjetje në hotel –, shuma totale 19.630 lekë”, dhe mandatarkëtim nr. {***}, datë 13.05.2003, për pagesën e shumës 19.630 lekë.

iii. Aktdetyrim, për vitin 2004, në bazë të ligjit nr. 8982, datë 12.12.2002, “Për sistemin e taksave vendore”, dhe vendimit të Këshillit Bashkiak nr. {***}, datë 24.12.2003, për aktivitetin “marangoz”, në të cilin evidentohen detyrimet: “taksë ndërtese – 4.130 lekë, tarifë pastrimi – 15.000 lekë, taksë tabele – 500 lekë. Shuma totale 19.630 lekë”, dhe mandatarkëtimi nr. {***}, datë 26.08.2004, për pagesën e shumës 19.630 lekë.

iv. Aktdetyrim, për vitin 2006, në bazë të ligjit nr. 8982, datë 12.12.2002, “Për sistemin e taksave vendore”, për aktivitetin “përpunim druri”, në të cilin evidentohen detyrimet: taksë tabele – 500 lekë, taksë ndërtese – 1.280 lekë, tarifë pastrimi – 15.000 lekë, shuma totale 16.680 lekë, dhe mandatarkëtimi nr. {***}, datë 13.06.2006, për pagesën e shumës 16.680 lekë.

v. Aktdetyrim, për vitin 2007, në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, për aktivitetin “marangoz” në njësi, në të cilin evidentohen detyrimet: “taksë tabele – 500 lekë, taksë ndërtese – 1.180 lekë, tarifë pastrimi – 15.000 lekë, taksa vendore mbi biznesin e vogël deri në datën 20.04.2007 – 5.000 lekë; deri në datën 20.07.2007 – 5.000 lekë; deri në datën 20.10.2007 – 5.000 lekë; deri në datën 20.01.2008 – 5.000 lekë; shuma totale: 36.680 lekë.

vi. Aktdetyrim, për vitin 2008, në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, për aktivitetin “marangoz” në njësi, adresa “{***}”, në të cilin evidentohen detyrimet: “taksë tabele 500 lekë, taksë ndërtese 1180 lekë, tarifë pastrimi 15.000 lekë, taksa vendore mbi biznesin e vogël, deri në datën 20.04.2008 – 5.000 lekë; deri në datën 20.07.2008 – 5.000 lekë; deri në datën 20.10.2008 – 5.000 lekë; deri në datën

20.01.2009 – 5.000 lekë; shuma totale, viti 2008 – 36.680 lekë; shuma totale e vitit 2007, së bashku me gjobën për detyrimin e prapambetur, 45.850 lekë.

vii. *Aktedetyrim*, për vitin 2009, në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, për aktivitetin “marangoz”, të ushtruar në njësi, adresa “{***}”, në të cilin evidentohen detyrimet: *taksë tabele* – 500 lekë; *taksë ndërtese* – 1.180 lekë; *tarifë pastrimi* – 15.000 lekë; *taksa vendore B.V* – 20.000 lekë. *Shuma totale e vitit 2009* – 36.680 lekë; *detyrim i vitit 2007 dhe gjoba* – 45.850 lekë; *detyrim i vitit 2008 dhe gjoba* – 45.850 lekë.

viii. *Aktedetyrim*, për vitin 2010, në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, në të cilin evidentohen detyrimet: *taksë tabele* – 120 lekë; *taksë ndërtese* – 1.180 lekë; *taksë pastrimi* – 15.000 lekë; *taksë vendore B.V* – 20.000 lekë. *Shuma totale, viti 2010* – 36.300 lekë; *detyrim i vitit 2007 dhe gjoba* – 45.850 lekë; *detyrim i vitit 2008 dhe gjoba* – 45.850 lekë; *detyrim i vitit 2009 dhe gjoba* 45.850 lekë.

ix. *Aktedetyrim*, për vitin 2011, në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, në të cilin evidentohen detyrimet: “*taksë tabele* – 120 lekë; *taksë ndërtese* – 1.180 lekë; *taksë pastrimi* – 2.000 lekë; *tarifa e ndriçimit rrugor* – 600 lekë; *taksë vendore B.V* – 20.000 lekë. *Shuma totale, viti 2011* – 23.900 lekë.

x. *Aktedetyrim*, për vitin 2012, në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, në të cilin evidentohen detyrimet: “*taksë tabele* – 120 lekë; *taksë ndërtese* – 1.180 lekë; *tarifë pastrimi* – 2.000 lekë; *tarifë e ndriçimit rrugor* – 600 lekë; *taksa vendore B.V* – 20.000 lekë. *Shuma totale, viti 2012* – 23.900 lekë; *detyrimi për vitin 2011, së bashku me gjobën* – 29.875 lekë. *Aktedetyrime të viteve 2013 [...], 2014 [...]*.

xi. Plan zdrukthëtarie për Sh. R, për objekt me sipërfaqe 59 m², në të cilin evidentohet vendndodhja e objektit “zdrukthëtari”, pranë rrugës automobilistike.

37.5 Veç sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (i) Leje higjieno-sanitare nr. {***}, datë 09.01.1997, lëshuar nga Inspektorati Sanitar Shtetëror i Rrethit Gjirokastër, për z. Sh. R, sipas së cilës, pas kontrollit higjieno-sanitar, të ushtruar nga inspektorët sanitarë shtetërorë, në objektin që i përket z. Sh. R në Libohovë, është vendosur që objekti me destinacion “prodhime druri” plotëson kushtet higjieno-sanitare; (ii) Kërkesë e Kryetarit të Bashkisë Libohovë, z. B. Ç., pa datë, drejtuar Korporatës Elektrike Gjirokastër, dega Libohovë, duke i kërkuar lidhjen e energjisë elektrike për zdrukthëtarinë e ndërtuar me leje të rregullt ndërtimi nga bashkia, për shtetasin Sh. R.

37.6 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ shtesë,⁵³ subjekti i rivlerësimit ka sjellë sërish në vëmendje përgjigjen e Bashkisë Libohovë, të cituar më sipër, e cila, sipas tij, në një interpretim të kuadrit ligjor të kohës, provon faktin se babi i tij e ka nisur aktivitetin që në vitin 2001 dhe se ka paguar tatimet e taksat për vitet 2003, 2004 dhe 2006, sipas mandatarkëtimeve respektive, si dhe taksën vendore për biznesin e vogël në vitet 2007 – 2009, dhe se nuk ka detyrime tatimore të papaguara.

38. Trupi gjykues, nga kontrolli i përmbajtjes së vendimit, fillimisht vëren se, në lidhje me të ardhurat e babait nga aktiviteti tregtar, Komisioni ka argumentuar se: (i) Në vitin 2001, kur pretendohet se ka filluar aktivitetin, babai i subjektit nuk rezultoi i regjistruar pranë DRT-së Gjirokastër, si organi kompetent për regjistrimin, deklarimin dhe pagesën e detyrimeve tatimore (tatimit për biznesin e vogël për personat fizikë me qarkullim 0 deri 2.000.000 lekë/vit, me kuotë fikse vjetore), sipas parashikimeve të ligjit nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, i ndryshuar me ligjin nr. 8715, datë

⁵³ Subjektit iu bë i njohur konkluzioni paraprak se nuk kishte provuar mundësinë financiare të babait të tij për dhënien e huas, në vlerën 3.000.000 lekë, në vitin 2009.

15.12.2000⁵⁴. (ii) Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor pagesën e detyrimeve tatimore (me kuotë fikse, sipas llojit të aktivitetit, për qarkullimin 0 – 2.000.000 lekë), pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër, sipas ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”. Mandatet për vitet 2003, 2004 dhe 2006 provuan vetëm pagimin e taksës vendore për këto vite.⁵⁵ (iii) Komisioni, pavarësisht se nuk i ka rezultuar e provuar, me mandatpagesa apo fatura bankare, pagesa e detyrimeve për vitin 2007, 2008 dhe 2009, në një analizë garantiste, ka vlerësuar të ligjshme të ardhurat për periudhën 2007 – 2009, të cilat në total shkojnë 3.000.000 lekë, bazuar në shkresën nr. {***} prot., datë 21.04.2022, të Bashkisë Libohovë, e cila evidenton faktin se babai i subjektit nuk është debitor⁵⁶. Për këtë periudhë, Komisioni ka mbajtur në konsideratë parashikimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, sipas të cilit organi kompetent për regjistrimin, deklarimin dhe pagesën e detyrimeve tatimore do të ishin organet e pushtetit vendor (Bashkia Libohovë)⁵⁷.

39. Në drejtim të këtyre argumenteve, në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nga analizimi i situatës së fakteve të parashtruara më sipër, në raport me parashikimet e legjislacionit të zbatueshëm, trupit gjykues i rezulton që, për vitin 2001, z. Sh. R ka qenë i regjistruar pranë Bashkisë Libohovë si person fizik me aktivitet “marangoz”, me adresë “{***}”, dhe ka paguar *taksë pastrimi*, *taksë pasurie* dhe *taksë table*, të cilat janë taksa vendore të komunës ose bashkisë, të paguara në zbatim të ligjit nr. 8435, datë 28.12.1998, “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Krahas taksave vendore, në këtë periudhë, çdo person që kryen biznes me xhiro vjetore deri në 8 milionë lekë dhe që nuk i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar, është subjekt i tatimit mbi biznesin e vogël, sipas ligjit nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”,⁵⁸ i ndryshuar⁵⁹, i cili nënkupton tatimin me kuotë fikse, plus tatimin mbi xhiron. Konkretisht, aktiviteti i marangozit përfshihet në grupin E, “Ambulant, artizanat”, nëngrupi 2, “Artizanë të vegjël”, të nenit 3, pika 1, Kreu II, “Tatimi me kuotë fikse”, të këtij ligji. Këta persona kanë detyrimin, si çdo kategori tjetër që dëshiron të ushtrojë biznes, për t’u regjistruar në zyrën e tatimeve të rrethit ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre.⁶⁰ Në rastin konkret, duke qenë se ky lloj tatimi, pra tatimi mbi biznesin e vogël, në kuptim të ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, klasifikohet në kategorinë e tatimeve

⁵⁴ Shih paragrafin 1.38 të vendimit.

⁵⁵ Shih paragrafët 1.40 dhe 1.40.2 të vendimit.

⁵⁶ Shih paragrafët 1.42 dhe 1.45 të vendimit.

⁵⁷ Shih paragrafët 1.40.1, 1.41 dhe 1.42 të vendimit.

⁵⁸ Në nenin 1 të këtij ligji përcaktohet se: “Subjekt i tatimit mbi biznesin e vogël është çdo person që kryen biznes në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjatë çfarëdo periudhe të vitit kalendarik, i cili realizon një xhiro vjetore deri në 8 milionë lekë dhe që nuk i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar. Objekt i tatimit mbi biznesin e vogël është xhironja (në lekë) e realizuar në çdo vend biznesi për një vit kalendarik. Tatimi mbi biznesin e vogël nënkupton tatimin me kuotë fikse, të llogaritur sipas tabelës përkatëse të Kreut II, plus tatimin mbi xhiron të llogaritur sipas dispozitave të Kreut III të këtij ligji. Në nenin 3 përcaktohet se: “Subjekte të tatimit me kuotë fikse janë ato subjekte që realizojnë një qarkullim deri në shumën 2.000.000 lekë në vit”. Në nenin 5 përcaktohet se: “Tatimi mbi xhiron është 4 për qind e xhiros për tatimpaguesit që realizojnë shumën nga 2 deri në 8 milionë lekë për çdo vit kalendarik”.

⁵⁹ I ndryshuar me ligjin nr. 8715, datë 15.12.2000, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8313, datë 26.03.1998, ‘Për tatimin mbi biznesin e vogël’”.

⁶⁰ Në Kreun II, në nenin 4, përcaktohet se: “1. Çdo person që kërkon të fillojë një biznes, duhet të regjistrohet në zyrën e tatimeve të rrethit ku ai ushtron veprimtarinë e tij. 2. Personi që regjistrohet, duhet të plotësojë deklaratën përkatëse me këto të dhëna: a) Emri e mbiemri (sipas dokumentit identifikues); b) Vendimi i gjykatës që i njej zotësinë tatimpaguesit për të ushtruar biznes; c) Lloji ose llojet e biznesit që do të ushtrojë; ç) Adresa e vendit a vendeve të biznesit; d) Xhiro e realizuar gjatë vitit të mëparshëm; dh) Xhiro e parashikuar për vitin në vijim; e) Informacione të tjera mbi biznesin që i kërkohen, sipas udhëzimit të ministrit të Financave. 3. Organet tatimore pajisin me ‘certifikatë regjistrimi’ çdo person të regjistruar. Përmbajtja e saj përcaktohet në udhëzim”.

dhe taksave kombëtare,⁶¹ organi përgjegjës për zbatimin dhe administrimin e tij është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e saj në rrethe,⁶² dhe jo zyrat tatimore të pushtetit vendor, të cilat administrojnë vetëm tatimet dhe taksat vendore.⁶³ Në zbatim të këtij kuadri ligjor, trupi gjykues vlerëson se fakti që nga organet tatimore nuk konfirmohet regjistrimi i aktivitetit privat të z. Sh. R, ndërkohë që detyrimet e evidentuara në pasqyrën progresive të subjekteve private të Bashkisë Libohovë janë taksat vendore të bashkisë, që administrohen prej saj, përbëjnë prova të mosushtimit të veprimtarisë së pretenduar në përputhje me ligjin dhe, për rrjedhojë, çdo e ardhur e krijuar në kuadër të një aktiviteti të tillë (pra, jo prej një burimi të ligjshëm), me të drejtë, është vlerësuar nga ana e Komisionit se nuk përmbush standardin e të ardhurave të ligjshme, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

40. Në vijim të analizës së mësipërme, për vitet 2003, 2004 dhe 2006, trupi gjykues konstaton se z. Sh. R ka ushtruar në këto vite veprimtarinë e marangozit apo të përpunimit të drurit në njësi (pra, jo si ambulancë pa një vendndodhje fikse), dhe ka paguar taksat vendore *taksë tabele, taksë ndërtese/pasurie dhe taksë pastrimi*, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8435, datë 28.12.1998, “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 8⁶⁴ të ligjit nr. 8982, datë 12.12.2002, “Për sistemin e taksave vendore”. Krahas këtyre taksave vendore, të quajtura ndryshe si taksa të bashkisë dhe të komunës, në këtë periudhë, çdo person që ushtronte veprimtari biznesi, ka pasur edhe detyrimin e pagimit të taksës vendore të biznesit të vogël⁶⁵ me kuotë fikse vjetore, ndër të cilët, edhe ambulancët në fushën e tregtisë dhe shërbimeve⁶⁶, si dhe regjistrimin e çdo vendndodhjeje të biznesit në organin tatimor përgjegjës, sipas ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”,⁶⁷ përpara nisjes së tij. Ndonëse sipas këtyre ligjeve, kjo lloj takse u klasifikua tashmë në kategorinë e taksave vendore, ajo gjeti

⁶¹ Në nenin 6 të këtij ligji përcaktohet se: “2. Në tatimet dhe në taksat kombëtare përfshihen: a) tatimi mbi vlerën e shtuar; b) tatimi mbi të ardhurat; c) akcizat; ç) tatimi mbi taksa vendore për biznesin e vogël; [...]”.

⁶² Në nenin 16, pika 1 e këtij ligji përcaktohet se: “[...] Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e saj në rrethe janë organet kompetente që zbatojnë dhe administrojnë tatimet. Ajo e ka selinë në Tiranë. [...] Më tej, në nenin 18 përcaktohet se: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka degët e veta në rrethe. [...] Degët e tatimeve pajisin tatimpaguesit me certifikatë tatimore, hartojnë projektprogramin e të ardhurave tatimore për rrethin, ndjekin dhe përgjigjen për realizimin e programit të të ardhurave tatimore, përpunojnë deklaratat tatimore, përcaktojnë dhe nxjerrin detyrimin tatimor, bëjnë ruajtjen dhe organizimin e dokumentacionit, kryejnë kontrollin e tatimpaguesve dhe mbledhjen e tatimeve, si dhe zbatojnë vendimet e veçanta ekzekutive”.

⁶³ Në nenin 22 të këtij ligji përcaktohet se: Tatimet dhe taksat vendore administrohen nga organet e qeverisjes vendore, të cilat kanë në varësi zyrat tatimore të pushtetit vendor. [...].

⁶⁴ Në këtë nen përcaktohet se: Në taksat vendore përfshihen: a) taksa vendore mbi biznesin e vogël, e cila rregullohet me ligj të veçantë; b) taksa mbi pasuritë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore; c) taksa e fjetjes në hotel; ç) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime të reja; d) taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme; dh) taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve; e) taksa për zënie të hapësirave publike; ë) taksa e tabelës dhe f) taksa të përkohshme.

⁶⁵ Në nenin 2 të ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, përcaktohet se: “1. Objekt i taksës vendore për biznesin e vogël është një kuotë fikse vjetore, e pagueshme, e realizuar për çdo vendndodhje ku një person kryen biznes. 2. Subjekt i taksës vendore për biznesin e vogël është çdo person, që kryen biznes në territorin e njësisë të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, në çdo periudhë të vitit kalendarik, dhe që nuk i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar, TVSH-së”. Neni 6, “Kërkesat për regjistrim”, përcakton se: 1. Taksapaguesi do të regjistrojë çdo vendndodhje të biznesit në organin tatimor përgjegjës për atë vendndodhje. Regjistrimi bëhet përpara se taksapaguesi të fillojë biznesin. 2. Gjatë regjistrimit, taksapaguesi detyrohet të japë të dhënat e mëposhtme: a) vendimin e gjykatës për regjistrimin; b) certifikatën personale me fotografi; c) adresën e vendndodhjes ose vendndodhjeve të biznesit; ç) llojin e biznesit ose bizneseve që kryhen në atë vendndodhje; d) numrin e identifikimit të taksapaguesit, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; dh) numrin e regjistrimit në degën e taksave të pushtetit vendor; e) çdo të dhënë ose dokument tjetër që kërkohet nga udhëzimi. 3. Taksapaguesi, pas regjistrimit fillestar, reregjistrohet në çdo vit kalendarik që vijon dhe jo më vonë se data 31 mars. Procedura e reregjistrimit përcaktohet në udhëzim. 4. Kur taksapaguesi nuk regjistrohet ose nuk reregjistrohet në kohën e duhur, ai regjistrohet nga organi tatimor. Ky regjistrim ka të njëjtin efekt me regjistrimin ose reregjistrimin e bërë nga taksapaguesi dhe shoqërohet me sanksione, sipas nenit 12, pika 1.a e këtij ligji. [...].

⁶⁶ Në tabelën nr. 1 të ligjit, shkronja Dh përfshihen “Ambulancët në fushën e tregtisë dhe të shërbimeve”.

⁶⁷ Ky ligj shfuqizoi ligjin nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, i ndryshuar.

rregullim me ligj të veçantë, konkretisht me ligjin nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, i cili parashikoi shprehimisht që kjo lloj takse do të vazhdonte të mbledhej nga administrata qendrore e tatimeve, sipas nenit 4 dhe 15 të këtij ligji.⁶⁸ Vetëm më hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, u parashikua që organi kompetent për regjistrimin, deklarin dhe pagesën e këtij detyrimi do të ishin organet e pushtetit vendor⁶⁹. Veç këtij detyrimi, në këtë periudhë, çdo person që ushtronte biznes, do të ishte subjekt i një tjetër detyrimi tatimor të quajtur “Tatim i thjeshtuar mbi fitimin”, në masën 4% të qarkullimit të realizuar gjatë një viti kalendarik, i përcaktuar sipas ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”,⁷⁰ për të cilin duhej të regjistrohej në degën e tatimeve të rrethit, përpara se të fillonte biznesin. Nga ky detyrim tatimor përjashtohen ambulantët në fushën e tregtisë dhe të shërbimeve, që në kuptim të këtij ligji⁷¹, janë personat fizikë, që nuk kanë vendndodhje fikse të biznesit të tyre. Në zbatim të këtij kuadri ligjor, edhe në këtë rast, trupi gjykues vlerëson se fakti që nga organet tatimore nuk konfirmohet regjistrimi i aktivitetit privat të z. Sh. R për këtë periudhë, i ushtruar në njësi, pra jo si ambulant (pa një vendndodhje fikse të ushtrimit të aktivitetit), ndërkohë që pagesat e evidentuara të paguara në akt-detyrimet e Bashkisë Libohovë për këtë periudhë i përkasin taksave vendore në administrim të kësaj të fundit, përbëjnë sërish prova të mosushtrimit të veprimtarisë së pretenduar në përputhje me ligjin dhe, për rrjedhojë, çdo e ardhur e krijuar në kuadër të një aktiviteti të tillë (pra, jo prej një burimi të ligjshëm), me të drejtë është vlerësuar nga ana e Komisionit se nuk përmbush standardin e të ardhurave të ligjshme, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

41. Konkluzionet e mësipërme të trupit gjykues e bëjnë të pambështetur edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit, *se mosregjistrimi në organin tatimor është i karakterit formal*, sa kohë nuk rezultoi e provuar pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti privat i babait në periudhën 2001 – 2006 dhe, për rrjedhojë, ligjshmëria e burimit dhe të ardhurave, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Argumenti i subjektit, se mosregjistrimi ka ndodhur edhe për shkak të mosveprimit të organeve shtetërore, Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, në vlerësimin e trupit gjykues, është i pabazuar në ligj dhe nuk e zhvesh atë nga përmbushja e detyrimeve në kuadër të procesit të rivlerësimit, në rastin konkret, nga detyrimi për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua nga babai, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, të deklaruar nga subjekti dhe huadhënësi me

⁶⁸ Në nenin 4 të këtij ligji përcaktohet se: *Për dy vitet e para nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, organet tatimore janë degët e tatimeve, me përjashtim të rasteve kur organi tatimor caktohet nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në rekomandimin e ministrit të Financave, në përputhje me kërkesën e organeve të pushtetit vendor. Më tej, në nenin 15, pika 2, përcaktohet se: “2. Për të gjitha çështjet për të cilat subjektet apelojnë, procedurat e apelimt janë sipas ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999, ‘Për procedurat tatimore’, me ndryshimet përkatëse, për aq kohë sa kjo taksë vazhdon të mbledhet nga administrata qendrore e tatimeve, sipas nenit 4 të këtij ligji”.*

⁶⁹ Në nenin 12, pika 1 e këtij ligji, përcaktohet se: *“1. Taksapaguesi regjistron çdo vendndodhje të biznesit pranë bashkisë ose komunës përkatëse”.*

⁷⁰ Në nenin 4 të këtij ligji përcaktohet se: *“Neni 32/1, ‘Fusha e veprimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin’. 1. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin zbatohet ndaj çdo personi, i cili: a) kryen një biznes në territorin e Republikës së Shqipërisë në çdo kohë, gjatë vitit kalendarik; b) nuk është i regjistruar ose i detyruar me ligj të regjistrohet për TVSH-në. 2. Përjashtohen nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin: ambulantët në fushën e tregtisë dhe të shërbimeve; ata që kryejnë veprimtari që lidhet me transportin individual. Neni 32/2, ‘Regjistrimi dhe reregjistrimi’, 1. Tatimpaguesit detyrohen të regjistrohen në organet tatimore përpara se të fillojnë biznesin. Në çdo vit kalendarik, pas vitit të regjistrimit të parë, tatimpaguesit detyrohen të reregjistrohen përpara datës 31 mars. Në rastet kur tatimpaguesit nuk regjistrohen ose nuk reregjistrohen në kohën e duhur, degët e tatimeve bëjnë regjistrimin e tyre dhe ky regjistrim do të ketë të njëjtat efekte, ashtu si dhe regjistrimi ose reregjistrimi i bërë nga vetë tatimpaguesit. 2. Tatimpaguesit do të regjistrohen ose reregjistrohen në degën e tatimeve të rrethit, ku ndodhet vendi kryesor i veprimtarisë. Mënyra e veprimeve për regjistrim ose reregjistrim përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Financave. [...]”.*

⁷¹ Në nenin 1, shkronja “ç” e këtij ligji përcaktohet se: *“ambulant” nënkupton një person fizik, të angazhuar në shitjen e mallrave ose kryerjen e shërbimeve, i cili nuk ka vendndodhje fikse të biznesit të tij.*

burim nga aktiviteti privat. Ky vlerësim vjen pasi, referuar kuadrit ligjor të sipërcituar, nga viti 1998 deri në vitin 2006, detyrimi për regjistrimin e aktivitetit privat/biznesit i përkiste qartazi personit që dëshironte të ushtronte këtë aktivitet dhe, nëse ai nuk vepronte, mosveprim që shoqërohej me sanksione,⁷² ai regjistrohej nga organi tatimor. Lidhur me këtë të fundit, nga aktet e administruara në fashikull, nuk ka rezultuar ndonjë akt konstatimi, vlerësimi apo edhe ndonjë sanksion i vendosur nga organet tatimore në këtë periudhë, në të cilën të evidentohet mosregjistrimi i veprimtarisë private të z. Sh. R, prej nga do të rridhte detyrimi që këto organe të regjistronin këtë veprimtari sipas rregullave të parashikuara, përkatësisht në nenin 6, pika 4 e ligjit nr. 8978, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, datë 12.12.2002, dhe në nenin 32/2, pika 1 e ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”. Ndërkaq, nga krahasimi i rrethanave konkrete me rrethanat në vendimin e Kolegjit nr. 14, datë 15.06.2021, të referuar nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se, në rastin konkret, nuk gjendet përpara problematikave në drejtim të ruajtjes dhe administrimit të dokumentacionit nga organet shtetërore.

42. Lidhur me argumentin tjetër të subjektit të rivlerësimit, *se Komisioni ka njohur të ardhurat e viteve 2007 – 2009, për shkak se provohej pagesa e detyrimeve tatimore, pavarësisht regjistrimit ose jo në drejtorinë përkatëse tatimore Gjirokastër*, trupi gjykues, referuar përmbajtjes së vendimit,⁷³ çmon me rëndësi të theksojë se Komisioni, konsiderimin e shumës prej 3.000.000 lekësh e ka bërë në funksion të një analize garantiste, çka nënkupton që edhe Komisioni duket se ka pranuar që nuk provohen, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të ardhurat e ligjshme të periudhës 2007 – 2009. Këtij qëndrimi të Komisionit i kanë paraprirë një sërë argumentesh, të tilla si: (i) referuar parashikimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, organi kompetent për regjistrimin, deklarimin dhe pagesën e detyrimeve janë organet e pushtetit vendor (Bashkia Libohovë). (ii) Nuk u evidentua ndonjë provë e shkruar në formë mandati apo dokument tjetër i kohës, që të provonte që detyrimet për vitin 2007, 2008 dhe 2009 ishin paguar, dhe se faktet e referuara në shkresën nr. {***} prot., datë 21.04.2022, të Bashkisë Libohovë, sipas së cilës: “Detyrimet tatimore dhe taksat vendore të vendosura për çdo vit kalendarik nga Këshilli Bashkiak janë paguar të gjitha në bazë të mandatarkëtimeve dhe faturave të bankës dhe, si rrjedhojë, nuk rezultojnë të jetë debitor ndaj Bashkisë Libohovë”, nuk provohen me mandatpagesa apo fatura bankare. (iii) Sipas vërtetimit të Bashkisë Libohovë, nr. {***}, të ardhurat e z. Sh. R, për periudhën 2007 – 2009, ishin 1.000.000 lekë në vit. Në drejtim të këtyre argumenteve, trupi gjykues vëren se vlerësimi i Komisionit mbi të ardhurat e babait gjatë kësaj periudhe duket se nuk ka qenë i bazuar në aktet e administruara. Konkretisht, vërtetimi nr. {***}, datë 31.10.2014 dhe shkresa nr. {***} prot., datë 21.04.2022, të Bashkisë Libohovë (të lëshuara në cilësinë e organit kompetent në këtë periudhë, për pagesën e taksës vendore të biznesit të vogël), referojnë se janë likuiduar detyrimet tatimore në kuptim të dispozitave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, por ato janë të pashoqëruara me mandatpagesa apo

⁷² Në nenin 9, “Përgjegjësia dhe shkeljet” të ligjit nr. 8313, datë 26.3.1998, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Përbëjnë kundërvajtje administrative këto shkelje: a) Mosregjistrimi sipas kërkesave të përcaktuara në kreun II; [...]”; Në nenin 6, pika 4 e ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, përcaktohet se “4. Kur taksapaguesi nuk regjistrohet ose nuk reregjistrohet në kohën e duhur, ai regjistrohet nga organi tatimor. Ky regjistrim ka të njëjtin efekt me regjistrimin ose reregjistrimin e bërë nga taksapaguesi dhe shoqërohet me sanksione, sipas nenit 12, pika 1.a e këtij ligji”. Ndërsa në nenin 12, “Kundërvajtjet dhe dënimet”, të këtij ligji përcaktohet se: “1. Në kuptim të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative: a) Mosregjistrimi ose mosreregjistrimi i vendndodhjes së veprimtarisë ekonomike, siç përcaktohet në nenin 6 të këtij ligji, ose mospagimi i taksës brenda datës së caktuar dënohen me gjobë [...]”; Në nenin 32/8, “Kundërvajtjet dhe gjobat”, të ligjit nr. 8979, datë 12.12.2002, përcaktohet se: “1. Në kuptim të këtij ligji, kur shkeljet nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë: a) kur tatimpaguesi nuk regjistrohet ose nuk reregjistrohet, në përputhje me nenin 32/2, ai dënohet me një gjobë prej 50 000 lekësh. [...]”

⁷³ Shih paragrafët 1.40.1, 1.41, 1.42 dhe 1.45 të vendimit.

fatura bankare, për rrjedhojë, vlera e këtyre akteve mbetet e kufizuar sa i përket provueshmërisë dhe ligjshmërisë së këtyre të ardhurave. Ndërkaq, vërtetimi nr. {***}, i datës 31.10.2014, nuk referon një shumë ekzakte të ardhurash të realizuar nga veprimtaria e z. Sh. R, por vetëm një mesatare vjetore të tyre, që nuk identifikohet se mbi cilën bazë ligjore dhe metodologji është përcaktuar. Në këto rrethana, trupi gjykues, ndonëse në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, nuk mund të mbajë një qëndrim të ndryshëm nga Komisioni mbi ligjshmërinë e të ardhurave të periudhës 2007 – 2009, e gjen të pambështetur përdorimin e këtyre argumenteve të Komisionit, në vlerësimin e tij për ligjshmërinë e të ardhurave të pretenduara në periudhën 2001 – 2006.

43. Sa i takon ushtrimin të aktivitetit *privat të z. Sh. R, edhe përpara vitit 2001*, trupi gjykues vlerëson se aktet e referuara nga subjekti i rivlerësimit në mbështetje të këtij pretendimi, leja higjieno-sanitare e vitit 1997, lëshuar nga Inspektorati Sanitar Shtetëror Gjirokastër, dhe shkresa (pa datë) e kryetarit të Bashkisë Libohovë, drejtuar Korporatës Elektrike Gjirokastër, japin informacion vetëm mbi faktin se babai i tij ka pasur një objekt me vendndodhje fikse për ushtrimin e aktivitetit privat, por jo ushtrimin e tij, mbi të ardhurat e përfituara në këtë periudhë apo pagesën e detyrimeve tatimore. Ndërsa, sa i takon pretendimin të subjektit të rivlerësimit mbi pamundësinë e tij për të siguruar akte për zhvillimin e këtij aktiviteti nga organet tatimore, për shkak të kushteve sociale ekonomike të Shqipërisë dhe mënyrës së administrimit të dokumentacionit përpara vitit 2001, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi se ndodhej në kushtet e pamundësisë objektive, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nuk rezultoi ndonjë akt i depozituar prej tij, i cili të vërtetojë që mungesa e dokumentacionit mbi aktivitetin privat të babait në këtë periudhë t'i atribuohet situatës së vendit apo keqadministrimit nga vetë institucionet publike.

II/2 Të ardhura të prindërve nga vetëpunësimi në bujqësi

44. Lidhur me këto të ardhura, Komisioni në vendim ka arritur në konkluzionin⁷⁴ se: *të ardhurat e prindërve nga bujqësia nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në arritjen e këtij konkluzioni, Komisioni ka argumentuar se: “Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në të gjitha provat dhe faktet e analizuar së bashku, arsyeton se në dokumentet e paraqitura nga subjekti provohet vetëm se prindërit e tij kishin përfituar tokë bujqësore, sipas ligjit nr. 7501, ‘Për tokën’. Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues të ardhurat nga aktiviteti bujqësor, si dhe të ardhurat nga mbledhja dhe tregtimi i bimëve medicinale. – Subjekti, si dokument në lidhje me të ardhurat nga puna në bujqësi, ka paraqitur vërtetim nr. {***}, datë 31.10.2014, të Bashkisë Libohovë, e cila konfirmon se familja e z. Sh. R kultivon bimë mjekësore dhe ka të ardhura në shumën 500.000 lekë/vit. Komisioni vlerësoi se të ardhurat nga bujqësia mbeten vetëm në kuadrin deklarativ, pasi ato nuk u arritën të vërtetoheshin me dokumentacion ligjor provues, në lidhje me pagimin e detyrimit tatimor, që prindërit e subjektit kishin të ardhura nga bujqësia në masën 500.000 lekë/vit, sipas pretendimit të subjektit”.*
45. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar konkluzionin e mësipërm, duke pretenduar se *prindërit e tij kanë jetuar në fshat dhe kanë realizuar të ardhura nga bujqësia, për të cilat Komisioni, minimalisht duhet të kishte konkluduar se kanë mbuluar shpenzimet e jetesës së familjes. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar si më poshtë:*

45.1 Komisioni i jep fuqi provuese shkresave nr. {***}, datë 31.10.2014, dhe nr. {***} prot., datë 21.04.2022, të Bashkisë Libohovë, në lidhje me detyrimet tatimore dhe taksat vendore për aktivitetin

⁷⁴ Shih paragrafët 1.33 - 1.35 të vendimit.

tregtar të ushtruar nga babai, por nuk pranon fuqinë tyre lidhur me atë çfarë pohojnë në drejtim të kultivimit të tokës, kryesisht me bimën medicinale të sherbelës dhe kulturën e misrit, derdhjen rregullisht të kontributeve të sigurimeve shoqërore, pagimin e taksës së tokës pranë bashkisë, dhe të ardhurat mesatare vjetore të realizuara, rreth 500.000 lekë.

45.2 Komisioni, shpenzimet e jetesës së familjes së babait, të përbërë nga dy anëtarë, duhet t'i kishte llogaritur si tepër minimale⁷⁵, pasi të gjitha kostot e ushqimit ata i kanë prodhuar vetë, referuar kjo qëndrimin të konsoliduar të mbajtur prej tij, si dhe jurisprudencës së KPA-së, kur kanë pranuar se familjet bujqësore, shpenzimet e jetesës i kanë më të vogla se familjet e tjera, që llogariten nga INSTAT-i, pasi koston e ushqimit e prodhojnë vetë. Ndërsa me parashtrimet në Kolegj, në analizën financiare mbi mundësinë e kursimit të babait, pretendohet që këto shpenzime të përlllogariten në masën 50% të shpenzimeve të përcaktuara nga ILDKPKI-ja sipas qëndrimit të konsoliduar, për anëtarët e familjeve që realizojnë të ardhura nga bujqësia⁷⁶.

45.3 Prindërit e subjektit kanë jetuar në shtëpinë e tyre, apartament në qytetin e Libohovës, të cilin e kanë përfituar nga privatizimi në vitin 1996 dhe, për pasojë, shpenzimet për qira kanë qenë zero lekë.

46. Në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se:

46.1 Subjekti i rivlerësimit, për të provuar të ardhurat nga puna e prindërve në bujqësi, ka paraqitur me deklaratën e pasurisë *vetting* aktet: (i) Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (në vijim "AMTP"), me nr. {***}, datë 27.07.1996, në emër të familjes së z. Sh. R, nga fshati Libohovë, të cilit i jepet në pronësi tokë arë me sipërfaqe 14.250 m². (ii) Vërtetim nr. {***}, datë 31.10.2014, lëshuar nga Bashkia Libohovë, sipas të cilit vërtetohet se: "*Sh. Sh. R. [...] ka qenë i vetëpunësuar në bujqësi, së bashku me bashkëshorten e tij, H. R., duke kultivuar tokën, të cilën e ka përfituar sipas ligjit 7501, 'Për tokën', duke kultivuar kryesisht bimë medicinale të sherbelës dhe kulturën e misrit, për të cilat ka derdhur rregullisht kontributet për sigurimet shoqërore, si dhe ka paguar taksën për përdorimin e tokës së Bashkisë. Nga ky aktivitet kanë realizuar të ardhura mesatare vjetore rreth 500.000 lekë*". (iii) Librezë kontributesh për Sh. dhe H. R., për vitet 1993, 2001 dhe 2002, me përshkrim "*sigurim, bujk privat*". Me shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së, më datë 07.11.2014, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur AMTP-në e cituar më lart, e shoqëruar me certifikatën e përbërjes familjare nga pesë anëtarë,⁷⁷ si dhe librezë kontributesh si bujk privat, për znj. H. R. dhe z. Sh. R, për vitin 2005.

46.2 Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, për të provuar e dokumentuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait nga bujqësia, subjekti i rivlerësimit, përveç sa më lart, ka paraqitur edhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.01.2020, të z. Sh. R, përmes të cilës, ai deklaron: "*[...] si i vetëpunësuar në bujqësi, së bashku me bashkëshorten time H. R. R., kemi paguar sigurimet shoqërore dhe shëndetësore pranë DRSSH-së Gjirokastër, si dhe kemi paguar detyrimet vendore për tokën e përfituar sipas ligjit nr. 7501*". Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit,⁷⁸ në kundërshtim të barrës së provës mbi mungesën e provueshmërisë me dokumentacion ligjor të të

⁷⁵ Subjekti ka cituar në ankim, në mbështetje të këtij argumenti, vendimet e Komisionit nr. 234, datë 04.02.2020, nr. 229, datë 28.01.2020, nr. 241, datë 26.02.2020 dhe nr. 191, datë 26.07.2019, si dhe vendimet e Kolegjit nr. 18, datë 12.07.2021 dhe nr. 18, datë 26.07.2019, në të cilin, sipas subjektit, është pranuar se shpenzimet për konsum përbëjnë vetëm 19% të të ardhurave, ndërkohë që 81% e të ardhurave shkojnë për kursim.

⁷⁶ Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka cituar në parashtrime vendimet nr.20, datë 14.06.2022; nr.18, datë 30.04.2024; nr. 25, datë 23.05.2024; nr. 4, datë 30.01.2024 dhe nr. 45, datë 26.10.2023.

⁷⁷ Sipas kësaj certifikate (pa datë), përbërja familjare është si vijon: Sh. R., H. R., Emilio Ruli, E. R. dhe B. R.

⁷⁸ Shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 04.05.2022.

ardhurave nga bujqësia për personin tjetër të lidhur, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime duke u fokusuar në vërtetimin e Bashkisë Libohovë, cituar më lart, mbi realizimin e këtyre të ardhurave në shumën 500.000 lekë çdo vit, pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe pagesën e taksës së tokës. Për këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime edhe në prapësimet mbi rezultatet e hetimit shtesë, në kundërshtim të barrës së provës mbi mungesën e provueshmërisë së mundësisë financiare të babait për dhënien e huas objekt shqyrtimi, të cilat konsistojnë në mënyrë të përmbledhur në argumentin se, referuar kuadrit ligjor në fuqi, të ardhurat nga vetëpunësimi në bujqësi në këtë periudhë përjashtoheshin nga detyrimet tatimore, si dhe ka cituar, në mbështetje të këtij pretendimi, një sërë vendimesh të Komisionit dhe të Kolegjit.

47. Në vlerësim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, nga analizimi i informacionit që përfitohet nga vërtetimi nr. {***}, datë 31.10.2014, i lëshuar nga Bashkia Libohovë, trupi gjykues konstaton fillimisht se vlera e të ardhurave të realizuara nga aktiviteti bujqësor i prindërve, të referuara në këtë vërtetim, nuk përbën një shumë ekzakte të ardhurash, por një mesatare vjetore të përafërt dhe, së dyti, nuk evidentohet se cili ka qenë burimi apo të dhënat në bazë të të cilave është përcaktuar kjo vlerë. Pagesa e taksës vendore të tokës ose e njohur ndryshe si tatimi mbi tokën bujqësore,⁷⁹ si i vetmi detyrim që zotëruesit e tokës bujqësore kanë pasur kundrejt organeve vendore (për periudhën 1996 – 2009), i llogaritur në varësi të sipërfaqes së tokës në pronësi të taksapaguesit dhe pjellorisë së saj, nuk provon shfrytëzimin apo prodhimtarinë e saj, për sa kohë që ato lidhen me të drejtat e pronësisë mbi tokën bujqësore, si dhe faktin e jetesës në fshat dhe, aq më pak, përfitimin e të ardhurave. Shfrytëzimin e tokës dhe të ardhurat e përfituara prej saj nuk i provon as pagesa e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si “*bujk privat*” në disa vite (1993, 2001, 2002 dhe 2005), pasi për regjistrimin në këtë skemë sigurimi, mjaftonte që i interesuari të provonte faktin se banonte në fshat dhe se kishte në pronësi tokë bujqësore⁸⁰. Nga subjekti i rivlerësimit nuk është depozituar asnjë akt i vetëm i kohës, që të provojë përfitimin e këtyre të ardhurave dhe vlerën e tyre, si dhe asnjë dokument për shitjen a përpunimin e produkteve bujqësore dhe bimëve medicinale. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Libohovë nuk prodhon asnjë shifër për t’u llogaritur si e ardhur e ligjshme e prindërve të subjektit të rivlerësimit nga vetëpunësimi në bujqësi, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Në mungesë të provueshmërisë së masës së të ardhurave nga puna e prindërve në bujqësi, si dhe të prodhimtarisë së tokës bujqësore, nuk mund të përcaktohet as masa e mbulimit të shpenzimeve nga këto të ardhura e, për pasojë, edhe përfshirja e këtyre të ardhurave në analizën financiare, minimalisht në masën e shpenzimeve të jetesës, apo se reduktimi i tyre për shkak të përdorimit të produkteve bujqësore do të përbënte një përlllogaritje jo të drejtë dhe joobjektive. Përpos kësaj, trupi gjykues vëren se, referuar shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit, por edhe raportit të analizës financiare të audituesit ligjor, depozituar nga subjekti me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, nuk rezulton të jetë ngritur shprehimisht ndonjë pretendim në drejtim të reduktimit të shpenzimeve të jetesës për shkak të përdorimit të produkteve bujqësore, përveç faktit të përlllogaritjes së tyre për dy anëtarë të familjes së babait, fakt që e bën pretendimin për reduktimin e këtyre shpenzimeve të ngritur për herë të parë në Kolegji, në funksion të justifikimit të mungesës së burimeve financiare të personit tjetër të lidhur dhe jobindës për vërtetësinë e tij. Në këto rrethana, trupi gjykues e çmon të panevojshme edhe mbajtjen e një qasjeje garantiste në këtë drejtim. Sa i takon argumentit tjetër të subjektit të rivlerësimit të përdorur në funksion të shkakut të ankimit, lidhur me reduktimin e shpenzimeve të jetesës për shkak të mungesës së shpenzimeve të qirasë, pasi prindërit e tij kanë banuar në apartamentin e përfituar nga privatizimi në qytetin e Libohovës, në vitin 1996, trupi

⁷⁹ Ligji nr. 7805, datë 16.03.1994, “Për tatimin mbi pasurinë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 8982, datë 12.12.2002, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”.

⁸⁰ https://www.issh.gov.al/?page_id=11307

gjykues sjell në vëmendje se shpenzimet e qirasë, parimisht nuk përfshihen në kategorinë e shpenzimeve të jetesës, por trajtohen si zë më vete. Në rastin konkret, trupi gjykues vëren se, edhe në raportin e analizës financiare të audituesit ligjor, nuk përmenden shpenzime qiraje të familjes së babait. Në këto rrethana, argumenti i sjellë konsiderohet jorelevant, në drejtim të reduktimit së shpenzimeve të jetesës.

48. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *konkluzioni i Komisionit në paragrafin 1.45 të vendimit, lidhur me përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës së familjes së babait, Sh. R, për periudhën 2007 – 2009, për 5 (pesë) persona, është i gabuar, pasi në këtë periudhë familja e babait përbëhej vetëm nga dy anëtarë (nëna dhe babai)*. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar argumentet si vijojnë:

48.1. Ai është shkëputur nga familja e origjinës që në vitin 1999, me nisjen e studimeve në Fakultetin e Drejtësisë, në Tiranë, ndërsa që prej vitit 2005, kur është martuar, është shkëputur edhe nga trangu familjar i babait, duke u regjistruar si familje më vete pranë Zyrës së Gjendjes Civile të Njësisë Bashkiake nr. {***}, Bashkia Tiranë, ku dhe aktualisht figuron i regjistruar.

48.2. I vëllai, z. E. R., është shkëputur nga trangu familjar që në vitin 2003, kur ka ikur për studime të larta *Bachelor*, periudha (2003 – 2006) dhe studime *Master (Laurea Specialistica in Scienze Economiche)* periudha (2006 – 2010), në Universita degli Studi di Cagliari, në Itali, ku edhe aktualisht jeton me familjen e tij. Që prej vitit 2004, ai ka qenë i pajisur me leje qëndrimi studentore. Gjatë gjithë periudhës studimore, vëllait i është akorduar bursë e plotë nga universiteti. Po kështu, ai ka fituar dhe përfunduar studimet për doktoraturë në Universita degli Studi di Padova, me bursë të plotë të akorduar.

48.3. E motra, znj. B. R., është shkëputur nga trangu familjar që në vitin 2005, kur ka ardhur për studime në Fakultetin e Drejtësisë, Tiranë, kryer në periudhën 2006 – 2010, ku edhe jeton aktualisht. Gjatë periudhës së studimeve, ajo ka jetuar pjesërisht në qendrën studentore dhe pjesërisht në shtëpinë e subjektit.

48.4 Në parashtrimet e paraqitura në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar: *“Nga viti 2001 deri në vitin 2003, familja Ruli ka qenë e përbërë nga 5 (pesë) anëtarë (babai, nëna, subjekti i rivlerësimit, vëllai E. R. dhe motra B. R.). Nga viti 2003, deri në vitin 2009, familja Ruli ka qenë e përbërë nga 3 (tre) anëtarë (babai, nëna dhe motra B. R.), pasi vëllai E. R., në tetor të vitit 2003, ka qenë duke ndjekur studimet e larta Bachelor, periudha (2004 – 2006) dhe Master (Laurea Specialistica in Scienze Economiche), (periudha 2006 – 2010), në Universita degli Studi di Cagliari, Itali, ku dhe aktualisht jeton së bashku me familjen e tij. Ndërsa, unë, subjekti i rivlerësimit, në tetor të vitit 2003, kam fituar Shkollën e Magjistraturës, ku dhe jam trajtuar me bursë mujore⁸¹”*.

49. Në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme, në vijim edhe të analizës së shkakut të ankimit në paragrafin 15 të këtij vendimi, nga kontrolli i arsytimit të vendimit të Komisionit dhe akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se:

49.1 Komisioni, në paragrafin 1.45 të vendimit, ka arritur në konkluzionin se: *“Nëse në funksion të një analize garantuese dhe shteruese, të ardhurat nga zdrukthëtaria për periudhën 2007 – 2009 do të konsideroheshin të ardhurat në shumën 3.000.000 lekë, përkatësisht, 1.000.000 lekë në vit, siç referonte vërtetimi nr. {***} i Bashkisë Libohovë dhe, nëse prej tyre do të zbriteshin shpenzimet jetike për të njëjtën periudhë, referuar numrit të anëtarëve të familjes së subjektit (5 anëtarë)⁸², pa llogaritur asnjë shpenzim tjetër, mundësia e kursimit të babait do të ishte e pamjaftueshme për të justifikuar dhënien hua të shumës prej 3.000.000 lekë, subjektit të rivlerësimit, në vitin 2009.*

⁸¹ Ky fakt është pasqyruar rregullisht në deklaratën vetting, në rubrikën “të ardhura”.

⁸² Referuar certifikatës familjare, familja e subjektit përbëhet nga pesë anëtarë, tre fëmijët dhe prindërit.

49.2 Nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, në drejtim të numrit të anëtarëve të familjes së z. Sh. R, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka depozituar pranë ILDKPKI-së, me shpjegimet e dhëna më datë 07.11.2014, pranë këtij institucioni, AMTP-në nr. {***}, datë 26.07.1996, dhënë familjes së shtetasit Sh. R, shoqëruar me certifikatën e përbërjes familjare së tij. Nga kjo certifikatë, e cila nuk përmban datë, evidentohet fakti se familja e shtetasit Sh. R përbëhet nga pesë anëtarë, Sh. R., bashkëshortja H. R. dhe tre fëmijët Emilio Ruli, E. R. dhe B. R.

49.3 Nga verifikimi i deklaratës së pasurisë *vetting* dhe deklaratat e interesave periodikë privatë, të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, rezulton se: (i) Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, certifikatë familjare të datës 23.01.2017, nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr. {***}, Tiranë, sipas së cilës, referuar RKGjC-së së vitit 2010, familja e subjektit të rivlerësimit përbëhej nga 4 (katër) anëtarë: subjekti i rivlerësimit, bashkëshortja V. R. dhe dy fëmijët, e datëlindjes 06.05.2007 dhe 05.08.2013. (ii) Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, dorëzuar më datë 27.03.2006 dhe në DIPP-në e vitit 2006, plotësuar nga subjekti në funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, emëruar në tetor 2005, përbërja familjare deklarohet me 2 (dy) anëtarë, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, V. R. (iii) në DIPP-të e viteve 2007, 2008 dhe 2009, të plotësuar nga subjekti, në funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, familja e tij deklarohet e përbërë nga tre persona (subjekti, bashkëshortja dhe i biri). Në këto deklarata, adresa e regjistrimit në gjendjen civile deklarohet në qytetin e Tiranës.

49.4 Në përgjigjet e pyetësorit standard, i pyetur mbi adresat e banimit që nga momenti i marrjes së detyrës për herë të parë, subjekti ka deklaruar se, nga marrja e detyrës në tetor të vitit 2005, deri në muajin prill të vitit 2010, ka banuar në një apartament banimi në pronësi të vjehrrës së tij, L. G., i ndodhur në adresën: “Njësia Bashkiake nr. {***}, rruga {***}, pallati 12-katësh i firmës {***}” mbrapa ish-Uzinës Enver, Tiranë”. Me tej ka deklaruar se, nga momenti i marrjes së detyrës, në tetor 2005, deri në muajin maj 2007, ka jetuar me bashkëshorten dhe, pas datës 06.05.2007, edhe me të birin, L. R. Ndërsa, në periudhën shtator 2007, deri në deklaratën e pasurisë *vetting*, me ta ka jetuar edhe vjehrra, znj. L. G. I pyetur lidhur me mbulimin e shpenzimeve të jetesës për secilin vit të periudhës së deklarimit, subjekti ka deklaruar: “ [...] Deri në shtator të vitit 2007, shpenzimet e jetesës janë përballuar nga pagat tona, si dhe nga ndihmesat e herëpashershme (të cilat kanë qenë në vlera monetare jo të konsiderueshme dhe produkte ushqimore të vendit ku banonin) të prindërve të mi, Sh. R, H. R., si dhe të vjehrrës, L. G. Pas shtatorit 2007, e në vijim, shpenzimet e jetesës janë përballuar pjesërisht nga pagat tona dhe pjesërisht nga vjehrra L. G.”. Bashkëlidhur këtyre shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur certifikatën e tij familjare, të bazuar sërish në RKGjC-në e vitit 2010. Me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti ka paraqitur edhe certifikatën e lëshuar më datë 27.04.2021, nga Njësia Administrative nr. {***}, Bashkia Tiranë, sipas së cilës vërtetohet se ai dhe bashkëshortja, V. R., kanë lidhur martesë në datën 14.10.2005.

49.5 Gjatë hetimit administrativ, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile,⁸³ në përgjigje të kërkesës së Komisionit, ka informuar se shtetasit Emiljano Ruli, V. R., L. R. dhe E. R., figurojnë të regjistruar si banorë në zyrën e gjendjes civile në Njësinë Bashkiake nr. {***}, Njësia Administrative Tiranë, Bashkia Tiranë. -- Me lidhjen e martesës, më datë 14.10.2005, shtetasja V. G. rezulton të jetë vendosur në përbërjen familjare të bashkëshortit, shtetasit Emiljano Ruli, duke marrë mbiemrin e bashkëshortit, “Ruli”. -- Shtetasit Sh. R. dhe H. R. figurojnë të jenë të regjistruar si banorë në zyrën e gjendjes civile në Bashkinë Libohovë.

⁸³ Kërkesë për informacion nr. {***} prot., datë 30.01.2020, e Komisionit dhe shkresë “kthim përgjigje” nr. {***} prot., datë 24.02.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

50. Në analizë të sa më lart, trupi gjykues, referuar përmbajtjes së vendimit, vëren fillimisht se Komisioni, në përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës së familjes me 5 (pesë) anëtarë, i referohet një certifikate familjare të subjektit, pa evidentuar të dhënat konkrete të saj, si data apo nga kush dhe ku është paraqitur. Nga kontrolli i imtësishëm i dokumentacionit në dosje, e vetmja certifikatë familjare e z. Sh. R rezulton ajo e paraqitur nga subjekti pranë ILDKPKI-së në vitin 2014, e përbërë nga pesë anëtarë, e cila, nisur nga fakti që është paraqitur së bashku me AMTP-në e vitit 1996, duket se i përket një kohe të largët dhe, si e tillë, informacioni që përftohet prej saj mbi përbërjen familjare të shtetasit Sh. R, për periudhën 2007 – 2009⁸⁴, vlerësohet të merret me rezervë nga trupi gjykues, dhe të analizohet në raport me të gjitha faktet e rrethanat e tjera të çështjes. Nga dokumentacioni i administruar në fashikull, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë me bashkëshorten e tij në vitin 2005 dhe, nga ky moment, ajo i është bashkuar përbërjes familjare të subjektit të rivlerësimit, por nga aktet nuk evidentohet përbërja familjare e tij në këtë periudhë, pra nëse ai ka qenë në të njëjtën përbërje familjare me babanë e tij apo është shkëputur si më vete. Ky moment nuk është qartësuar nga subjekti i rivlerësimit, as kur i është kërkuar në mënyrë specifike nga Komisioni, gjatë hetimit administrativ, për të deklaruar ndryshimet kronologjike në certifikatat familjare të gjendjes civile. Ndonëse nga deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave periodikë privatë 2006 – 2009, plotësuar prej tij, fillimisht në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe më pas në Shkodër, përbërja familjare e tij në periudhën 2007 – 2009 deklarohet e përbërë fillimisht nga 2 (dy) anëtarë, ai dhe bashkëshortja, dhe më pas, nga 3 (tre) anëtarë – trupi gjykues vlerëson se këto deklarime, të pashoqëruara me certifikatë familjare të gjendjes civile, nuk provojnë përbërjen familjare të kësaj periudhe. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur as në ankim akte të gjendjes civile, që vërtetojnë përbërjen familjare të tij në periudhën 2007 – 2009 apo të babait në këtë periudhë. Në kushtet kur, në funksion të përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës, subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me akte të gjendjes civile, shkëputjen e tij nga trangu familjar i babait dhe përbërjen e familjes së tij për periudhën 2007 – 2009, trupi gjykues vlerëson ta përfshijë, më së paku atë, në shpenzimet e jetesës së z. Sh. R, në këtë periudhë.

- Sa i takon argumenteve të subjektit të rivlerësimit, se i vëllai, E. R., ka qenë i shkëputur nga familja e babait në periudhën në fjalë, trupi gjykues vëren fillimisht se ky pretendim ngrihet për herë të parë në Kolegj, në funksion të kundërshtimit të përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës së familjes së z. Sh. R, të përbërë prej 5 (pesë) anëtarësh. Nga analizimi i akteve të paraqitura në mbështetje të këtij pretendimi, bashkëlidhur ankimit,⁸⁵ në eventualitetin që do të tejkalonin problemet me aspektin e formës (sikurse arsyetuar në paragrafin 20 të këtij vendimi), por edhe nën dritën e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, ato rezultojnë pa ndikim në drejtim të faktit që kërkohet të provohet, pasi nga përmbajtja e tyre përftohet informacioni se, në periudhën 2006 – 2010, i vëllai, E. R., ka ndjekur studimet *Master* për Shkenca Ekonomike në “*Universita degli Studi di Cagliari*”, Itali, të cilat i ka përfunduar me rezultate të larta, ndërsa në periudhën janar 2011 – dhjetor 2013 ka ndjekur studimet e Doktoraturës në Statistikë në Universita degli Studi di Padova, Itali, por nuk provojnë përfitimin e bursës si mjet i pretenduar për mbulimin e kostove të jetesës së tij në Itali, në periudhën 2007 – 2009. Edhe aktet e depozituara me

⁸⁴ Në dokumentacionin e depozituar nga subjekti pranë ILDKPKI-së në vitin 2014, bashkëlidhur AMTP-së së vitit 1996 gjendet certifikatë familjare e Sh. R., pa datë, përbërja e së cilës ishte nga pesë persona, ku statusi i subjektit ishte “beqar”.

⁸⁵ Kopje vërtetimi në gjuhën angleze, i lëshuar nga institucioni “*Universita degli Studi di Padova*”, Itali, datë 25.03.2014; dokument në gjuhën italiane, i lëshuar nga institucioni “*Universita degli Studi di Cagliari*”, Itali, datë 30.05.2018.

parashtrimet shtesë,⁸⁶ si dhe të dhënat nga aksesimi i burimeve të hapura,⁸⁷ të referuara nga subjekti i rivlerësimit, në mbështetje edhe të pretendimit të ngritur në parashtrime se, pas vitit 2006 e në vazhdim, krahas studimeve *Master*, i vëllai ka mbajtur edhe detyrën “*Collaboratore @ Osservatorio Economico Della Sardegna*”, dhe është trajtuar me pagesë, në eventualitetin e kapërcimit të ndalimit ligjor të neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, japin informacion në drejtim të faktit se vëllai i subjektit të rivlerësimit është larguar në gusht të vitit 2003 drejt shtetit italian, ku ka jetuar deri në vitin 2019, dhe ka fituar edhe shtetësinë italiane, por nuk përftohet informacion mbi ndonjë lloj të ardhure të përfituar prej tij nga puna, bursa etj., e për rrjedhojë, burimet e ligjshme për mbulimin e kostos së jetesës në Itali, për periudhën 2007 – 2009. Nga të dhënat nga burimet e hapura të referuara nga subjekti konfirmohet i njëjti informacion mbi kryerjen e studimeve nga ana e të vëllait, sipas periudhave të cituara më lart, dhe evidentohet se, në vitin 2006, ai ka qenë *Collaboratore @ Osservatorio Economico Della Sardegna* dhe se, në momentin e aksesimit, mbante pozicionin “Profesor i asociuar”, në Departamentin e Shkencave Statistikore të Universita degli Studi di Padova, por sërish nuk përftohet informacion mbi të ardhurat e përfituara dhe mbulimin e kostove të jetesës në periudhën 2007 – 2009. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me akte të gjendjes civile, shkëputjen e të vëllait E. R. nga trangu familjar i babait, z. Sh. R, trupi gjykues e konsideron atë pjesë përbërëse të familjes së babait në periudhën 2007 – 2009, objekt shqyrtimi, duke e përfshirë në shpenzimet e jetesës së familjes së tij. Ky vlerësim mbështetet edhe nga fakti se, nëse prindërit e subjektit të rivlerësimit, në periudhën 2005 – 2007 (kur subjekti i rivlerësimit ishte gjyqtar prej tetorit të vitit 2005), e ndihmonin atë⁸⁸, do të ishte e logjikshme të konsiderohet që ata kanë mbuluar shpenzimet për të birin, student në Itali, në periudhën 2007 – 2009, për më tepër kur nuk u arrit të provohet ndonjë lloj e ardhure e të vëllait, me të cilat ai ka mbuluar kostot e jetesës së tij në shtetin italian gjatë periudhës objekt shqyrtimi. Në këto rrethana, shpenzimet e jetesës së vëllait, z. E. R., në funksion të mundësisë së kursimit të familjes së z. Sh. R për këtë periudhë janë përlllogaritur si pjesë e familjes së z. Sh. R, duke iu referuar një analize garantiste të të dhënave të tabelës së konsumit për frymë, sipas ILDKPKI-së, bazuar në INSTAT në Shqipëri, për vitet 2007 – 2009, në shumën 509.208 lekë. Nëse këto shpenzime do të përlllogariteshin referuar të dhënave të EUROSTAT-it⁸⁹ për një person në Itali, në vitet 2007 – 2009, situata ekonomike e familjes së z. Sh. R. do të përkeqësohej dukshëm, pasi këto shpenzime do të kapnin vlerën prej 27.811 eurosh.

- Sa i takon argumenteve të subjektit të rivlerësimit lidhur me të motrën, znj. B. R., trupi gjykues evidenton fillimisht se subjekti i rivlerësimit, në ndryshim nga ankimi, në të cilin, duke argumentuar se e motra, B. R., ishte shkëputur nga trangu familjar që në vitin 2005, kur ka ardhur për studime në Fakultetin e Drejtësisë, Tiranë, të kryera në periudhën 2006 – 2010, ka pretenduar përjashtimin e saj nga shpenzimet e jetesës së familjes së z. Sh. R., duke kërkuar përlllogaritjen e tyre për 2 (dy) persona – në parashtrime ka pranuar që shpenzimet për të motrën të përfshihen në shpenzimet e familjes së z. Sh. R. të kësaj periudhe dhe ka kërkuar përlllogaritjen e tyre për 3 (tre) persona. Për këtë arsye, trupi gjykues

⁸⁶ (i) *Kopje e kartës së identitetit të shtetasit E. R., lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Italisë, Bashkia e Padovas, më datë 15.05.2019, me vërtetim përkthimi nr. {***} rep., datë 23.05.2025, nga gjuha italiane në gjuhën shqipe; (ii) Kopje leje qëndrimi e shtetasit E. R., lëshuar nga Ministria e Brendshme, Departamenti i Sigurisë Publike, Stacioni i Policisë së Padovas, Itali, më datë 05.05.2015, me vërtetim përkthimi nr. {***}, datë 23.05.2025, nga gjuha italiane në gjuhën shqipe; (iii) Kërkesë e subjektit të rivlerësimit dhe shkresë “kthim përgjigje” e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, me nr. {***} prot., datë 22.05.2025, origjinale, përmes të cilës përcillen të dhënat e sistemit TIMS mbi hyrje-daljet e shtetasit E. R. në shtetin shqiptar.*

⁸⁷ https://www.unipd.it/en/contatti/rubrica/?detail=Y&ruolo=I&checkout=cerca&persona=RULI&key={***} dhe https://rocketreach.co/postdoctoral-fellow-email_204754458

⁸⁸ Referuar deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësorin standard.

⁸⁹ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ilc_li01_custom_20699981/default/table

çmon të mos ndalet më gjatë në analizën e këtij pretendimi, në drejtim të mungesës së provueshmërisë së shkëputjes të së motrës, znj. B. R., nga certifikata familjare e z. Sh. R., dhe mbulimit të kostos së jetesës së saj në qytetin e Tiranës, duke e përfshirë atë në shpenzimet e jetesës së z. Sh. R.

- Në konkluzion të analizës së mësipërme, trupi gjykues vlerëson se ndryshimi i pretendimeve të subjektit të rivlerësimit mbi përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës së familjes së z. Sh. R., në ankim dhe në parashtrime, nga 2 (dy) në 3 (tre) persona, si dhe provat e depozituara me ankimin (përfshirë parashtrimet), përveçse nuk provuan se cila ishte përbërja familjare e z. Sh. R., për rrjedhojë anëtarët e familjes për të cilët do të llogariteshin shpenzimet e jetesës në periudhën 2007 – 2009, e bën atë të pabesueshëm në këtë pretendim. Për këtë arsye, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të kundërshtojë konkluzionin e Komisionit mbi përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës për familjen e z. Sh. R., për periudhën 2007 – 2009, për 5 (pesë) persona. Pavarësisht këtij konkluzioni, bazuar në sa arsyetuar më sipër në lidhje me subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues përlllogariti shpenzimet e jetesës për familjen e z. Sh. R. edhe në një analizë garantiste me 4 (katër) persona, duke e përjashtuar subjektin e rivlerësimit.

1/3. Lidhur me të ardhurat e babait nga emigracioni

51. Komisioni ka arritur në konkluzionin *se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me asnjë dokumentacion justifikues ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, të deklaruara si burimi i krijimit të shumës së dhënë hua prej babait të tij.*
52. Në ankim, subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur ndonjë shkak ankimi të posaçëm në lidhje me vlerësimin që Komisioni u ka bërë të ardhurave të pretenduara nga puna e babait nga emigracion, por ka pretenduar në mënyrë të përgjithshme që babai i tij ka pasur burime të ligjshme për dhënien e huas. Në shqyrtim të këtij pretendimi, nga verifikimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, rezulton se i vetmi dokument i paraqitur nga subjekti, në përgjigje të kërkesave të Komisionit për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave nga emigracioni, është deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.01.2020, e z. Sh. R., në të cilën konfirmohet mungesa e dokumentimit të tyre, për shkak se ka punuar në mënyrë informale. Në këto rrethana, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor, të ardhura të ligjshme të babait nga puna në emigracion.
53. Veç pretendimeve të mësipërme, në drejtim të burimeve të të ardhurave të babait për dhënien e huas, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se konkluzioni i Komisionit në paragrafin 1.47, në të cilin shprehet se: *“Referuar huamarrjes së babait të subjektit në ‘Fondin Besa’ dhe përqindjes së lartë të normës së kreditimit, të përdorur në këtë huadhënie, nuk tregon një situatë financiare të tillë të babait të subjektit, që të mundësonte krijimin e likuiditeteve cash nga babai i subjektit gjatë viteve 2003 – 2005”*, është i gabuar, mbështetur në argumentet si vijojnë:

53.1 Ndryshe nga sa konkludon Komisioni, sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 15.04.2022, të lëshuar nga institucioni financiar “Fondi Besa”, Dega Rajonale Gjirokastër, rezulton se: *“Sh. R. në datën 09.06.2003, ka marrë kredi pranë ‘Fondit Besa’ ShA, në shumën 500.000 ALL, me afat 24 muaj, me kontratën me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.06.2003, dhe e ka mbyllur kredinë në datën 22.06.2005. Klienti ka qenë shumë i rregullt me pagesat e kësteve”*.

53.2 Miratimi i dhënies së kredisë nga institucioni financiar përfshin analizimin e të ardhurave të kredimarrësit nga ana e këtij institucioni, për mundësinë e shlyerjes së kredisë në afat, në vlerësim të

riskut, duke përfshirë garancinë hipotekore, që është një mjet shtesë, i cili garanton institucionin për mundësinë e shlyerjes së kredisë.

53.3 Kredia është shlyer në afat, në një kohë të shkurtër dhe, duke pasur parasysh interesin financiar të aplikuar mbi vlerën e kredisë, vërteton përtej çdo lloj dyshimi, se babai i subjektit ka pasur mundësi financiare të ligjshme, të vërtetuara dhe të konsideruara si të tilla, edhe nga institucioni financiar.

53.4 Sipas një metodologjie të caktuar ekonomike, kredimarrësi duhet të ketë të ardhura trefish deri në pesëfish të vlerës së kështit, për të qenë në kushte optimale të shlyerjes së kredisë (kësti nuk mund të jetë me shumë se 30% e të ardhurave neto mujore).

53.5 Kredia e marrë nga babai në “Fondin Besa”, ka pasur si garanci mbi të ardhurat për shlyerjen e saj aktivitetin e babait si “marangoz”, çka faktori dhe vërteton kryerjen e kësaj veprimtarie/profesionit dhe investimi.

54. Në kuadër të shqyrtimit të këtij pretendimi, nga kontrolli i arsytimit të Komisionit,⁹⁰ trupi gjykues vëren se argumenti i marrjes së një kredie nga babai i subjektit pranë “Fondit Besa”, me përqindje të lartë të normës së kreditimit, përbën një element që i bashkëngjitet vlerësimit të Komisionit mbi situatën financiare të prindërve, sipas së cilës ata nuk kanë pasur gjendje likuiditetesh për dhënien e huas subjektit. Në këtë drejtim, trupi gjykues, referuar informacionit të përcjellë nga Fondi Besa⁹¹ gjatë hetimit administrativ, konstaton se z. Sh. R ka marrë, më datë 09.06.2003, një kredi pranë këtij institucioni financiar, në shumën 500.000 lekë, me afat 24 muaj, me interes 24% në vit ose 2% në muaj, detyrim të cilin e ka shlyer përfundimisht më datë 22.06.2005, duke paguar kështu çdo muaj për periudhën 01.07.2003 – 22.06.2005. Sipas kontratës së kredisë nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 03.06.2003, të lidhur mes palëve, rezulton se për shlyerjen e saj është vendosur si garanci hipotekore apartamenti i banimit me sipërfaqe 55.3 m², në pronësi të prindërve të subjektit, i ndodhur në qytetin e Libohovës, Gjirokastër. Të njëjtat fakte konfirmohen edhe në vërtetimin nr. {***} prot., datë 15.04.2022, të institucionit financiar “Fondi Besa”, të paraqitur nga subjekti në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, në mbështetje të pretendimeve mbi mjaftueshmërinë e të ardhurave të babait të tij.

55. Në analizë të këtyre fakteve, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit ka respektuar kushtet e vendosura në kontratë për shlyerjen e kredisë brenda afatit, duke kryer pagesat mujore të kësteve në mënyrë të rregullt, deri në likuidimin e plotë të saj, në qershor të vitit 2005. Në këto rrethana, trupi gjykues, në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit, sipas të cilës, verifikimi i mundësisë financiare të huadhënësit kryhet në kufijtë e shumës së dhënë hua, bazuar në raportin ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të jetesës së personit tjetër të lidhur, çmon se, edhe pse kjo e dhënë është tregues i mjeteve/instrumenteve financiare të përdorura prej z. Sh. R për veprimtarinë e tij, ajo nuk mund të shërbejë *a priori* për të arritur në përfundimin se, domosdoshmërisht, huadhënësi ndodhet në një situatë jo të mirë financiare për të krijuar/disponuar likuiditete *cash*.

56. Bazuar në sa arsyetuar më lart, trupi gjykues kreu analizën financiare mbi mundësinë e dhënies së huas nga babai, z. Sh. R., duke përllogaritur shpenzimet e jetesës për familjen e babait të subjektit të rivlerësimit, z. Sh. R., me 5 (pesë) persona. Nga kjo analizë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait për dhënien e huas, në vlerën e plotë të saj prej 3.000.000 lekësh, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të pretenduar si një ndër burimet

⁹⁰ Shih paragrafët 1.46 dhe 1.47 të vendimit.

⁹¹ Shkresë “kthim përgjigje” nr. {***} prot., datë 17.02.2020, e institucionit financiar “Fondi Besa”.

që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi në vitin 2009, për shkak të balancës negative në vlerën - 2.546.040 lekë. Edhe në variantin garantist të përllogaritjes së shpenzimeve të jetesës për familjen me 4 (katër) persona, rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme për dhënien e huas, në shumën - 2.036.832 lekë.

57. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit në lidhje me pasurinë “*Apartament banimi 2+1, me sipërfaqe 119.3 m²*”, rruga “{***}”, Tiranë, trupit gjykues, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, për periudhën 01.01.2009 – 12.11.2009, duke reflektuar në të sa arsyetuar në sipër, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve të ligjshme për pagesën e kështu prej 8.631.500 lekësh, për blerjen e këtij apartamenti, në shumën 9.000.000 lekë, për shkak të balancës negative prej -3.866.435 lekësh⁹², duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*Në lidhje me “apartament banimi, me sipërfaqe 119 m²”, rruga “{***}”, Tiranë*

58. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj pasurie, Komisioni ka arritur në konkluzionin se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, kur ka gjykuar tri çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{***}” ShPK, duke e vendosur atë në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion, duke parashtruar disa pretendime që paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

58.1 Ky konkluzion vjen në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, pasi: (i) kjo pasuri është përfituar nga një burim i ligjshëm (trashëgimia e bashkëshortes); (ii) është deklaruar saktë prej tij; (iii) nuk është përfituar në kushtet e konfliktit të interesit, pasi në vitin 2010, kur ajo është përfituar, ai ka qenë duke ushtruar detyrën pranë Gjykatës së Shkodrës; (iv) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri; (v) nuk është kryer fshehje e kësaj pasurie; (vi) nuk është kryer deklarim i rremë. Referuar jurisprudencës së Kolegjit,⁹³ analiza do të duhej të adresohet në drejtim të ligjit të zbatueshëm dhe efektit që këto situata sjellin në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, analizë që, në rastin konkret, do të duhet të përfundonte këtu, sepse pasuria nuk është krijuar në kushtet e konfliktit të interesit dhe, për kriterin e vlerësimit profesional, subjekti ka arritur nivel kualifikues.

58.2 Marrëdhënia e interesit së cilës i referohet Komisioni, mes bashkëshortes së tij dhe shoqërisë “{***}” ShPK, kishte përfunduar në vitin 2016, dhe është përfituar e marrë fizikisht prej bashkëshortes shumë kohë përpara se ai të gjykonte çështjen ku pretendohet se ishte në konflikt interesi. Kjo marrëdhënie, nga e cila nuk rezultoi të ketë lindur ndonjë mosmarrëveshje mes palëve, nuk përmbush kriteret për t’u quajtur “interes në procedim” apo si “shkak i rëndësishëm njëanshmërie”. Organet e rivlerësimit nuk kanë juridiksion dhe kompetencë për të vlerësuar sjelljen e subjekteve të rivlerësimit jashtë periudhës së rivlerësimit.

58.3 Në zbatim të nenit 72, pika 6 e K. Pr. Civile, subjekti ka paraqitur pranë Kryetarit të Gjykatës kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, duke i bërë të njohur me shkrim, por edhe verbalisht, kontratat e sipërmarrjes së viteve 2010 dhe 2012, si dhe aneks-kontratën e sipërmarrjes të vitit 2016,

⁹² Reduktimi i kësaj vlere nga - 4.322.620 lekë në - 3.866.435 lekë, vjen si pasojë e faktit se në Kolegj është konsideruar si e ardhur në analizën financiare të kësaj pasurie, likuiditeti i mbetur nga diferenca e të ardhurave minus shpenzime jetese, rezultuar nga analiza financiare për mundësinë e babait për dhënien e huas, ndërkohë që Komisioni e ka konsideruar të plotë mungesën e të ardhurës në vlerën 3.000.000 lekë, pa marrë në konsideratë vlerën e mbetur.

⁹³ Vendimet e Kolegjit nr. 16/2020, nr. 10/2020, nr. 15/2021 dhe nr. 8/2022.

ndërkohë që, për kontratën e sipërmarrjes së vitit 2017, nuk ka pasur dijeni. Subjekti ka parashtruar faktin se, pas refuzimit të kërkesës së tij nga Kryetari i Gjykatës, ai nuk kishte asnjë mundësi ligjore ta refuzonte gjykimin e çështjes apo ta adresonte në ndonjë organ tjetër kompetent. Gjithashtu, në zbatim të nenit 72 të K. Pr. Civile, ka njoftuar palët me kërkesën e tij për dorëheqje nga çështja, dhe asnjëra prej tyre nuk shfaqti kundërshtime apo të kërkonte përjashtimin e gjyqtarit. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, pas shqyrtimit të çështjes, nuk ka konstatuar papajtueshmëri nga ana e trupit gjykues dhe, për pasojë, nuk ka disponuar me prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, sipas nenit 467, pika “b” e K. Pr. Civile. Referuar kontratës së shkëmbimit të datës 21.10.2020, bashkëshortja e tij nuk ka përfituar asnjë trajtim preferencial nga ana e shoqërisë, sepse të gjithë bashkëpronarët kishin përfituar pjesët takuese, sipas përqindjes që ata kishin në pronësi.

59. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit në drejtim të marrëdhënies së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “{***}” ShPK, nga verifikimi i akteve në fashikullin e Komisionit, trupi gjykues konstaton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, si një ndër trashëgimtarët e familjes C., ka hyrë në një marrëdhënie kontraktore sipërmarrjeje me shoqërinë “{***}” ShPK, që në vitin 2010⁹⁴, duke i vënë në dispozicion kësaj të fundit truallin në bashkëpronësi për ndërtimin e një kompleksi polifunksional në Lalëz, Durrës, përkundrejt kalimit në pronësi të pronarëve të truallit të 30% të ndërtimit. Disa muaj pas kësaj kontrate, po në vitin 2010, ajo ka lidhur një tjetër kontratë sipërmarrjeje⁹⁵ me këtë shoqëri për porositjen e apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë (pasuri që do t’i zbritej nga pasuritë që do të përfitoheshin nga kontrata e mëparshme në Lalëz, Durrës). Në vitin 2012,⁹⁶ bashkëshortja e subjektit, së bashku me bashkëpronarët e tjerë, ka vendosur në dispozicion të shoqërive “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, një tjetër pasuri në bashkëpronësi, të ndodhur në Lalëz, Durrës, për ndërtimin e një kompleksi polifunksional, përkundrejt kalimit në pronësi të pronarëve të truallit, të 30% të ndërtimit. Përmes një tjetër aneks-kontrate sipërmarrjeje⁹⁷ të vitit 2016 është përcaktuar sipërfaqja ndërtimore totale që i takon znj. V. R., nga kontrata e parë e vitit 2010 dhe ajo e vitit 2012. Kjo e fundit është ekzekutuar me lidhjen e kontratës së shkëmbimit mes pronarëve të truallit në vitin 2020⁹⁸, ndër të cilët, znj. V. R., dhe palës sipërmarrëse e investitore në ndërtim, shoqërive “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, të cilat kanë konkluduar dhe përcaktuar në mënyrë të detajuar pjesën përfituese të sipërfaqes së truallit dhe sipërfaqes ndërtimore që i takon secilës palë. Në vitin 2017,⁹⁹ bashkëshortja e subjektit dhe të tjerë kanë rënë dakord të vendosin në dispozicion të shoqërisë “{***}” ShPK një tjetër pasuri (të përbërë nga disa pasuri/parceta) në bashkëpronësi, të ndodhur në Lalëz, Durrës, për projektimin dhe ndërtimin e një kompleksi polifunksional, përkundrejt kalimit në pronësi të pronarëve të truallit të së drejtave, sipas kësaj kontrate.

⁹⁴ Kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.05.2010.

⁹⁵ Kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 03.09.2010.

⁹⁶ Kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.06.2012. Në nenin IV parashikohet: “1. Me marrjen e lejes së ndërtimit nga ana e shoqërisë, midis palëve në këtë kontratë, do të lidhet kontrata e shkëmbimit me kusht, në të cilën do të përcaktohen në mënyrë më të detajuar të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe afatet për realizimin e tyre. [...]”.

⁹⁷ Aneks kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.10.2016. Në këtë aneks kontratë përcaktohet: [...] pasi të ketë përfunduar ndërtimi i strukturës turistike dhe të jetë regjistruar në hipotekë, do të lidhet kontrata e shkëmbimit midis tyre për kalimin e pronësisë së apartamenteve të pronari i truallit dhe të truallit të ndërtuesi i pallatit, në masën e përqindjeve që janë përcaktuar më lart.

⁹⁸ Kontratë shkëmbimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.10.2020, objekti i së cilës është: [...] ekzekutimi i kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.06.2012 dhe marrëveshjes së bashkësipërmarrësve nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.03.2015 [...], dhe ka si qëllim konkludimin dhe përcaktimin e detajuar të pjesës përfituese të sipërfaqes së truallit dhe sipërfaqes ndërtimore që i takon secilës palë.

⁹⁹ Kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.04.2017.

60. Në drejtim të gjykimit të çështjeve me palë ndërgjyqëse, shoqërinë “{***}” ShPK, dhe dorëheqjes së subjektit të rivlerësimit nga gjykimi i tyre, trupi gjykues konstaton se:

60.1 Nga informacioni i përcjellë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe ajo e Apelit¹⁰⁰, rezulton se subjekti i rivlerësimit, për periudhën 2013 – 2018, ka shqyrtuar tri çështje me palë ndërgjyqëse “{***}” ShPK: (i) Çështja nr. {***}, datë 25.08.2017, me objekt: *Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ, vendimeve për pezullimin e punimeve [...]*. Për këtë çështje, subjekti, me vendim nr. {***}, datë 29.08.2017, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë së paraqitur nga kërkuesi, shoqëria ‘{***}’ ShPK”*. [...] Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 13.02.2018, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 29.08.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, si e pabazuar në ligj. [...]”*. (ii) Çështja me nr. {***}, datë 25.08.2017, me objekt: *Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ, vendimeve për pezullimin e punimeve [...]*. Për këtë çështje, me vendimin nr. {***}, datë 29.08.2017, subjekti ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë së paraqitur nga kërkuesi, shoqëria ‘{***}’ ShPK”*. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 06.12.2018, ka vendosur: *Ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 29.08.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Refuzimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë. [...]”*... (iii) Çështja me nr. {***}, datë 04.09.2017, me objekt: *Konstatimi absolutisht i pavlefshëm dhe shfuqizimin e akteve administrative, vendimeve për pezullimin e punimeve [...]*. Me vendimin nr. {***}, datë 28.09.2017, subjekti ka vendosur *“Pranimin e kërkesëpadisë së paditësit, shoqëria ‘{***}’ ShPK”* [...].

60.2 Gjatë hetimit administrativ,¹⁰¹ subjekti ka shpjeguar se, duke çmuar marrëdhënien që bashkëshortja e tij kishte pasur me palën kërkuese, shoqëria “{***}” ShPK, i ka kërkuar dorëheqjen nga gjykimi i këtyre çështjeve Kryetarit të Gjykatës, i cili ka vendosur për mospranim. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti ka paraqitur: (i) Kërkesë e datës 25.08.2017, për heqjen dorë¹⁰² nga gjykimi i çështjes administrative me nr. {***}, datë 25.08.2017, drejtuar Kryetarit të Gjykatës, në të cilën ka parashtruar rrethanat: *Bashkëshortja ime, V. R., me palën kërkuese, ka pasur një marrëdhënie kontraktore, kontratë sipërmarrje, mbi bazën e së cilës ka përfituar dy objekte (nga trashëgimia). Edhe pse objektet e ndërtuara nga pala kërkuese janë përfituar nga bashkëshortja, unë, si gjyqtar, për të shmangur çdo lloj paragjykimi nga palët, çmoj se duhet të paraqes dorëheqjen nga gjykimi i kësaj çështjeje”, dhe vendimin nr. {***}, datë 29.08.2017, të Kryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me anë të të cilit është vendosur mospranimi i kërkesës për heqje dorë të gjyqtarit Emiljano Ruli nga çështja nr. {***}, datë 25.08.2017, si e pabazuar në nenin 71/3/6 të K. Pr. Civile. (ii) Kërkesë e datës 25.08.2017, për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes administrative me nr. {***}, datë 25.08.2017, në të cilën referohet dhe parashtrohet e njëjta bazë ligjore dhe rrethanë, si në kërkesën e cituar më sipër, dhe vendimin nr. {***}, datë 29.08.2017, të Kryetarit të Gjykatës për mospranimin e kërkesës. (iii) Kërkesë e datës 08.09.2017, për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes administrative me nr. {***}, datë 04.09.2017, në të cilën, sërish, referohet dhe parashtrohet e njëjta bazë ligjore dhe rrethanë si më sipër, si dhe vendimi nr. {***}, datë 08.09.2017, i Kryetarit të Gjykatës, për mospranimin e*

¹⁰⁰ Shkresë “kthim përgjigje” nr. {***} prot., datë 04.11.2021, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe shkresë “kthim përgjigje” nr. {***} prot., datë 07.04.2022, e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

¹⁰¹ Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3.

¹⁰² Si bazë ligjore e kësaj kërkesë referohen: neni 1/2 i ligjit nr. 49/2012, nenet 72/4 dhe 73 të K. Pr. Civile, vendimi nr. {***}, datë 24.12.2008, i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

kërkesës. Në përfundim të hetimit administrativ, në kundërshtim të barrës së provës,¹⁰³ subjekti ka shpjeguar në mënyrë të përmbledhur se, pavarësisht se marrëdhënia kontraktore e bashkëshortes me shoqërinë “{***}” ShPK kishte përfunduar, pasi objektet e përfituara janë marrë fizikisht pas lidhjes së aneks-kontratës së sipërmarrjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.10.2016, nga ana e tij, bazuar në nenin 72, pika 7 e K. Pr. Civile, në nenin 13/2 dhe 39/1, shkronja “a” e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, si dhe në rezolutën me 10 parimet bazë, të miratuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, i kishte paraqitur Kryetarit të Gjykatës kërkesën për heqjen dorë nga shqyrtimi i këtyre rasteve. Sipas subjektit, Kryetari i Gjykatës ishte njohur nëpërmjet kërkesës së tij formale edhe verbalisht, por edhe provave të para prej tij fizikisht, lidhur me kontratat e sipërmarrjes së datave 04.05.2010, 03.09.2010, 29.06.2012, si dhe aneks-kontratën e sipërmarrjes, të datës 22.10.2016. Pas njohjes me kërkesat e tij dhe faktet e parashtruara, Kryetari i Gjykatës kishte vendosur mospranimin e tyre. Më tej, subjekti ka sqaruar se gjatë kohës së zhvillimit të proceseve gjyqësore, ai nuk ka qenë në dijeni të kontratës së sipërmarrjes së datës 30.04.2017, e cila ka qenë një kontratë premtimi për zhvillimin e pronës, për më tepër që, pas kalimit të afatit njëvjeçar për marrjen e lejes së ndërtimit, marrëdhënia me shoqërinë “{***}” ShPK është ndërprerë. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se, në vitin 2017, nuk mund të kishte dijeni se çfarë do të ndodhte në vitin 2020, duke iu referuar aneks-kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.01.2020.

61. Në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren fillimisht se konkluzioni i arritur nga Komisioni, në përfundim të shqyrtimit të kësaj pasurie, i atribuohet situatës së konfliktit të interesit, në të cilën është gjendur subjekti i rivlerësimit, me gjykimin e tri çështjeve gjyqësore nga ana e tij, në vitin 2017, me palë paditëse shoqërinë “{***}” ShPK, për shkak të ekzistencës së marrëdhënies kontraktore mes bashkëshortes së tij dhe kësaj shoqërie në këtë periudhë, referuar dy kontratave të sipërmarrjes të viteve 2010 dhe 2012, si dhe një tjetër kontratë sipërmarrjeje të vitit 2017, afërsisht 4 muaj përpara shqyrtimit të çështjeve¹⁰⁴. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se problematika e evidentuar nga Komisioni në këtë rast, e cila nuk lidhet me ligjshmërinë e origjinës së krijimit të kësaj pasurie dhe mënyrën e përfitimit të saj, në kushtet e konfliktit të interesit, nuk mund të prodhojë pasojën ligjore të parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016.
62. Përveç sa më lart, trupi gjykues vlerëson se analiza ligjore e rastit duhet të ishte orientuar drejt kuadrit ligjor të zbatueshëm, parashikimeve të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, në të cilin përcaktohet rrethi i interesave pasurorë dhe gjendja e konfliktit të interesit, si dhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, në të cilat parashikohen kushtet dhe procedurat se si një gjyqtar duhet ta deklarojë dhe ta shmangë atë. Bazuar në situatën faktike në rastin konkret, trupi gjykues, referuar nenit 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile, vëren se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur tri kërkesa¹⁰⁵ për të hequr dorë nga gjykimi i çështjeve administrative, me qëllim shmangien e çdo lloj paragjykimi nga palët, për shkak të ekzistencës së një marrëdhënieje kontraktore të bashkëshortes së tij, mbi bazën e së cilës ajo kishte përfitur dy objekte nga trashëgimia, por pa konkretizuar kontratën e sipërmarrjes për të cilën bëhej fjalë, si dhe faktin nëse kjo marrëdhënie kishte përfunduar ardhjen e pasojave. Duke e ekspozuar të cunguar rrethanën e marrëdhënies kontraktore, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk i ka dhënë Kryetarit të Gjykatës mundësinë për të

¹⁰³ Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i ka kaluar barra e provës në lidhje me: “Duket se subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit në gjykimin dhe vendimmarrjen e çështjeve administrative me nr. {***}, datë 25.08.2017; nr. {***}; nr. {***}, datë 04.09.2017.

¹⁰⁴ Shih paragrafin 2.27 të vendimit.

¹⁰⁵ Në këto kërkesa referohet si bazë ligjore neni 72, pika 4 dhe neni 73 i Kodit të Procedurës Civile.

vlerësuar në mënyrë të plotë arsyet e ekzistencës ose jo, të shkaqeve të parashikuara për përjashtimin e gjyqtarit, sipas nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile. Në këto kushte, problematikat e konstatuara me të drejtë nga Komisioni, lidhur me mosparaqitjen në kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi i të gjitha fakteve dhe rrethanave, të cilat, sipas subjektit të rivlerësimit, e vendosin atë në kushtet për heqjen dorë nga gjykimi i çështjeve, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, në vlerësimin e trupit gjykues do të duhet të adresoheshin në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale.

Në lidhje me automjetin tip “Mercedes-Benz”, blerë në vitin 2015

63. Komisioni ka arritur në konkluzionin se, në analizë të burimit të deklaruar në deklaratën vetting, lidhur me pasurinë e luajtshme “automjet” tip “Mercedes-Benz”, sipas një vlerësimi tërësor të hallkave të zinxhirit të burimit të pretenduar, trupi gjykues arrin në konkluzionin se, pavarësisht përpjekjeve, subjekti dështoi të provojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, duke u ndodhur në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
64. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion si të pabazuar në provat e administruara gjatë hetimit administrativ dhe në jurisprudencën e Kolegjit, duke pretenduar se, nga përlllogaritjet e kryera në datën e blerjes së automjetit, ai ka pasur mjaftueshmëri burimesh financiare për blerjen e këtij automjeti, bazuar në argumentet që parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si vijon:

64.1 Si burim krijimi për automjetin tip “Mercedes - Benz”, të deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting, kanë shërbyer edhe të ardhurat në shumën prej 900.000 lekësh, nga shitja e autoveturës tip “Mercedes-Benz”, me targa {***}, sipas kontratës së shitblerjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.02.2015, shitur shtetasit A. K. Ky automjet ishte blerë nga subjekti, më datë 05.03.2011, nga shtetasi B. Z., kundrejt çmimit 7.000 euro, pasi ka pasur ndërhyrje në matësin e kilometrave (defekt jo i dukshëm), i cili i ulte vlerën makinës, për shkak të amortizimit, vërtetuar ky fakt me shkresën “kthim përgjigje” të shoqërisë “{***}” ShPK, datë 22.11.2021, dhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.04.2022, të shtetasit B. Z., të depozituara në Komision.

64.2 Çmimi i shitjes së automjetit, në vlerën 900.000 lekë, në vitin 2015, (rreth 84.000 lekë¹⁰⁶ më pak se çmimi i blerjes prej 7.000 eurosh, në vitin 2011) ka qenë real, pasi kjo shumë është paguar nëpërmjet transfertës bankare, nga llogaria e blerësit, në llogarinë e bashkëshortes së subjektit, dhe ky fakt është deklaruar në DIPP-në e vitit 2015, si dhe në deklaratën e pasurisë vetting, pra nuk ka pasur asnjë qëllim për fshehjen e tij.

64.3 Automjeti “Volkswagen Passat”, të ardhurat nga shitja e të cilit kanë shërbyer si burim për blerjen e automjetit të mësipërm, në datën 05.03.2011, ka qenë prodhim i viteve 2004 – 2005, dhe është blerë nga subjekti me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2009, në gjendje të dëmtuar, pas premtimit të ortakut të shoqërisë “{***}” ShPK, z. E. F., për riparimin e tij me kosto të ulët. Shpenzimet e kryera për riparimin tërësor të këtij mjete ishin rreth 3.000 euro, pjesa më e madhe e të cilave i janë shlyer z. F. në vitin 2011, pasi subjekti ka përfituar shumën prej 7.500 euro nga shitja e automjetit, vëllait të gruas, z. J. G. Këto fakte konfirmohen me shkresën “kthim përgjigje”, të datës 22.11.2021, të shoqërisë “{***}” ShPK, dhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.04.2022, të z. J. G.

¹⁰⁶ Subjekti i rivlerësimit i referohet arkivit të kursit të këmbimit për vitin 2011, të Bankës së Shqipërisë, paraqitur në Komision.

64.4 Nga analiza financiare e Komisionit, dërguar bashkëlidhur rezultateve të hetimit, nuk konstatohen pamjaftueshmëri financiare për blerjen e automjeteve, si në vitin 2009, ashtu edhe në vitin 2011, pavarësisht se Komisioni, në analizën e vitit 2011, çmimin e shitjes së automjetit “Volkswagen Passat” e ka përlllogaritur vetëm në vlerën e blerjes. Ky fakt duhet t’i kishte krijuar bindjen trupit gjykues për vlerat reale të shitjes dhe blerjes së automjeteve, në vlerat që ato janë përcaktuar në kontratat e shitblerjes, përndryshe, analiza financiare do të kishte një situatë të ndryshme nga ajo e paraqitur nga Komisioni në analizën financiare të vitit 2011. Përderisa nga analiza financiare e viteve kur janë blerë automjetet (përfshirë edhe automjetin e shitur në vitin 2015), nuk janë konstatuar pamjaftueshmëri financiare, vlera e shitjes së automjetit në analizën e vitit 2015, referuar praktikës së konsoliduar të Komisionit, por edhe të Kolegjit,¹⁰⁷ duhet të ishte vendosur sipas çmimit të shitjes së këtij automjeti.

65. Nga kontrolli i arsytimit në vendim, trupi gjykues vëren se konkluzioni i Komisionit, që subjekti i rivlerësimit dështoi të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të këtij automjeti, duke i ngarkuar pasojën ligjore të parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “b”, i atribuohet veprimeve financiare të pajustificuara të kryera nga subjekti, në drejtim të vlerave të shitblerjeve të automjeteve që kanë shërbyer si burim krijimi zinxhir për njëri-tjetrin, konkretisht¹⁰⁸: (i) subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë vlerat reale të shitjes dhe blerjes së automjetit “DaimlerChrysler”, me targa {***}, i cili ishte blerë nga subjekti më datë 05.03.2011, në vlerën 7.000 euro, ndërkohë që shitësi, B. Z., e kishte blerë këtë automjet në fund të vitit 2010, në vlerën 13.180 euro. (ii) Subjekti nuk provoi defektet e pretenduara të automjetit për një periudhë 3-mujore, që sollën zvogëlimin e vlerës së shitjes nga shitësi i saj, dhe as shpenzimet e bëra më pas, që çuan në shitjen pas katër vitesh në qarkullim, në vlerën 900.000 lekë. (iii) Shitja dhe blerja e automjetit “Volkswagen Passat”, që ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit “DaimlerChrysler”, në datën 05.03.2011, janë veprime financiare të pajustificuara, pasi ky automjet, i blerë në vitin 2009, në vlerën 500.000 lekë, iu shit vëllait të bashkëshortes së subjektit, më datë 30.12.2012, në vlerën 10.000 euro.
66. Në shqyrtim të shkakut të ankimit, trupi gjykues kontrolloi burimin e krijimit të automjetit “Mercedes-Benz”, të blerë në vitin 2015, në drejtim të pasojës ligjore dhe argumenteve si më sipër të Komisionit, duke marrë në analizë transaksionet e shitblerjeve të automjeteve që kanë shërbyer si burim për krijimin e njëri-tjetrit, dhe të automjetit objekt shqyrtimi.
67. *Lidhur me automjetin “DaimlerChrysler”, me targa {***}”, blerë më datë 05.03.2011 dhe shitur më datë 02.02.2015, trupi gjykues konstaton se:*

67.1 Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar automjetin tip “Mercedes-Benz”, blerë me kontratë shitblerje automjeti, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.03.2015, nga shitësi D. D.. Çmimi i blerjes: 1.500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar: (i) të ardhura nga paga e bashkëshortes; (ii) shumën 900.000 lekë, të transferuar në Credins Bank, nga z. A. K., në datën 02.02.2015, për blerje automjeti; (iii) shumën prej 226.380 lekësh, e përfituar si bonus nga bashkëshortja, nga “Universiteti i Nju-Jorkut”, Tiranë, e depozituar më datë 31.10.2011.

67.2 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” si më sipër, me të njëjtin çmim, por pa deklaruar burimin e krijimit. Në këtë deklaratë deklarohet edhe: *“Kontratë shitblerje automjeti, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.02.2015, me palë shitëse Emiljano Ruli dhe V. R., me palë blerëse A. K., lloji i automjetit ‘Mercedes-Benz’. Çmimi i blerjes është*

¹⁰⁷ Vendimi i Kolegjit nr. 5/2019 (JR).

¹⁰⁸ Shih paragrafët 3.29 - 3.31 të vendimit të Komisionit.

transferuar nga A. K., nëpërmjet Credins Bank, në llogarinë e bashkëshortes V. R., në Raiffeisen Bank. Vlera: 900.000 lekë. Pjesa takuese: ½ (ose 50%)”.

67.3 Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar: “[...] 2. Kontratë shitblerje e pasurisë së luajtshme (automjet tip ‘Daimler Chrysler’), me palë shitëse B. Z., me palë blerëse Emiljano Ruli, me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 05.03.2011, me çmim 7.000 euro. Pjesa takuese: 50%. [...]”. Nuk deklarohet burimi i krijimit.

67.4 Nga dokumentacioni i përcjellë nga DPSHTRr-ja,¹⁰⁹ rezulton se automjeti i markës “DaimlerChrysler”, me vit prodhimi 2006, është blerë nga subjekti me kontratë shitblerjeje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.03.2011, nga shitësi B. Z., në vlerën 7.000 euro. Në këtë kontratë, ndër të tjera, përcaktohet se: “Palët deklarojnë se janë likuiduar në mes tyre për këtë shumë shitblerje dhe se nuk kanë më asnjë lloj detyrimi as tani dhe as në të ardhmen. Pala blerëse deklaroi se e ka marrë në dorëzim automjetin në fjalë dhe se nuk ka asnjë lloj pretendimi për gjendjen teknike të këtij automjeti”. Shtetasi B. Z. e kishte blerë këtë automjet me faturën e shitjes së datës 19.11.2010, në Itali, në vlerën 9.000 euro, dhe ka paguar sipas deklaratës doganore, të datës 07.12.2010, detyrimin në shumën 579.570 lekë. Me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.02.2015, ky automjet, i referuar në këtë kontratë i markës “Mercedes-Benz”, me targa {***}, është shitur nga subjekti dhe bashkëshortja të blerësi A. K., në vlerën 900.000 lekë.

67.5 Gjatë hetimit administrativ, i pyetur mbi arsyet e shitjes së këtij automjeti me një çmim më të lartë nga sa ishte blerë, subjekti ka shpjeguar¹¹⁰ se çmimi i blerjes prej 7.000 eurosh dhe ai i shitjes prej 900.000 lekësh ka qenë pothuajse i njëjtë, për shkak se makina nuk është përdorur shumë prej tij dhe ka qenë në gjendje shumë të mirë motorike dhe xhenerike. I pyetur më tej mbi koston e blerjes së këtij automjeti me një çmim rreth 5.000 euro, më pak nga sa e kishte blerë shitësi B. Z., dhe marrëdhënien e tij me këtë shtetas, subjekti ka deklaruar¹¹¹: “[...] në fund të muajit shkurt 2011, kam shkuar te tregu i makinave në Shijak dhe kam parë automjetin tip “DaimlerChrysler [...]”. Automjetin e mësipërm e kam çuar personalisht, së bashku me shitësin, për kontroll pranë autoservis “{***}”. Pas kontrollit dhe diagnostifikimit që iu bë automjetit me kompjuter, rezultoi se ai kishte një diferencë shumë të madhe (rreth 2.5 herë më shumë) ndërmjet kilometrave që kishte të regjistruara te matësi i kilometrazhit, me ato që kishte bërë faktikisht mjeti. [...] Nga ana e pronarit të autoservisit, menjëherë, më është thënë se vlera e këtij automjeti, për shkak të numrit shumë të madh të kilometrave që ka bërë, nuk është më shumë se 6.000 euro. [...] Pas disa ditësh, në fillim të muajit mars 2011, shitësi i automjetit, z. B. Z., më ka telefonuar, duke më propozuar blerjen e mjetit me një çmim tjetër. Pas disa negociatave, ramë dakord që automjetin tip “DaimlerChrysler” ta blej me çmimin 7.000 euro. Pas dakordësimit, kemi lidhur kontratën përkatëse për blerjen e automjetit. Me shtetasin B. Z., njohja ka qenë krejt rastësore, ditën që kam parë automjetin. [...] Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti ka paraqitur kërkesë dhe shkresë “kthim përgjigje”, të datës 22.11.2021, nga shoqëria “{***}” ShPK, me administrator dhe ortak z. E. F., i cili ka konfirmuar deklaratimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit.

67.6 Në përfundim të hetimit administrativ, në kundërshtim të barrës së provës,¹¹² subjekti ka sqaruar

¹⁰⁹ Shkresë “kthim përgjigje” nr. {***} prot., datë 10.02.2020, nga DPSHTRr-ja.

¹¹⁰ Përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

¹¹¹ Përgjigjet e pyetësorit nr. 3.

¹¹² Subjektit i ka kaluar barra e provës, duket se: -- shpjegimet e subjektit nuk i krijojnë bindjen trupit gjykues për vlerat reale të shitjes dhe të blerjes së këtij automjeti, pasi shitësi B. Z. e ka blerë automjetin në fund të vitit 2011, në vlerën totale prej 13.180 eurosh, dhe ia ka shitur subjektit në shumën 7.000 euro, më datë 05.03.2011; si dhe subjekti nuk ka provuar defektet e pretenduara të këtij automjeti, të cilat, për një periudhë 3-mujore, kanë sjellë zvogëlim të vlerës së tij me 50%; -- ky automjet është shitur në vitin 2015, në vlerën 900.000 lekë, dhe subjekti nuk arriti të provojë shpenzimet e bëra për rritjen e vlerës së automjetit, për shitjen e tij në një vlerë më të madhe se ajo e shpenzuar për blerjen e tij, në vitin 2011, referuar edhe faktit se

se nuk ka deklaruar asnjëherë shpenzime për rritjen e vlerës së automjetit, sepse realisht nuk ka bërë të tilla, pasi mjeti, përveç ndërhyrjes në matësin e kilometrave, duke iu ulur kilometrat, nuk kishte defekte të tjera. Sipas tij, referuar kursit të këmbimit të lekut me monedhën euro, në mars të vitit 2011 (sipas arkivit të kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, për vitin 2011, 1 euro konvertohej me 140.57 lekë), çmimi i blerjes së këtij automjeti ka qenë 983.990 lekë, ndërkohë që është shitur në vitin 2011 për vlerën 900.000 lekë, pra rreth 84.000 lekë më pak. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur prapësimeve, edhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.04.2022, të shitësit B. Z., në të cilën ai ka deklaruar se makinën e kishte blerë në Itali, në mirëbesim, dhe, për shkak të vështirësive ekonomike, kishte vendosur ta shiste të blerësi Emiljano Ruli, në vlerën e propozuar, rreth 7.000 euro.

68. Në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, nga analizimi i transaksionit të blerjes së automjetit “DaimlerChrysler”, trupit gjykues i rezulton se kjo pasuri është blerë me kontratë noteriale të shitblerjes në datën 05.03.2011, e cila, në kuptim të nenit 690¹¹³ të Kodit Civil dhe nenit 253¹¹⁴ të Kodit të Procedurës Civile, ka fuqi të plotë provuese lidhur me faktet që parashikohen në të. Në këtë kontratë, palët kanë deklaruar me vullnet të plotë çmimin e blerjes 7.000 euro, si dhe faktin që pala blerëse (subjekti) nuk ka pretendime mbi gjendjen teknike të automjetit. Në këtë drejtim, aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, si shkresa “kthim përgjigje”, e shoqërisë “{***}” ShPK dhe deklarata noteriale e shtetasit B. Z., përmes të cilave subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të provojë një fakt ndryshe nga sa është parashikuar në aktin noterial (problematikën në matësin e kilometrave të automjetit në momentin e blerjes), nuk mund të rrëzojnë parashikimet e kontratës së shitblerjes. Sa i takon transaksionit të shitjes së këtij automjeti, nga 7.000 euro, më datë 05.03.2011, në 900.000 lekë, më datë 02.02.2015, pra pasi është përdorur për 4 (katër) vite, nga një përllogaritje e thjeshtë, referuar normës 20% të amortizimit për automjetet, të përcaktuar në listimin e normave të amortizimit në nenin 22 të ligjit nr. 8438, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe të përdorshme nga administrata fiskale, vlera e mbetur e mjetit pas katër vitesh përdorimi, pasi nga vlera fillestare e mjetit, prej 983.990¹¹⁵ lekësh, do të zbritej amortizimi në vlerën e mbetur pas çdo viti, do të rezultonte në shumën 403.042 lekë, ndërkohë që mjeti është shitur për 900.000 lekë. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për të konsideruar jobindëse argumentet e subjektit të rivlerësimit lidhur me çmimin e blerjes dhe më pas shitjes së këtij automjeti. Trupi gjykues ka analizuar në vijim, bazuar në pretendimet e subjektit të rivlerësimit, edhe burimin e krijimit (automjet “Volkswagen Passat”), që ka shërbyer për blerjen e këtij automjeti.
69. Lidhur me automjetin “Volkswagen Passat”, blerë më datë 23.03.2009 dhe shitur më datë 30.12.2011, trupi gjykues konstaton se:

69.1 Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “1. Kontratë shitje e pasurisë së luajtshme (automjet tip “Volkswagen Passat”), me palë shitëse Emiljano Ruli dhe V. R., me palë blerëse J. G., me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.12.2011, me çmim 10.000 euro. 2. Kontratë shitblerje e

automjeti ka qenë rreth 4 vite në qarkullim dhe ka pasur edhe kosto amortizimi për këto vite; -- për rrjedhojë, çmimi i referuar dhe shpjegimet e subjektit, nuk janë bindëse lidhur me vlerën reale të blerjes dhe të shitjes së këtij automjeti.

¹¹³ Ky nen përcakton se: “Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”.

¹¹⁴ Ky nen përcakton se “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklaratimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre. Lejohet të provohet e kundërta vetëm kur pretendohet se shkresa është e falsifikuar”.

¹¹⁵ Referuar arkivit të kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në mars 2011 (1 euro = 140.57 lekë).

pasurisë së luajtshme (automjet tip “DaimlerChrysler”), me palë shitëse B. Z., me palë blerëse Emiljano Ruli, me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 05.03.2011, me çmim 7.000 euro. Pjesa takuese: 50%”. Nuk deklarohet burimi i krijimit. [...]. Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kontratë shitje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.09.2009, tip “Mercedez”, viti 1997. Vlera e shitjes 500.000 lekë. Kontratë blerje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2009, tip “Volkswagen Pasat”. Vlera e blerjes 500.000 lekë.

69.2 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për blerjen e automjetit të markës “DaimlerChrysler”, më datë 05.03.2011: “5.000 euro nga kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol. datë 10.02.2011, me palë shitëse trashëgimtarët e familjes C., krahas tyre, bashkëshortja V. R. si bashkëpronare, [...] për pasurinë me sipërfaqe 10.000 m², e ndodhur në Lalëz, Durrës [...]. Nga kjo shitje, bashkëshortes V. R. i takonte shuma 2.500 euro. Ndërkohë, sipas marrëveshjes së bërë me vëllain J. G., të cilit i është shitur paraprakisht automjeti tip “veturë”, marka “Volkswagen Passat”, targa “{***}” (ndërsa, me akt noterial, është bërë me kontratën nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 30.12.2011), pjesën takuese të tij nga shitja e pasurisë, prej 2.500 eurosh, ia kalonte së motrës, në funksion të blerjes së automjetit, marka “Volkswagen Passat” [...]. Po kështu, vëllai i bashkëshortes, J. G., diferencën e mbetur prej 7.500 eurosh, nga çmimi 10.000 euro, me të cilin iu shit automjeti marka “Volkswagen Passat”, ia ka dhënë bashkëshortes paraprakisht. Nga kjo shumë është shlyer pjesa e mbetur prej 2.000 eurosh për blerjen e automjetit. Me sa më kujtohet, mënyra e pagesës së kësaj shume, shitësit B. Z., është bërë me para në dorë (cash), kjo sipas kërkesës së tij. [...]”.

69.3 Nga dokumentacioni i DPSHTRr-së¹¹⁶ rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.12.2011, i kanë shitur blerësit J. G. autoveturën e markës “Volkswagen Passat” (viti i prodhimit 2004), kundrejt çmimit 10.000 euro, shumë e likuiduar shitësit përpara redaktimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale. Ky automjet ishte blerë nga subjekti i rivlerësimit me kontratë shitje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.03.2009, në vlerën 500.000 lekë, e likuiduar nga blerësi me firmosjen e kontratës. Në këtë kontratë, nuk ka përcaktime lidhur me gjendjen teknike të automjetit.

69.4 Gjatë hetimit administrativ, lidhur me çmimin e blerjes në vlerën 500.000 lekë dhe atë të shitjes, 10.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar¹¹⁷: “[...] dua të theksoj se automjeti tip ‘Volkswagen Passat’ ka qenë prodhim i vitit 2004 – 2005 dhe është blerë në gjendje të dëmtuar, prandaj është blerë me vlerë aq të vogël. Makina është riparuar nga ana ime në servis dhe me shpenzime shumë të vogla e të shtrira në kohë. Në momentin që makina është shitur (pas riparimit), ishte në gjendje shumë të mirë motorike dhe xhenerike, dhe prandaj është shitur pothuajse me çmimin që ka pasur në treg, duke i bërë një zbritje të vogël, për shkak të marrëdhënies familjare që kam me blerësin, J. G. (vëllai i bashkëshortes)”.

69.5 Në vijim, në përgjigje të kërkesës së Komisionit për të provuar shpenzimet e kryera, si dhe mënyrën e likuidimit të shumës prej 10.000 eurosh, nga J. G., subjekti ka deklaruar se¹¹⁸: “[...] Shtetasi E. F., me të cilin unë kam njohje [...] në fillim të vitit 2009, më ka njoftuar se ishte paraqitur pranë servisit të tij një automjet tip ‘Volkswagen Passat’, i dëmtuar, të cilin pronari donte ta shiste dhe e shiste me çmim

¹¹⁶Shkresë “kthim përgjigje”, nr. {***} prot., datë 10.02.2020, nga DPSHTRr-ja.

¹¹⁷ Përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

¹¹⁸ Përgjigjet e pyetësorit nr. 3.

shumë të leverdishëm, për shkak të dëmtimit që kishte. [...] Pasi mjeti është riparuar, ku janë ndërruar pjesët e dëmtuara, është lyer e pastruar, ai ka dalë në gjendje shumë të mirë motorike dhe xhenerike. Shpenzimet e kryera për riparimin tërësor të këtij mjeti janë rreth 3.000 euro. [...] Dua të theksoj se, sipas marrëveshjes së bërë me vëllain e bashkëshortes, J. G., të cilit i është shitur paraprakisht automjeti [...] diferencën e mbetur prej 7.500 eurosh, nga çmimi 10.000 euro, me të cilin iu shit automjeti [...], ia ka dhënë bashkëshortes paraprakisht. Nga kjo shumë është shlyer pjesa e mbetur prej 2.000 eurosh për blerjen e automjetit. Pra, 4.500 euro nga çmimi i shitjes 10.000 euro të automjetit 'Volkswagen Passat' janë përdorur për blerjen e automjetit të llojit 'Mercedes-Benz' (DaimlerChrysler), në shumën 7.000 euro. [...] Shuma e mësipërme është likuiduar cash nga vëllai i bashkëshortes, J. G.". Subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtat shpjegime edhe mbi rezultatet e hetimit¹¹⁹, të dërguara nga Komisioni. Në mbështetje të deklarimeve të tij mbi shpenzimet e kryera për automjetin dhe shitjen e tij në gjendje shumë të mirë vëllait të bashkëshortes, subjekti ka paraqitur shkresë "kthim përgjigje", të datës 22.11.2021, të shoqërisë "{***}" ShPK, dhe deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.04.2022, të J. G., në të cilat konfirmohen deklaratimet e subjektit të rivlerësimit.

70. Bazuar në sa më lart, referuar kontratave noteriale të blerjes dhe të shitjes së automjetit "Volkswagen Passat", përkatësisht të datave 23.03.2009 dhe 30.12.2011, trupit gjykues vëren se vlera e këtij automjeti, me kalimin e viteve, është rritur nga 500.000 lekë, në 10.000 euro. Në analizë të shkaqeve që mund të kenë sjellë një rritje të tillë të çmimit, duke mbajtur në konsideratë fuqinë provuese të kontratës noteriale të shitblerjes, në kuptim të nenit 690 të Kodit Civil dhe të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit, në drejtim të fuqisë së kufizuar provuese të deklaratave noteriale, të paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit, të pambështetura në akte të kohës, trupit gjykues nuk i rezulton e provuar problematika mbi gjendjen teknike të automjetit "Volkswagen Passat" në momentin e blerjes, si dhe nuk rezultojnë të dokumentuara në kohë shpenzimet e kryera për riparimin e automjetit, të pretenduara nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe në ankim. Në këto kushte, trupit gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit, se transaksionet e blerjes dhe të shitjes së këtij automjeti janë veprime financiare të pajustificuara, pasi një automjet i vitit 2004 është shitur rreth shtatë vite më vonë, më shumë se dyfishi i çmimit të blerjes. Veç kësaj, trupit gjykues i Kolegjit çmon të evidentojë në këtë rast edhe faktin se data e mëvonshme e shitjes së automjetit "Volkswagen Passat", më 30.12.2011, nga data e blerjes së automjetit "DaimlerChrysler", më 05.03.2011, në mungesë të parashikimit kontraktor apo çdo dokumenti tjetër provues mbi datën e saktë të likuidimit të çmimit (i kryer në *cash*) nga vëllai bashkëshortes, e bën të pamundur disponimin e të ardhurave nga shitja e mjetit "Volkswagen Passat", më datë 05.03.2011 dhe, për rrjedhojë, ato nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e automjetit "DaimlerChrysler". Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me mungesë të burimeve financiare të blerjes së këtij automjeti, në vlerën e plotë prej 7.000 eurosh ose 983.990 lekësh. Pavarësisht këtij konkluzioni, nga një analizë garantiste, duke pranuar të disponueshme, në datën 05.03.2011, vetëm vlerën e blerjes së automjetit "Volkswagen Passat", në shumën prej 500.000 lekësh, mungesa e burimeve për blerjen e automjetit "DaimlerChrysler", me targa {***}, më datë 05.03.2011, do të rezultonte në vlerën 483.990 lekë.

¹¹⁹ Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i kaloi barra e provës: -- si burim për blerjen e automjetit në datën 05.03.2011 ka shërbyer shitja e një makine tjetër nga ana e subjektit dhe e bashkëshortes, blerë në vitin 2009, në vlerën 500.000 lekë, dhe shitur vëllait të bashkëshortes në vlerën 10.000 euro, në datën 30.12.2012. – Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar shpenzimet për mirëmbajtje dhe përmirësime, të kryera për këtë mjet, të cilat kanë sjellë rritjen e vlerës së tij, i cili, pasi ka qenë rreth 4 vite në qarkullim, ndaj edhe çmimi i referuar në këtë kontratë, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë bindëse, lidhur me vlerën reale të shitjes së mjetit.

71. Në konsideratë të qëndrimeve të mësipërme, në lidhje me automjetet “DaimlerChrysler”, me targa {***}, si dhe “Volkswagen Passat”, me targa {***}, të cilat kishin shërbyer si burime zinxhir për automjetin “Mercedes-Benz”, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe për të cilat çmimet e blerjes dhe të shitjes u konsideruan jashtë logjikës ekonomike, si dhe burimeve të tjera të deklaruara nga subjekti, trupi gjykues, nga një analizë garantiste e periudhës 01.01.2015 – 11.03.2015, në përgjigje të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, kreu analizën mbi burimin e automjetit “Mercedes-Benz” në datën e blerjes, 11.03.2015, duke konsideruar si burim vetëm vlerën e çmimit të blerjes së automjetit “DaimlerChrysler”, në shumën 500.000 lekë, pra jo vlerën e plotë të shitjes së tij. Nga kjo analizë, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e këtij automjeti, në datën 11.03.2015, në vlerën 630.639 lekë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
72. Në përfundim të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit të kriterit të pasurisë, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe gjendet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me mendimin paralel të vëzhguesit ndërkombëtar

73. Subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim kundërshtimet e tij në lidhje me opinionin bashkëpunues të vëzhguesit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”), i cili ka shprehur dakordësinë në lidhje me vendimin e Komisionit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, si dhe ka referuar te Komisioneri Publik opinionin për të paraqitur ankim për kriterin e parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit të rivlerësimit, paraqitja e këtij opinionin në këtë fazë të procesit, në një kohë që përfaqësuesi i ONM-së ka monitoruar procesin në çdo hap dhe nuk ka paraqitur në Komision ndonjë gjetje për cenimin e besimit të publikut, e cila t’i jetë njoftuar subjektit, vjen në kundërshtim me parimet e procesit të rivlerësimit. Në kuadër të kundërshtimit të këtij opinionin, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar në ankim disa shpjegime të përgjithshme, të cilat nuk i konsideron shkaqe ankimore, në lidhje me konkluzionet e Komisionit mbi denoncimet e publikut, të trajtuara në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, dhe të cituara në opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar, pasi, bazuar në parimin “*no reformatio in peius*”, Kolegji, mbi bazën e ankimit të ankuesit, nuk mund të përkeqësojë situatën juridike të tij.
74. Në analizë të sa më lart, trupi gjykues, referuar përmbajtjes së mendimit paralel të vëzhguesit të ONM-së, vëren se çështja objekt shqyrtimi, që i përket subjektit të rivlerësimit, referohet pranë Komisionit Publik për të ushtruar ankim, pasi për sa vlerësohet prej tij, lidhur me konkluzionet e Komisionit për disa denoncime të publikut dhe situatën e konfliktit e interesit në shqyrtimin e tri çështjeve me shoqërinë “Lura” ShPK, e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e cenimit të besimit të publikut, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
75. Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe parashikimet e nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sjell në vëmendje se në rastin konkret objekt analizimi në Kolegji është vendimi i Komisionit, mbi bazën e ankimit të subjektit të rivlerësimit. Në kushtet kur vetë subjekti i rivlerësimit në ankim shprehet se shpjegimet e dhëna prej tij në drejtim të konkluzioneve të Komisionit, që adresohen në opinionin paralel të vëzhguesit ndërkombëtar, nuk përbëjnë shkaqe ankimi, trupi gjykues e gjen të panevojshme analizën e mëtejshme në këtë drejtim.

76. Në përmbyllje të parashtimeve të tij, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar trupit gjykues të Kolegjit zbatimin e parimeve të proporcionalitetit dhe të objektivitetit, lidhur me arritjen e nivelit të besueshmërisë për kriterin e pasurisë, duke vlerësuar krahas peshës jopërcaktuese të vlerës së vogël të balancës negative, edhe disa rrethana që adresohen veçanërisht në balancën negative të babait të tij, për krijimin e shumës prej 3.000.000 lekësh, të dhënë hua, si vijon: (i) moskonsiderimi për shkak të pamundësisë për të provuar me dokumentacion tatimor të ardhurat e fituara nga bujqësia në atë kohë, të cilat, objektivisht, kanë ekzistuar dhe provohen nga autoritetet vendore (Bashkia Libohovë); (ii) fakti që shumat e fituara janë deklaruar rregullisht pranë organeve tatimore vendore, duke mos iu fshehur verifikimit; (iii) pjesa më e madhe e të ardhurave janë krijuar në periudhën 2001 – 2006 nga babai, kur subjekti i rivlerësimit ka qenë student, dhe nuk ekzistojnë deklarime periodike që mund të kishin ndihmuar situatën; (iv) konsistenca në deklarime për përdorimin e kësaj huaje si burim për krijimin e pasurisë; (v) vlera e balancës negative lidhet me aktivitetin privat të babait të subjektit, i cili nuk ka pasur ndonjë detyrim të posaçëm, të ngjashëm me subjektin e rivlerësimit, që do të thotë se veprimtarinë e tij mund ta zhvillonte edhe në kushtet e informalitetit të lartë të kohës; (vi) koha e largët e krijimit të kësaj pasurie dhe mospërsëritja më tej në vite e një situatë të tillë negative.
77. Trupi gjykues, në funksion të analizimit të këtij kërkimi të subjektit të rivlerësimit, sjell në vëmendje se, referuar kuadrit ligjor kushtetues dhe legjislacionit të posaçëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, në asnjë dispozitë nuk parashikohen kritere vlerësimi të kushtëzuara me periudha kohore të krijimit të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me ta, apo çdo lloj kriteri tjetër përcaktues. Sikurse është elaboruar tashmë nga Kolegji, nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive, synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit që janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive, për të cilat nuk mund të justifikohet ligjërisht burimi i tyre apo që posedojnë të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht faktit nëse të ardhurat janë përfituar ose jo në mënyrë të drejtpërdrejtë nga subjekti i rivlerësimit. Në rastin konkret, krahas problematikës në lidhje me huan në vlerën prej 3.000.000 lekësh, të dhënë nga babai në vitin 2009, e cila ka shërbyer si burim krijimi i një ndër pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues ka konfirmuar problematikat edhe në lidhje me burimin tjetër të krijimit të pasurisë në fjalë, dy tërheqjet nga Raiffeisen Bank ShA, si dhe pamjaftueshmërinë e burimeve të krijimit të një tjetër pasurie, të deklaruar po në deklaratën e pasurisë *vetting*, automjetit “Mercedes-Benz”, ardhur si pasojë edhe e transaksioneve të shitblerjeve jashtë logjikës ekonomike. Subjekti i rivlerësimit, në mënyrë të përsëritur, ka blerë automjete që sipas tij janë në gjendje jo të mirë teknike (ndryshe nga parashikimet kontraktore për blerjen e tyre), dhe i shiti ato më shtrenjtë, madje automjetin “DaimlerChrysler”, subjekti i rivlerësimit e ka blerë rreth 30% më lirë nga sa e kishte blerë shitësi i tij, tre muaj më parë. Në këto rrethana, balanca negative shumë e thellë vlerësohet si një mungesë e rëndësishme, e cila cenon standardin kushtetues të të provuarit bindshëm të ligjshmërisë së pasurisë. Këto arsye, në vlerësimin e trupit gjykues, në rastin konkret, e bëjnë të pamundur zbatimin e parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit.
78. Në konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit, mbështetur në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, dhe në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 557, datë 29.07.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë dhe duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 557, datë 29.07.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Emiljano Ruli.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 28.05.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi – kundër

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues për shqyrtimin e çështjes nr. 48/2022 (JR), jam kundër vendimit nr. 44, datë 28.05.2025, me të cilin shumica e trupit gjykues vendosi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 557, datë 29.07.2022, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Emiljano Ruli.
2. Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, provat e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si në ankim, ashtu dhe në parashtrime, provuan se ai ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në kuptim të nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, e për pasojë, vendimi i Komisionit duhej të ndryshohej nga shumica e trupit gjykues në Kolegj dhe të vendosej konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit.
3. Për pasurinë “*apartament banimi me sipërfaqe 119.3 m², rruga “{***}”, Tiranë*, Komisioni dhe shumica e trupit gjykues nuk ka konsideruar si burim të ligjshëm për krijimin e pasurisë, huan dhënë subjektit të rivlerësimit nga babai i tij, në vlerën 3.000.000 lekë, në vitin 2009.
4. Arsyetimin e përdorur nga shumica e trupit gjykues, për të konkluduar se babai i subjektit të rivlerësimit ishte në pamundësi financiare për dhënien e kësaj huaje, e vlerësoj në mungesë të një analize të plotë të situatës faktike, që ofrojnë aktet e administruara gjatë këtij procesi, si në drejtim të deklaramit, ashtu edhe të ligjshmërisë së kësaj të ardhure sipas detyrimit ligjor të parashikuar nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me deklarinimin e kësaj pasurie

4.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Kontratë porosie për blerje apartamenti me sipërfaqe 119.3 m², me firmën ‘{***}’ ShPK, nr. {***} prot., datë 12.11.2009. Për pagesën e vlerës kam përdorur tërheqjen nga RFZ Bank, e llogarisë së pagës së b/shortes V. R., në vlerën 800.000 lekë, tërheqjen e depozitës sime, në vlerën 700.000 lekë, vlerë cash e grumbulluar nga kursimet në shumën 131.500 lekë, hua në shumën 4.000.000 lekë, dhënë nga shtetasi A. Z., me kontratën e huas me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.12.2009, hua verbale e dhënë nga babai, Sh. R., në shumën 3.000.000 lekë. Vlera 9.000.000, parapaguar shuma 8.631.500 lekë. 50% bashkëpronësi me bashkëshorten”.*

4.2. Në deklaratën e interesave privatë periodike 2009, subjekti deklaron: “*Hua pa afat, e dhënë nga babai, Sh. Sh. R., në vlerën 3.000.000 lekë, me qëllim blerje apartament banimi”.*

4.3. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit rezulton i besueshëm në deklarinimin e huas si burim për krijimin e kësaj pasurie, që në kohën e marrjes së saj, në vitin 2009, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, ashtu edhe në deklaratën *vetting*, dhe nuk është një burim i pretenduar vetëm gjatë dhe për efekt të procesit të rivlerësimit.

Lidhur me provueshmërinë e burimit të të ardhurave të babait për dhënien e kësaj huaje

4.4. Pavarësisht se bie dakord me arsyetimin dhe vlerësimin e shumicës së trupit gjykues, sa i përket të ardhurave nga emigracioni dhe ato nga bujqësia, kundërshtoj vlerësimin e shumicës, sa i takon të ardhurave nga aktiviteti privat i babait si “marangoz”, në Libohovë. Në gjykimin tim, subjekti i rivlerësimit arriti të provojë me dokumentacion që ky aktivitet ka qenë i regjistruar dhe është ushtruar

pa ndërprerje që nga viti 2001 e në vijim, deri në vitin 2014. Konkretisht, analizimi i akteve shkresore, si renditur më poshtë, të vlerësuara në harmoni mes tyre, më krijojnë bindjen se babai i subjektit ka pasur mundësi të kursejë shumën e dhënë hua, me të ardhura nga ky aktivitet.

4.4.1. Për të provuar ushtrimin e këtij aktiviteti, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prova të tilla si: (i) Leje higjiëno-sanitare, lëshuar nga Inspektorati Sanitar Shtetëror i Rrethit Gjirokastrë, sipas së cilës, pas kontrollit higjiëno-sanitar, të ushtruar nga inspektorët sanitarë shtetërorë, në objektin që i përket z. Sh. R., në Libohovë, është vendosur që objekti me destinacion “prodhime druri” plotëson kushtet higjiëno-sanitare dhe (ii) Kërkesë e Kryetarit të Bashkisë Libohovë, drejtuar Korporatës Elektrike Gjirokastrë, Dega Libohovë, ku i kërkon lidhjen e energjisë elektrike për zdrukthëtarinë e ndërtuar me leje të rregullt ndërtimi nga bashkia, për shtetasin Sh. R.

4.4.2. Regjistrimi i aktivitetit, të ardhurat e realizuara prej tij dhe shlyerja e detyrimeve tatimore, provohen nga vërtetimi nr. {***}, datë 31.10.2014, i Bashkisë Libohovë, në të cilin konfirmohet se: *“Sh. Sh. R. [...] Në vitin 1996 është kthyer në Shqipëri, ku ka hapur biznes privat (marangoz), është regjistruar si biznes i vogël pranë kësaj bashkie dhe ka shlyer detyrimet tatimore në mënyrë të përvitshme, deri në qershor të vitit 2014, vit kur ka ikur në ShBA. Nga biznesi i tij privat kanë realizuar të ardhura vjetore mesatare rreth 1.000.000 lekë në vit [...]”*.

4.4.3. Në vijim, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 21.04.2022, të Sektorit të Tatim-Taksave, Bashkia Libohovë¹²⁰, vërteton se: *“Në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ‘Për sistemin e taksave vendore’, neni 12, pika 4, ‘Për regjistrimin e taksapaguesit nga Bashkia’, subjekti privat, z. Sh. Sh. R., në bazë të dokumentacionit që disponon Zyra e Tatim-Taksave pranë Bashkisë Libohovë, rezulton se e ka filluar aktivitetin në vitin 2001. Është regjistruar pranë regjistrimit të subjekteve private të Bashkisë Libohovë në muajin janar të vitit 2001, në cilësinë e statusit person fizik “marangoz”. Xhiroja vjetore që ka qenë e deklaruar prej tij, ka qenë në vlerën 2.000.000 lekë në vit; niveli i taksave vendore është pasqyruar në aktdetyrimet për çdo vit kalendarik, sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak. Subjekti ka paguar tatimin si biznes i vogël, sipas përcaktimit të bërë për nivelin e taksimit të biznesit të vogël, për bashkitë e kategorisë së tretë (Bashkia Libohovë është e tillë), në masën 20.000 lekë në vit, mbi bazën e xhiros vjetore të deklaruar prej 2.000.000 lekësh. Po kështu, edhe detyrimet tatimore për taksat vendore të vendosura për çdo vit kalendarik nga Këshilli Bashkiak janë paguar të gjitha në bazë të mandatarkëtimeve dhe faturave të bankës dhe, si rrjedhojë, nuk rezulton të jetë debitor pranë Bashkisë Libohovë. Edhe pas regjistrimit të tij si subjekt fiskal, në vitin 2011, pranë DRT-së Gjirokastrë, ku dhe është pajisur me NIPT, ai ka vazhduar të jetë i regjistruar pranë regjistrimit të subjekteve private të Bashkisë Libohovë, ku ka deklaruar xhiro vjetore në vlerën 2.000.000 lekë në vit, dhe ka paguar rregullisht tatimin si biznes i vogël, si dhe detyrimet tatimore vendore pasqyruar në aktdetyrimet për çdo vit kalendarik, sipas paketës fiskale të miratuar nga Këshilli Bashkiak”*.

4.5. Ndryshe nga Komisioni dhe shumica e trupit gjykues, në cilësinë e gjyqtarës në pakicë, vlerësoj se këto akte përbëjnë provë të plotë ligjore, në drejtim të provueshmërisë së ushtrimit të këtij aktivitetit nga viti 2001, të gjenerimit të të ardhurave mesatarisht në masën 1.000.000 lekë në vit, si dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore, elemente këto të konfirmuara nga organi përgjegjës. Në këto

¹²⁰ Informacionin më sipër, Bashkia Libohovë e mbështet në dokumentacion provues të kohës: (i) Kopje e fletës së regjistrimit të evidencës së tatimpaguesve, “Pasqyrë progresive e subjekteve private që janë të regjistruar dhe kanë paguar taksat lokale për vitin 2001”; (ii) Fletë njoftimi mbi tatimet dhe taksat e vitit 2003 dhe (iii) Aktdetyrimet, për vitet 2004, 2006, 2007, 2008 dhe 2009.

kushte, plotësohen të gjitha aspektet e kërkuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për të konsideruar një të ardhur të ligjshme, të deklaruar dhe të provuar. Me këtë argument, të ardhurat e realizuara nga aktiviteti ekonomik i babait duhet të ishin përlllogaritur në masën 1.000.000 lekë për çdo vit të periudhës 2001 – 2009, e për pasojë, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, babai i subjektit do të rezultonte me mjaftueshmëri burimesh të ligjshme për dhënien hua të shumës 3.000.000 lekë, në vitin 2009, dhe mbulimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën e sipërcituar. Ky vlerësim ligjor, i bazuar në prova, do të reduktonte ndjeshëm mungesën financiare për krijimin e apartamentit me sipërfaqe 119.3 m², rruga “{***}”, Tiranë.

5. Në lidhje me pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 119 m²”, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, për të cilën Komisioni ka konkluduar se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, kur ka gjykuar tri çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{***}” ShPK, duke e vendosur atë në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016, mbështes vlerësimin e shumicës së trupit gjykues në paragrafin 61 të vendimit, se: “[...] problematika e evidentuar nga Komisioni në këtë rast, e cila nuk lidhet me ligjshmërinë e origjinës së krijimit të kësaj pasurie dhe mënyrën e përfitimit të saj, në kushtet e konfliktit të interesit, nuk mund të prodhojë pasojën ligjore të parashikuar nga neni 33, pika 5, shkronja “d” e ligjit nr. 84/2016”.

5.1. Pavarësisht sa më sipër, edhe nëse çështja do të vlerësohet nën dritën e dispozitave të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, apo përcaktimeve në nenet 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile, situata faktike në rastin konkret provon se subjekti, në asnjë rrethanë, nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit apo ndonjë shkelje tjetër ligjore me qëllimin shmangien e tij.

5.2. Po kështu, çmoj të pabazuar arsyetimin e shumicës së trupit gjykues se: “Duke e ekspozuar të cunguar rrethanën e marrëdhënies kontraktore, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk i ka dhënë Kryetarit të Gjykatës mundësinë për të vlerësuar në mënyrë të plotë arsyet e ekzistencës ose jo, të shkaqeve të parashikuara për përjashtimin e gjyqtarit, sipas nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile. Në këto kushte, problematikat e konstatuara me të drejtë nga Komisioni, lidhur me mosparaqitjen në kërkesën për heqjen dorë nga gjykimi i të gjitha fakteve dhe rrethanave, të cilat, sipas subjektit të rivlerësimit, e vendosin atë në kushtet për heqjen dorë nga gjykimi i çështjeve, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, në vlerësimin e trupit gjykues do të duhet të adresoheshin në kuadër të kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale”. Thënë ndryshe, edhe pse ky konkluzion i shumicës nuk ka ndikim ligjor në vendimmarrjen e saj, përsëri, si gjyqtare në pakicë, vlerësoj se subjekti nuk e ka paraqitur të cunguar rrethanën e marrëdhënies kontraktore mes bashkëshortes dhe shoqërisë “{***}” ShPK, në kërkesat për heqje dorë nga gjykimi i çështjeve me palë kërkuese këtë shoqëri.

5.3. Parë në këtë këndvështrim, konstatoj se në të tria kërkesat që subjekti i rivlerësimit i ka drejtuar Kryetarit të Gjykatës: (1) Kërkesën e datës 25.08.2017, për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes administrative me nr. {***}, datë 25.08.2017, në të cilën ka parashtruar se: “Bashkëshortja ime, V. R., me palën kërkuese, ka pasur një marrëdhënie kontraktore, kontratë sipërmarrje, mbi bazën e së cilës ka përfutuar dy objekte (nga trashëgimia). Edhe pse objektet e ndërtuara nga pala kërkuese janë përfutuar nga bashkëshortja, unë, si gjyqtar, për të shmangur çdo lloj paragjykimi nga palët, çmoj se duhet të paraqes dorëheqjen nga gjykimi i kësaj çështjeje. Për këto arsye, në vështrim të nenit 72/4 dhe 73 të K. Pr. Civile, dhe vendimit nr. 138/a, datë 24.12.2008, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ju kërkoj të miratoni heqjen dorë nga gjykimi i çështjes administrative [...]”; (2) Kërkesën e datës 25.08.2017, për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes administrative me nr. {***}, datë 25.08.2017, në

të cilën parashtrohet e njëjta bazë ligjore dhe rrethanë, si në kërkesën e cituar më sipër; (3) Kërkesën e datës 08.09.2017, për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes administrative me nr. {***}, datë 04.09.2017, referuar po ashtu të njëjtës bazë ligjore dhe rrethanë si ajo përmendur më sipër. Për të tria këto kërkesa, Kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur mospranimin e tyre, respektivisht me vendimet nr. {***}, datë 29.08.2017, nr. {***}, datë 29.08.2017, dhe nr. {***}, datë 08.09.2017.

5.4. Të tria çështjet gjyqësore administrative më sipër kanë pasur të njëjtat palë ndërgjyqëse, përkatësisht shoqërinë “{***}” ShPK, në cilësinë e kërkesës/palës paditëse, dhe Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, në cilësinë e personit të tretë, palës së paditur. Për sa më sipër, nuk konstatoj asnjë rrethanë të *cunguar* të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka përsëritur ekzistencën e marrëdhënies kontraktore të bashkëshortes së tij me shoqërinë “{***}” ShPK, kontratën e sipërmarrjes mbi bazën e së cilës ajo kishte përfituar dy objekte (nga trashëgimia). Mospërmendja e ekstremiteteve të kontratës së porosisë/sipërmarrjes, në kërkesat për heqjen dorë, nuk i bën ato të vesuara apo përpjekje për të fshehur të dhëna përpos faktit që, nëse Kryetari i Gjykatës do të kishte paqartësi për objektin e tyre, mund të kërkonte plotësimin e tyre dhe mbështetjen me dokumentacionin e nevojshëm përpara disponimit për mospranimin e kërkesave.

5.5. Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka vepruar në përmbushje të kërkesave të neneve 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile, për heqjen dorë nga këto çështje, në drejtim të shmangies së çdo perceptimi për njëanshmëri nga ana e tij. Në këto kushte, rrethanat e mësipërme kanë treguar kujdesin e shtuar të subjektit në drejtim të paanshmërisë dhe shmangies së konfliktit të interesit.

6. Lidhur me *automjetin tip “Mercedes-Benz”, blerë në vitin 2015*, jam kundër qëndrimit të mbajtur nga shumica e trupit gjykues, me arsyetimin se:

6.1. Çmimi i shitjes së automjetit “DaimlerChrysler”, i cili ka shërbyer për blerjen e automjetit objekt analize, duhet konsideruar në masën e përcaktuar në kontratën e shitblerjes së automjetit, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.02.2015, në vlerën 900.000 lekë, që në kuptim të nenit 690 të Kodit Civil ka fuqinë e ligjit për palët. Transferimi i vlerës së shitjes nga blerësi nëpërmjet Credins Bank ShA, në llogarinë e bashkëshortes, V. R., në Raiffeisen Bank ShA, është një element që shton besueshmërinë e realizimit të kësaj të ardhure. Si gjyqtare në pakicë, përmbajtjen e kontratës noteriale e çmoj me vlerë provuese të plotë, edhe në kuptim të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile se: *“Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklarimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre”*. Duke konsideruar kontratën noteriale të sipërcituar, provë të plotë në lidhje me pagimin e vlerës 900.000 lekë, për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi, diferenca negative, e konstatuar nga shumica e trupit gjykues për krijimin e kësaj pasurie, do të reduktohej ndjeshëm dhe balanca e rezultuar do të jetë jodomethënëse për të penalizuar subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij kriteri.

7. Në përmbledhje të vlerësimit tim më sipër, lidhur me huan e dhënë nga babai i subjektit të rivlerësimit për blerjen e apartamentit të banimit si të ligjshme, lidhur me vlerësimin ligjor të bërë për automjetin e blerë në vitin 2015, e harmonizuar me deklaratimet jokontradiktore të subjektit të rivlerësimit gjatë këtij procesi, si dhe faktit që nga hetimi administrativ i kryer në Komision për të gjitha vitet e periudhës së rivlerësimit, subjekti nuk ka rezultuar me ndonjë balancë negative, përveçse asaj të konstatuar deri më datën 12.11.2009, moment në të cilin është blerë apartamenti i banimit objekt shqyrtimi, çmoj se subjekti i rivlerësimit e kalon testin e besueshmërisë, duke mbetur në kufijtë e zbatimit të parimeve të objektivitetit dhe të proporcionalitetit.

8. Qëndrimin tim të mbajtur në këtë çështje e përforcojnë vlerësimet edhe për dy kriteret e tjera, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, për të cilat subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel besueshmërie dhe kualifikues, duke u konsideruar i përshtatshëm dhe i aftë për vazhdimin e detyrës. Për sa më sipër, duke konsideruar se subjekti ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, së bashku me konkluzionet pozitive për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, në përfundim, çmoj se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 59, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c” të ligjit nr. 84/2016 dhe, në këto rrethana, vendimi i Komisionit duhet të ndryshohet dhe subjekti i rivlerësimit të konfirmohet në detyrë.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi